REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

# ANALIZA
## VJETORE

# 2023

www.app.gov.al

SHKURTIME: 6

PËRKUFIZIME: 7

HYRJE 8

1.1 ARRITJET KRYESORE GJATË VITIT 2023 8

TË DHËNA STATISTIKORE MBI SISTEMIN E PROKURIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI 11

2.1. Statistika në lidhje me Regjistrat e parashikimeve të krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik për periudhën Janar – Dhjetor 2023 13

2.2. Statistika në lidhje me numrin e procedurave të prokurimit të shpallura gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2023 në Sistemin e Prokurimit Elektronik 15

2.3. Statistika për Procedura mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël të zhvilluara në Sistemin e Prokurimit elektronik 17

2.3.1. Statistika sipas Tipit të kontratës 17

2.3.2. Statistika sipas llojit të procedurës së prokurimit 19

2.3.3. Statistika për procedurat e prokurimit të shpallura dhe të vazhduara gjatë vitit 2023, sipas 3 mujorëve 21

2.3.4. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave për procedurat e prokurimit të shpallura gjatë vitit 2023, krahasuar me vitin 2022. 22

2.4. Statistika sipas njoftimeve të fituesit 26

2.4.1. Statistika mbi numrin e njoftimeve të fituesve të shpallura gjatë vitit 2023, sipas tipit të kontratës 26

2.4.2. Statistika mbi numrin e procedurave të përfunduara me fitues të shpallura gjatë vitit 2023, sipas llojit të procedurës së prokurimit 28

2.4.3. Statistika mbi numrin e njoftimeve të fituesve të shpallura gjatë vitit 2022, krahasuar me vitin 2023 30

2.5. Statistika për kontratat e nënshkruara 32

2.5.1. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2023, sipas Tipit të kontratës 32

2.5.2. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave gjatë vitit 2023, sipas llojit të procedurës së prokurimit 34

2.5.3. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave dhe MK të nënshkruara gjatë vitit 2023, krahasuar me vitin 2022 35

2.6 Marrëveshjet Kuadër 37

2.7. Të dhëna mbi procedurat e prokurimit te kryera gjate vitit 2023 në kuadër të procesit të rindërtimit për shkak të Tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 41

2.8. Statistika mbi kriteret e parashikuara nga ligji për vlerësimin e ofertës fituese për procedurat të finalizuara me njoftim fituesit gjatë 2023 42

**2.9. Statistika mbi numrin e anullimeve të procedurave të prokurimit mbi kufirin monetar për procedurën më vlerë të vogel gjatë 2023** 43

**2.10. Të dhëna mbi procedurat e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës** 45

**2.11. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël** 50

**2.12 Statistika në lidhje me procedurat e krijuara në sistemin elektronik** 51

**2.13 Sistmi dinamik blerje bileta transporti ajror ndërkombëtar** 53

**2.14. Statistika në lidhje me Autoritet Kontraktore që kanë krijuar procedura me vlerë të vogël dhe mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël** 55

**2.15. Statistika mbi ofertat e dorezuara gjatë 2023** 56

**2.15.1.Statistika mbi procedurat e prokurimit me një ofertë të dorëzuar të përfunduara me fitues gjatë 2023** 59

**2.16. Statistika në lidhje me pjesëmarrjen e SME-ve në procedurat e prokurimit** 60

**2.17. Të dhëna mbi pjesëmarrjen e operatorët ekonomikë të huaj** 61

**2.17.1. Procedurat e fituara nga Operatorët Ekonomikë të huaj, sipas llojit të procedurës, paraqiten si me poshtë:** 64

**2.17.2. Operatorët Ekonomikë të huaj nga shtetet anëtare të BE** 64

**2.18. Statistika për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë gjatë vitit 2023** 65

**2.19. Statistika në lidhje me numrin e procedurave të dhënies me koncesion/ppp gjatë vitit 2023** 66

**2.20. Statistika në lidhje me procedurat e ankandit publik të zhvilluara gjatë vitit 2023** 66

**OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, ZBATIMI DHE MONITORIMI I TYRE** 68

**3.1. Strategjia e Re e Prokurimit Publik 2024-2030 dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e saj 2024-2027** 69

**3.2. Strategjitë Ndërsektoriale** 70

**PROCESI I INTEGRIMIT EUROPIAN DHE BASHKËPUNIMI MË TË TRETËT** 71

**BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE TË TJERA** 73

**5.1. Marrëveshjet e Bashkëpunimit** 73

**5.2. Bashkëpunimi me Institucione të Huaja** 75

**5.3. Profesionalizimi** 76

**5.4. Procesi i aderimit të Shqipërisë në GPA të OBT** 76

**INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2023** 78

**6.1. Akte Nënligjore** 78

TREGUES TË VEPRIMTARISË KËSHILLUESE DHE MONITORUESE TË APP 80
7.1. Veprimtaria asistuese e APP 81
7.1. 1. Analizimi i të dhënave të procedurave të asistuara 81
7.1.2. Analizimi i të dhënave në lidhje me procedurat që rezultojnë pa problematika, kundrejt procedurave të asistuara 82
7.1.3. Analizimi i të dhënave në lidhje me reagimin/reflektimin e autoriteteve kontraktore, ndaj rekomandimeve të APP. 84
7.1.4. Analizimi i të dhënave në lidhje me mesataren e numrit të ofertave të paraqitura dhe ofertave të kualifikuara në procedurat e asistuara nga APP. 86

VERIFIKIMI I ZBATIMIT TË LIGJSHMËRISË SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK 91
8.2. Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të ankandit publik, Koncesioneve/PPP dhe prokurimeve në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë. 97
9.1. Të dhëna mbi raportimin e planeve të zbatimit të kontratave nga Autoritetet Kontraktore. 100

MONITORIMI I KONTRATAVE 100
9.3. Të dhëna mbi korrektësinë e zbatimit të kontratave të raportuara nga AK-të nëpërmjet formularëve të raportimit, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023. 103
9.4. Problematika të evidentuara nga AK gjatë zbatimit të kontratave nga analizimi i formularëve standardë të raportimit të ecurisë së zbatimit të kontratave. 106
9.5. Modifikimet e Kontratave 107
9.6. Hartimi i Planit të Monitorimit të Kontratave 108
9.7. Hartimi i akteve të nevojshme për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë procesit të monitorimit të kontratave. 109

PËRJASHTIMI I OPERATORËVE EKONOMIKË 111
10.1. Shqyrtimi i kërkesave për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta per fituar kontrata publike 111

PËRFAQËSIMI I APP NË PROCESET GJYQËSORE 114
TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR PUBLIKIMIN 119
12.1. Publikimi i njoftimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik 120
12.2. Publikimi i Njoftimeve për Ankande Publike në Buletinin e Njoftimeve Publike 123
12.3. Njoftime për Koncesione/Partneritet Publik Privat dhe të njoftime të tjera 123
12.4. Publikimi i elementëve të regjistrit në sistem 124
12.5. Praktikat e shqyrtuara 126

TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR MENAXHIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE 127
13.1. Dhënia e asistencës teknike për përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik 130
13.2. Statistika mbi transaksionet e miratuara nga AFMIS 131
13.3. Praktikat e shqyrtuara 131
13.4. Krijimi i përdoruesve të rinj për vitin 2023 132
13.5. Statistika të tjera në lidhje me përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik 136
13.6. Aktiviteti i faqeve per vizitore 137
13.7. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas 24 orëve. 137
13.8. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas ditëve të javës. 139
13.9. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas muajve të vitit. 140
13.10. Perdoruesit te cilet perdorin me se shumti sistemin e prokurimit elektronik 141
13.11. Aktiviteti i përdoruesve sipas ndërfaqeve më të klikuara në portalin e APP. 142
13.12. Aktiviteti i përdoruesve sipas fjalëve kyc më të përdorura për kërkimin e portalit të APP. 144
13.13. Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas shfletuesve dhe sistemeve operative. 146
13.14. Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas llojeve të pajisjeve më të përdorura nga përdoruesit 147

MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCËS 150
14.1. E drejta e Informimit 150
14.2. Autoriteti Përgjegjës per Konfliktin e Interesit 151
14.3. Forcimi i kapaciteteve administrative 151
14.3.1. Pjesëmarrja në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare 151
14.3.2. Trajnimet e punonjësve të prokurimeve pranë Autoriteteve Kontraktore 153
14.4. Auditimin e KLSH 154
14.5. Përdorimi dhe ruajtja e aktiveve 155
14.6. Realizimi i buxhetit për vitin 2023 155
15.1. Hartimi i legjislacionit dytësor në zbatim të ndryshimeve ligjore në fushën e prokurimit publik. 156

PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT E PUNËS PËR VITIN 2024 156

## SHKURTIME:

**AK** - Autoritet Kontraktor

**APP** - Agjencia e Prokurimit Publik

**ASPA** - Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

**ATRAKO** - Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve

**BB** - Banka Botërore

**BNJP** -Buletini i Njoftimeve Publike

**BOE** –Bashkim i Operatorëve Ekonomikë

**OE** -Operator Ekonomik

**ILDKPKI** - Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit

**KVO** - Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

**KPA** - Kodi i Procedurave Administrative

**KLSH** -Kontrolli i Lartë i Shtetit

**KM** - Këshilli i Ministrave

**KPP** - Komisioni i Prokurimit Publik

**LAP** -Ligji për Ankandin Publik

**LPP** -Ligji i Prokurimit Publik

**MK-**Marrëveshje Kuadër

**NJP**- Njësi Prokurimi

**OQB** - Organi Qendror Blerës

**PBB-** Produkt i Brendshëm Bruto

**PPP** - Partneriteti Publik Privat

**QKB** - Qendra Kombëtare e Biznesit

**SA** - Strategjia Antikorrupsion.

**SAE** - Sistemi i Arkivës Elektronike

**SMFP** - Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike

**SPE**- Sistemi i Prokurimit Elektronik

**OBT-** Organizata Botërore e Tregtisë

**GPA-** Marrëveshja për Prokurimin Publik

**OSBE-** Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë

**BERZH**-Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

**OBP** -Operatori i Blerjes së Përqëndruar

## PËRKUFIZIME:

Në funksion të interpretimit të kësaj analize, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

**Fondi limit i prokuruar -** Vlera pa TVSH, që përllogaritet nga autoriteti kontraktor në çastin e publikimit të njoftimit të kontratës ose në çastin e fillimit të procedurës së prokurimit, në rastet kur nuk kërkohet një publikim i tillë.

**Vlera e fituar** – Vlera e ofertës së shpallur fituese.

**Fond i kursyer** - Diferenca midis fondit limit të prokuruar dhe vlerës së fituar

**Procedura të tjera** - Procedura prokurimi të zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, pas publikimit të njoftimit të kontratës.

**Marrëveshje kuadër** - Një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore dhe një a më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave, që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasitë e parashikuara.

**Procedurë prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës** – Lloj procedure e cila zhvillohet në rrugë elektronike dhe përdoret në rrethana të veçanta të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik.

**Procedura të papërfunduara (anuluara)** - Procedura prokurimi që nuk janë finalizuar me njoftim fituesi

**Pezullim** - Ndërprerje e zhvillimit të procedurës së prokurimit në rastet kur ka ankesa në Autoritetin Kontraktor apo në Komisionin e Prokurimit Publik.

**Asistim/koordinim** - Proces i zhvilluar në kuadër të dhënies së asistencës autoriteteve kontraktore, të cilat ndërmarrin një procedurë prokurimi, sa i takon hartimit të dokumenteve të tenderit.

**Verifikim** - Proces i zhvilluar pas përfundimit të procedurës së prokurimit me finalizimin e një kontrate për të verifikuar nëse procedura e prokurimit e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor është kryer në përputhje me parashikimet ligjore.

**Monitorim kontrate** - Procesi i monitorimit të implementimit të kontratës së nënshkruar nga ana e autoriteteve kontraktore nëpërmjet raporteve të dërguara nga ana e tyre

# 1

# HYRJE

Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim "APP") dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2023 deri në 31 Dhjetor 2023.
APP e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Ligjit Nr.125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, Ligjit Nr. 36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë", Ligjit Nr. 9874/2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar.
Raporti paraqet në mënyrë të detajuar edhe të dhëna statistikore në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimit publik në përgjithësi, përfshirë sistemin elektronik të prokurimit.

## 1.1 ARRITJET KRYESORE GJATË VITIT 2023

Gjatë vitit 2023, APP ka vijuar punën për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit publik në Shqipëri si edhe për të garantuar mirëzbatimin e legjislacionit të prokurimit.
Në këtë kuadër, drejtimet kryesore të veprimtarisë së APP dhe arritjet e shënuara gjatë vitit 2023 paraqiten si më poshtë:

- Procesi për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE ka shtuar angazhimin e APP në drejtim të procesit të integrimit europian dhe përgatitjes për këtë proces në cilësinë e institucionit kryesues të Kapitullit 5 të *Acquis,* "Prokurimi publik", si një nga kapitujt që i përket Grupit të Parë "Themelorët" të kapitujve negociues.

  Gjatë këtij viti puna e APP në këtë drejtim është fokusuar në hartimin i Pozicionit Negociues për këtë kapitullduke paraqitur situatën aktuale në fushën e prokurimeve publike dhe duke u fokusuar tek angazhimet e marra nga pala shqiptare gjatë takimit bilateral por edhe në kuadër të angazhimeve të marra në procesin e integrimit evropian.

  Gjithashtu, me rëndësi në këtë proces është edhe vijimi i punës për ngritjen e Tryezës së Partneritetit me qëllim përfshirjen në procesin e integrimit edhe të grupeve të interesit si biznes, akademi, media dhe shoqërui civile.

  Nga ana tjetër, duke marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna nga Komisioni Europian për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit, APP është përfsirë në mënyrë aktive, jo vetëm në hartimin e ndryshime ligjore për Ligjin e prokurimit publik, por edhe në grupin e punës për hartimin e një ligji të ri për koncesionet dhe PPP-të në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së.

- Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe monitorimit të zbatimit të politikave strategjike lidhur me prokurimin ku rëndësi të posaçme ka monitorimi i Strategjisë Kombëtare të Prokurimit Publik, hartimi i raporteve përkatëse dhe matja e të gjithë indikatorëve të performancës të identifikuar për këtë qëllim.

  Gjatë vitit 2023, është shtuar puna për realizimin e aktiviteteve të parashikuara në strategji, duke qenë se ky vit ishte edhe viti i fundit në të cilin shtrihet dhe Plani i Veprimit të Strategjisë aktuale në fushën e prokurimeve publike.

Nga ana tjetër, në kuadër të përfundimit të SKPP 2020-2023, gjatë vitit 2023 është punuar për hartimin e një Strategjie të re për Prokurimin Publik 2024-2030 dhe planin e saj të veprimit 2014-2027. Grupi Ndërinstitucional i Punës i ngritur me Urdhër të Kryeministrit ka hartuar draftin, i cili është dërguar për komente dhe sugjerime, është publikuar në faqen zyrtare të APP për mendime dhe komente dhe gjithashtu edhe në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet publike për konsultim publik.

Gjithashtu, APP ka punuar edhe për realizimin e aktiviteteve dhe indikatorëve të performancës në lidhje me dokumenta të tjerë strategjikë ku fusha e prokurimit publik është pjesë të tilla si, Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike etj, ku APP jep kontributin e saj, duke raportuar rregullisht në kuadër të hartimit të raporteve periodike të monitorimit në lidhje me zbatimin e masave përkatëse dhe realizueshmërinë e indikatorëve të performancës.

APP ka dhënë kontributin e saj edhe në kuadër të hartimit të strategjive të reja dhe planeve të reja të veprimit për strategjitë e mësipërme, për sa i takon prokurimit publik,

- Vijimi i procesit lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në Marrëveshjen e OBT për Prokurimet qeveritare është gjithashtu një detyrë e rëndësishme e APP si drejtuese e grupit të punës për përgatitjen e kushteve të aderimit të RSH në këtë marrëveshje.

Në kuadër të këtij procesi, pas depozitimit të pyetësorit pranë Sekretariatit Teknik të GPA-OBT në korrik 2023 dhe të sqarimeve shtesë në dhjetor 2023, Grupi i Punës me asistencën edhe të BERZH po vijon punën për hartimin e Ofertës Ekonomike të mbulimit të tregut.

- Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit rregullator është një nga objektivat kryesore të punës së APP ku rëndësi të veçntë merr hartimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i cili u miratua nga Këshilli i Ministrave në muajin Dhjetor 2023.

Projektligji i mësipërm ka për qëllim të adresojë një sërë problematikash të lindura gjatë zbatimit të ligjit të miratuar në vitin 2020 si edhe të përafrojë më tej ligjin e prokurimit me direktivat e BE-së.

Gjithashtu me rëndësi për t'u theksuar në drejtim të përmirësimit të kuadrit rregullator është miratimi i VKM për Operatorin e Blerjes së Përqendruar, e cila ka për qëllim riorganizimin e blerjes së përqendruar si një sh.a me kapital 100% publik, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

Ky ndryshim synon të rrisë kapacitetet e organit qendror blerës dhe njëkohësisht të rrisë eficencën e tij në lidhje me procedurat e prokurimit.

- Zhvillime të rëndësishme ka pasur gjatë vitit 2023 edhe në drejtim të profesionalizimit të funksionit të prokurimit publik ku në bashkëpunim me OSBE, ASPA dhe DAP është zhvilluar një program trajnimi gjithëpërfshirës në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

  Ky program përshin hartimin e kurrikulave të reja për trajnimin e punonjësve të prokurimit në 4 nivele; bazë, mesatar, i avancuar dhe ekspert dhe ka si synim rritjen e kapaciteteve të stafeve përgjegjës për prokurimin publik në institucionet përkatëse dhe garantimin e qëndrueshmërisë institucionale sa i takon prokurimit publik.

  Në këtë kuadër, gjatë vitit 2023 është organizuar Trajnimi i Trajnerëve për prokurimin publik si edhe një sërë trajnimesh të nivelit bazë me qëllim pilotimin e kurrikulës nga trajnerët e rinj.

- Gjatë vitit 2023, procesi i asistencës së dhënë autoriteteve kontraktore në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, veçanërisht në hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, ka vijuar normalisht, duke u asistuar pothuajse gjysma e procedurave të publikuara në SPE, si dhe duke asistuar çdo kërkesë paraprake të paraqitur nga autoritetet kontraktore.

  Në këtë kuadër, vlen të theksohet se vërehet një ndërgjegjësim i shtuar i Autoriteteve Kontraktore për këtë proces dhe, për pasojë, numri i procedurave të asistuara me kërkesë paraprake të autoriteteve kontraktore përpara publikimit në SPE, rezulton në rritje për këtë vit.

- Në kuadër të verifikimit ex-post të ligjshmërisë të procedurave, gjatë vitit 2023, përveç verifikimit të procedurave të prokurimit është realizuar edhe verifikimi i ligjshmërisë së procedurave koncesionare/ppp sipas parashikimeve të ligjit për koncesionet dhe PPP-të.

  Gjithashtu, është realizuar edhe një proces monitorimi për ankandet publike në kuadër të ligjit për ankandet jatë të cilit ka rezultuar si domosdoshmëri ndryshimi i kuadrit ligjor për ankandet publike dhe miratimi i një ligji të ri për këtë qëllim.

- Lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratave, me rëndësi për t'u theksuar për vitin 2023 është realizimi për herë të parë i tre planeve të monitorimit për zbatimin e kontratave gjetjet e të cilave u janë bërë me dije Autoriteteve Kontraktore respektive dhe, gjithashtu, janë hartuar rekomandime të përgjithshme që iu drejtohen të gjitha Autoriteteve Kontraktore.

- **Përmirësimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik** është gjithashtu një sfidë e vazhdueshme ku gjatë vitit 2023, me qëllim ardhjen në ndihmë të gjithë përdoruesve të sistemit, janë finalizuar çështjet si më poshtë:

- 

  - Përmirësim në deklarimin e operatorëve ekonomikë si bashkim operatorësh nga KVO;

  - Ndarja e skedarit Procedurat e publikuara në rolin e njësisë së prokurimit;

  - Ndryshim i zyrtarëve të prokurimit nga llogaria e administratorit të sistemit të autoritetit kontraktor;

  - Përmiresim i BI Report.

  - Asistenca

2

# TË DHËNA STATISTIKORE MBI SISTEMIN E PROKURIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI

Prokurimi publik është një nga fushat kryesore të veprimtarisë shtetërore dhe një nga proceset më të rëndësishme në menaxhimin e financave publike. Sikundër tregohet edhe nga shifrat dhe të dhënat e përpunuara në këtë kuadër, fondi buxhetor i shpenzuar për prokurime publike në vendet e rajonit për vitin 2022 shkon mesatarisht nga 6,5-9,4% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Konkretisht sikundër paraqitet edhe në Grafikun nr. 1 më poshtë, sipas të dhënave të publikuara rezulton se:

1.**Kosova**: Sipas raportit të Komisionit Europian, në vitin 2022, Prokurimi Publik arriti në 6,5% të PBB, me një rritje nga përqindja e vitit 2021, kur Prokurimi Publik zinte 5,6% të PBB. [1]

2.**Serbia**: Sipas raportit të Komisionit Europian, në vitin 2022, Prokurimi Publik arriti në rreth 9,3 % të PBB, duke pësuar një rritje nga përqindja e vitit 2021, kur Prokurimi Publik zinte 8,9 % të PBB. [2]

3.**Mali i Zi**: Sipas raportit të Komisionit Europian, në vitin 2022, Prokurimi Publik zë 8.74% të PBB, duke pësuar një rritje të konsiderueshme nga përqindja e vitit 2021, kur Prokurimi Publik zinte 4.47 % të PBB. [3]

4.**Maqedonia e Veriut**: Sipas raportit të Komisionit Europian, në vitin 2022, Prokurimi Publik, përfaqëson 8,6 % të PBB, duke pësuar një ulje nga përqindja e vitit 2021, kur Prokurimi Publik zinte 11 % të PBB. [4]

5.**Shqipëria**: Sipas analizës vjetore të vitit 2022, publikuar nga APP, prokurimi publik për vitin 2022 zinte rreth 9,4 % të PBB, duke pësuar një rritje nga përqindja e vitit 2021, kur Prokurimi Publik zinte 8.9 % të PBB .[5]




**Grafiku 1**

Burimi: Të dhëna të marra nga Raportet e Komisionit Europian për vendet e Rajonit dhe analiza vjetore e APP

Ndërkohë, nga përpunimi i të dhënave në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe bazuar në të dhënat

1 European Commission (2023), Kosovo Report, pg. 71
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

2 European Commission (2023), Serbia Report, pg. 86
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_695_Serbia.pdf

3 European Commission (2023), Montenegro Report, pg. 79
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_694%20Montenegro%20report.pdf

4 European Commission (2023), North Macedonia Report, pg. 68
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20report.pdf

5 Analiza Vjetore 2022, APP, pg. 13

paraprake të siguruara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë[6] mbi Produktin e Brendshëm Bruto (PBB), rezulton se, për vitin 2023 **fondi total limit**[7] zë 6.7% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). **Tabela e** mëposht**me paraqet** të dhënat në lidhje me raportin fond total limit -PBB:

**Tabela 1**

| Treguesi makroekonomik | Vlera (në miliardë Lekë) |
|---|---|
| **PBB- Produkti Brendshëm Bruto** | **2,176,100,000,000** |
| **Fondi total limit në Republikën e Shqipërisë** | **145,000,822,316.35** |
| **Fondi total limit në Republikën e Shqipërisë në raport me PBB (në %)** | **6.7%** |

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhënat në lidhje me raportin fond total limit -PBB:




**Grafiku 2**

Siç tregohet nga të dhënat e mësipërme, gjatë vitit 2023 ka një rënie të raportit të fondit total limit me PBB krahasuar me vitin 2022 nga 9.4% në 6.7%.
Duke analizuar të dhënat kjo rënie e vlerës së raportit të fondit total limit me PBB, vjen si rezultat i rënies së fondit total limit të procedurave të publikuara në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.
Nga ana tjetër, sikurse vërehet edhe nga të dhënat e pasqyruara më sipër, PBB e parashikuar për vitin 2023 ka pësuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me PBB në vitin 2022 nga 1,803,000,000,000 ALL në 2,176,100,000,000 ALL (17% rritje).

6 Sipas parashikimeve zyrtare paraprake për 2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (https://financa.gov.al/kuadri-makroekonomik-dhe-fiskal-2/) Produkti i Brendshëm Bruto për vitin 2023 është: **2,176,100,000,000.**

7 **Fondi total limit** është vlera totale e prokuruar në Republikën e Shqipërisë për të gjitha llojet e procedurave duke përfshirë fondin limit për procedurat e prokurimit mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël, fondin limit për procedurat me vlerë të vogël, fondin limit për sistemin dinamik të biletave dhe fondin limit për procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

## 2.1. Statistika në lidhje me Regjistrat e parashikimeve të krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik për periudhën Janar – Dhjetor 2023

Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistri i procedurave të prokurimit publik të realizuara përgatiten elektronikisht dhe publikohen në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ku janë të aksesueshme pa pagesë nga çdo i interesuar dhe në çdo moment.

Automatizimi i këtyre dy regjistrave ka një rëndësi shumë të madhe për rritjen e përgjegjësisë së Autoriteteve Kontraktore në planifikimin e nevojave që do të prokurojnë gjatë vitit në vijim, si dhe u mundëson operatorëve ekonomikë që, **në kohë reale**, **të kenë informacion mbi të gjitha procedurat dhe fondet publike që do të prokurohen gjatë vitit, duke rritur në mënyrë të dukshme transparencën në lidhje me përdorimin dhe mirëmenaxhimin e fondeve publike.**

Gjithashtu, automatizimi i regjistrave i mundëson APP-së identifikimin e të dhënave për procedurat e prokurimit të planifikuara për t'u kryer nga autoritetet kontraktore në kohë reale.
Nga të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit për periudhën Janar-Dhjetor 2023, rezulton se janë publikuar në total **38,413** elementë në regjistrat e parashikimit të prokurimeve (elementë të rinj dhe ndryshime).
Konkretisht, detajimi i elementëve në Regjistrin Kombëtar të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit është si më poshtë:

**Tabela 2**

| Tipi i Kontratës | Lloji i procedurës së prokurimit | Janar-Dhjetor 2023 |
|---|---|---|
| Punë | Procedura mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël | 1,646 |
| | Prokurim me vlerë të vogël | 511 |
| | Procedura me negocim pa shpallje paraprake | 6 |
| | Blerje nën vlerën 100.000 lekë | 0 |
| | Modifikimet e kontratës | 27 |
| Mallra | Procedura mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël | 5,694 |
| | Prokurim me vlerë të vogël | 7,918 |
| | Procedura me negocim pa shpallje paraprake | 36 |
| | Blerje nën vlerën 100.000 lekë | 6,310 |
| | Sistem Dinamik Blerje Bileta | 1 |
| | Modifikimet e kontratës | 14 |
| Shërbime | Procedura mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël | 2,893 |
| | Prokurim me vlerë të vogël | 6,006 |
| | Procedura me negocim pa shpallje paraprake | 50 |
| | Blerje nën vlerën 100.000 lekë | 6,923 |
| | Modifikimet e kontratës | 16 |
| | Sistem Dinamik Blerje Bileta | 362 |
| Totali Elementë të regjistrit | | 38,413 |

Nga monitorimi i përgatitjes së Elementeve të Regjistrit të Parashikimeve dhe Realizimeve në SPE në periudhën Janar-Dhjetor 2023, rezulton se janë **38,413** elementë të krijuar **në regjistër**, nga të cilët **34,822** elementë ose 90.7% e totalit kanë vijuar me procedurat, ndërsa **3,591** elemente ose 9.3% e totalit janë me statusin të anulluar.

Në formë grafike, të dhënat paraqiten si më poshtë vijon:




**Grafiku 3**

Nga analizimi i elementëve në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik, të cilët kanë vijuar me shpalljen e procedurave nga autoritetet kontraktore rezulton se **4,924** elementë janë me ndryshime. Ndryshimet në regjistrin e parashikimeve, janë tregues i performancës së Regjistrit të Parashikimeve.

Nëse do analizojmë vetëm Performancën e Regjistrit të Parashikimeve të shprehur në përqindje, rezulton se ato paraqiten në masën **14**%, matur si raport i elementëve të ndryshuar ndaj totalit të elementëve me statusin të pa anulluar (4,924/34,822 x 100).

**Tabela 3**

| Performanca e R egjistrave të Parashikimit | |
|---|---|
| **Janar - Dhjetor 2023** | **Numri i Elementëve** |
| **Total Numri i elementëve të Rregjistrit të Parashikimit të pa anulluar** | **34,822** |
| **Numri i elementeve të Rregjistrave të Parashikimit të Ndyshuara** | **4,924** |
| **Performanca ose % e elementëve të Ndryshuar (4,924/34,822 x 100)** | **14%** |

Krahasuar me vitin 2022, ku përqindja e zërave të regjistrit që kanë patur ndryshime ishte 15.23%, vihet re se kemi një rënie të këtij treguesi në 14%, duke treguar një performance më të mirë.

Në diagramën e mëposhtme paraqitet performanca e elementeve të regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit për periudhën Janar-Dhjetor 2023.




**Grafiku 4**

## 2.2. Statistika në lidhje me numrin e procedurave të prokurimit të shpallura gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2023 në Sistemin e Prokurimit Elektronik

Në këtë seksion paraqiten të dhënat e detajuara, lidhur me procedurat e prokurimit publik, përfshirë procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, procedurat me vlerë të vogël dhe sistemin dinamik të biletave **të zhvilluara gjatë periudh**ës Janar-Dhjetor 2023.

Në mënyrë të përmbledhur, të dhënat kryesore për procedurat mbi kufirin monetar për prokurimet me vlerë të vogël dhe procedurat negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, si dhe raportet në përqindje dhe fondi i kursyer në total, për periudhën Janar-Dhjetor 2023, paraqiten si më poshtë:

**Tabela 4**

| Procedura mbi kufirin monetar të blerjes së vogël dhe Procedura me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të zhvilluara për Periudhën Janar-Dhjetor 2023 | |
|---|---|
| Nr.Total i Procedurave/Loteve të shpallura ne SPE | 5,250 |
| Fondi limit total i shpallur në SPE | 134,365,187,814 |
| Nr.Total i Procedurave/Loteve të shpallura në SPE dhe të anulluara | 1,369 |
| Fondi limit i Procedurave/Loteve të shpallura ne SPE dhe të anulluara | 17,258,937,089 |
| Nr.Total i Procedurave/Loteve të shpallura në SPE dhe të vazhduara | 3,881 |
| Fondi limit i Procedurave/Loteve të shpallura në SPE dhe të vazhduara | 117,106,250,724 |
| % që zë fondi limit i procedurave të vazhduara ndaj fondit limit total të procedurave të shpallura. | 87.1% |

| | |
|---|---|
| **Numri Total i Procedurave të përfunduara me fitues** | **4,007** |
| **% që zë numri total i procedurave, të përfunduara me fitues ndaj totalit të procedurave.** | **76.3%** |
| **Fondi total limit i procedurave të përfunduara me fitues (vlera në lekë)** | **125,622,965,646** |
| **Fondi total i fituar (vlera në lekë)** | **111,769,899,062** |
| **% që zë fondi i fituar ndaj fondit limit total të shpallur në SPE** | **83.1%** |
| **Nr.Total i Procedurave të fituara Negocim pa shpallje** | **120** |
| **Fondi limit total për procedurat me negocim pa shpallje** | **3,463,677,562** |
| **Fondi total i fituar (vlera në lekë)** | **2,319,016,309** |
| **% që zë nr Total i procedurave me negocim pa shpallje paraprake, ndaj nr total të procedurave të përfunduara me fitues (procedura mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël +negocim pa shpallje)** | **2.9%** |
| **% që zë fondi i fituar për procedurat me negocim pa shpallje, ndaj fondit total të fituar të procedurave të përfunduara me fitues (procedura mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël +negocim pa shpallje)** | **2%** |
| **KURSIMI TOTAL** | |
| **% që zë Vlera totale e fituar ndaj Fondit total limit** | **84.9%** |
| **Vlera totale e kursyer në lekë pa TVSH** | **20,276,272,443** |
| **% që zë Vlera totale e Kursyer të procedurave të fituara ndaj Fondit total limit** | **15%** |

S
ikurse vërehet nga tabela e mësipërme, krahasuar me numrin total të procedurave të përfundura me fitues (procedura mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël + negocim pa shpallje), procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës përbëjnë **2.9% të tyre.**

Në çdo rast, sikundër rezulton nga të dhënat e analizuara, fondi i fituar për procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës (**2,319,016,309** lekë) është shumë më i ulët, krahasuar me fondin e fituar të procedurave të përfunduara me fitues (procedura mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël +negocim pa shpallje) (**114,088,915,371** lekë) duke zënë vetëm **2% të fondit total të fituar të procedurave të përfundura me fitues.**

Sa i takon kursimit, gjatë vitit 2023, konstatohet fakti se vlera totale e kursyer e procedurave të fituara ndaj fondit total limit shprehur në përqindje është **15%** dhe krahasuar me vitin e kaluar kjo vlerë është domethënëse më e lartë se në vitin 2022 (ku kjo vlerë ishte 8.4%) gjë që tregon rritje të efektivitetit në përdorimin e fondeve publike.

## 2.3. Statistika për Procedura mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël të zhvilluara në Sistemin e Prokurimit elektronik

Në këtë pjesë të analizës vjetore, do të pasqyrohen dhe interpretohen të dhënat mbi numrin e procedurave të prokurimit mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël, të cilat janë shpallur për t'u zhvilluar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Gjithashtu, në këtë pjesë do të pasqyrohen të dhënat respektive për numrin e njoftimeve të fituesve dhe numrin e njoftimeve të kontratave të nënshkruara dhe do të bëhet analiza e këtyre të dhënave.

### 2.3.1. Statistika sipas Tipit të kontratës

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të shpallura gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas tipit të kontratës, shërbim, mallra, punë, në faqen zyrtare të APP është **5,250** procedura.

Konkretisht, numri i procedurave të shpallura sipas tipit të kontratave paraqitet si më poshtë:

**Tabela 5**

| Njoftime Procedurash Janar - Dhjetor 2023 | | | |
|---|---|---|---|
| Lloji i Procedurës | Shërbime | Mallra | Punë Civile |
| Procedurë e hapur | 306 | 760 | 489 |
| E hapur mbi kufirin e lartë monetar | 203 | 261 | 16 |
| E Hapur e Thjeshtuar | 885 | 1763 | 431 |
| Shërbim Konsulence | 115 | - | - |
| Konkurs Projektimi | 7 | - | - |
| E kufizuar | 3 | 1 | - |
| E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar | 3 | - | - |
| E kufizuar për Rindërtimin | 6 | - | 1 |
| TOTAL | 1,528 | 2,785 | 937 |

Në formë grafike, këto njoftimet e procedurave sipas tipit të kontratës paraqiten si më poshtë:

## Njoftime Procedurash 2023 sipas Tipit të Kontratës




Grafiku 5

Nga analizimi i të dhënave për periudhën Janar - Dhjetor 2023 vërehet se, numrin më të madh të procedurave të shpallura e zënë procedurat për prokurimin e mallrave me 2,785 procedura të shpallura në total ose **53% të procedurave të shpallura, duke vijuar me procedurat për shërbimet** 1,528 procedurave të shpallura në total ose **29%** dhe të punëve publike 937 procedura të shpallura në total ose **18%.**

Përsa i përket vlerës **të procedurave të shpallura,** në formë grafike, përqindja e fondeve të procedurave të shpallura sipas tipit të kontratës paraqitet si më poshtë:

## Përqindja e fondeve të procedurave të shpallura sipas tipit të kontratës ndaj totalit




Grafiku 6

Sikurse vërehet nga grafiku i mësipërm, fondin më të lartë të procedurave të shpallura sipas tipit të kontratës e zë fondi i procedurave të tipit "Punë Publike" i cili zë **45.6% të fondit total të procedurave të shpallura, duke u pasuar nga procedurat e tipit "Mallra" me 27.3%** dhe "Shërbime" me **37.1%.**

## 2.3.2. Statistika sipas llojit të procedurës së prokurimit

Të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për periudh**ë**n Janar-Dhjetor 2023, si dhe fondet limite përkatëse, janë si më poshtë:

Tabela 6

| **Numri total i procedurave të shpallura të ndarë sipas llojit të procedurave për periudhën Janar – Dhjetor 2023** | | |
|---|---|---|
| **Lloji i procedurës** | **Nr procedura/lote** | **Fondi limit total** |
| **Procedurë e hapur** | **1,555** | **52,455,088,775** |
| **E hapur mbi kufirin e lartë monetar** | **480** | **67,804,540,314** |
| **E Hapur e Thjeshtuar** | **3,079** | **9,874,198,004** |
| **Shërbim Konsulence** | **115** | **2,343,284,055** |
| **Konkurs Projektimi** | **7** | **254,620,816** |
| **E kufizuar** | **4** | **32,598,656** |
| **E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar** | **3** | **1,386,424,517** |
| **E kufizuar per Rindërtimin** | **7** | **214,432,678** |
| **TOTAL** | **5,250** | **134,365,187,814** |

Sikurse vërehet në të dhënat e mësipërme numrin më të madh të procedurave e zë procedura "E Hapur e Thjeshtuar" me 3,079 procedura të shpallura ose **58.6% të numrit total të procedurave të shpallura pasuar nga procedura e hapur me 1,555 procedura të shpallura ose 29.6% të numrit total të tyre.**

Grafiku i mëposhtëm paraqet, përqindjen e numrit të procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, të zhvilluara në SPE **për per**iudh**ë**n Janar-Dhjetor 2023:




**Grafiku 7**

Tabela e mëposhtme paraqet, përqindjen e Fondit Limit të procedurave të prokurimit publik të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për periudhën Janar - Dhjetor 2023 detajuar sipas llojit:

Tabela 7

| Fondi Limit i Shpallur sipas llojit të procedurës Janar-Dhjetor 2023 | | |
|---|---|---|
| **Lloji i procedurës** | **Fondi limit total** | **% që zë fondi limit/totalit** |
| **Procedurë e hapur** | **52,455,088,775** | **39.04%** |
| **E hapur mbi kufirin e lartë monetar** | **67,804,540,314** | **50.46%** |
| **E Hapur e Thjeshtuar** | **9,874,198,004** | **7.35%** |
| **Shërbim Konsulence** | **2,343,284,055** | **1.74%** |
| **Konkurs Projektimi** | **254,620,816** | **0.19%** |
| **E kufizuar** | **32,598,656** | **0.02%** |
| **E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar** | **1,386,424,517** | **1.03%** |
| **E kufizuar për Rindërtimin** | **214,432,678** | **0.17%** |
| **TOTAL** | **134,365,187,814** | **100%** |

Sa i takon Fondit Limit të procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurave të zhvilluara për periudhën Janar-Dhjetor 2023, sikur vërehet nga të dhënat e mësipërme, përqindjen më të madhe e zë procedura "E hapur mbi kufirin e lartë monetar" me fond limit 67,804,540,314 lekë pa TVSH, ose 50.46% të Fondit Limit total të procedurave të shpallura, ndërkohë që numrin më të madh të procedurave e zë procedura "E Hapur e Thjeshtuar" me 3,079 procedura të shpallura.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet përqindja e fondit limit të procedurave përgjatë 2023 të ndara sipas llojit.




Grafiku 8

## 2.3.3. Statistika për procedurat e prokurimit të shpallura dhe të vazhduara gjatë vitit 2023, sipas 3 mujorëve

Në formë tabelare, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, të shpallura në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2023 dhe fondet limite përkatëse, sipas 3 mujorëve janë si më poshtë:

**Tabela 8**

| Statistika Publikime Procedura Prokurimi të vazhduara sipas 3 mujorëve Viti 2023 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emërtimi | Nr. Procedura / Lote Shpallura | Fondi limit Lekë pa TVSH | % Numrit të procedurave/ loteve të 3 mujorit ndaj totalit | % e Fondit Lim- it të 3 mujorit ndaj totalit |
| 1 | Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 mujori I-rë viti 2023 | 1,080 | 31,600,718,000 | 27.9% | 27% |
| 2 | Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 mujori II-të viti 2023 | 945 | 23,658,967,482 | 24.3% | 20.2% |
| 3 | Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 mujori III-të viti 2023 | 848 | 29,055,290,047 | 21.8% | 24.8% |
| 4 | Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 mujori IV-t viti 2023 | 1,008 | 32,791,275,196 | 26% | 28% |
| 5 | TOTALI | 3,881 | 117,106,250,724 | 100% | 100% |

Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, në tremujorin e I-rë dhe të IV-të, kemi numrin më të madh të procedurave të shpallura dhe të vazhduara që zënë 53.9 % të totalit. Po kështu, edhe fondi limit i procedurave të shpallura e të vazhduara në tremujorin e I-rë dhe të IV-të ka zënë 55 % të totalit. Numri i lartë i procedurave të shpallura gjatë tremujorit të I-rë, është tregues i performancës së lartë të Autoriteteve Kontraktore.

Numri i lartë i procedurave të shpallura në tremujorin e IV-të shpjegohet me faktin se në këtë periudhë fillojnë të shpallen edhe procedura të reja për vitin e ardhshëm buxhetor.

Rritja e konsiderueshme e procedurave të publikuara gjatë tremujorit të I-rë të vitit 2023 në 27.9% nga 14% që ka qenë në vitin 2022, tregon për rritjen e ndërgjegjësimit të Autoriteteve Kontraktore me qëllim publikimin në një kohë sa më të shpejtë të procedurave të prokurimit.

Kjo rritje është gjithashtu një tregues i rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të performancës së Autoriteteve Kontraktore, megjithatë ka ende nevojë për përmirësim në këtë drejtim.

Grafiku i mëposhtëm paraqet, përqindjen e procedurave të prokurimit publik të vazhduara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2023, sipas 3 mujorëve:




**Grafiku 9**

Grafiku i mëposhtëm paraqet publikimet e procedurave të prokurimit në Sistemin Elektronik të Prokurimeve për vitin 2023 sipas 6 mujorëve.




**Grafiku 10**

Sikurse vërehet nga grafiku, krahasuar me vitin 2022 ka një përmirësim në drejtim të publikimit të procedurave në gjashtëmujorin e parë të vitit nga 43.5% që ka qenë në 2022 në 52% të procedurave të publikuara gjatë gjysmës së parë të vitit.

### 2.3.4. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave për procedurat e prokurimit të shpallura gjatë vitit 2023, krahasuar me vitin 2022.

Për sa i përket, numrit të njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të shpallura, sipas tipit të kontratës për vitin 2023, krahasuar me vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

Tabela 9

| Krahasime Publikime Procedura mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël Viti 2023 me Vitin 2022 sipas Tipit të kontratës | | |
|---|---|---|
| **Viti** | **2022** | **2023** |
| Shërbime | 1,632 | 1,528 |
| Mallra | 3,706 | 2,785 |
| Punë | 1,156 | 937 |
| Numri Total i Procedurave | 6,494 | 5,250 |
| **Vlera totale Fondi limit** | **170,200,854,721** | **134,365,187,814** |

Sikurse vërehet nga tabela më sipër, gjatë vitit 2023 vihet re një ulje e numrit të procedurave krahasuar me vitin 2022 dhe si rrjedhin edhe një ulje e fondit limit përkatës përgjatë 2023 krahasuar me 2022.

Përsa i përket, numrit të njoftimeve për procedurat e prokurimit për vitin 2023, sipas llojit të procedurës krahasuar me vitin 2022 të dhënat paraqiten si më poshtë:

Tabela 10

| Numri i njoftimeve të procedurave mbi kufrin e procedurave me vlerë të vogël krahasimore viti 2023 me vitin 2022, sipas llojit të procedurës së prokurimit | | |
|---|---|---|
| **Lloji i procedurës** | **Viti 2022** | **Viti 2023** |
| **Procedurë e Hapur** | **1,642** | **1555** |
| **E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike** | **1** | **-** |
| **E Hapur mbi Kufirin e lartë monetar** | **843** | **480** |
| **E Hapur e Thjeshtuar** | **3,729** | **3079** |
| **Shërbim Konsulence+Konk.Projekt** | **98** | **122** |
| **E kufizuar** | **16** | **4** |
| **E kufizuar për Rindërtimin** | **141** | **7** |
| **E kufizuar mbi kufirin e lartë** | **20** | **3** |
| **E kufizuar mbi kufirin e lartë për Rindërtimin)** | **4** | **-** |
| **Numri i Procedurave** | **6,494** | **5,250** |
| **Vlera totale Fondi limit** | **170,200,854,721** | **134,365,187,814** |

Në mënyrë të detajuar, siç vihet re edhe nga tabela, për vitin 2023 rezultojnë të shpallura një numër më i vogël i procedurave (5,250), krahasuar me vitin 2022 ku janë shpallur (6,494).

Shprehur në vlerë, fondi limit i procedurave të shpallura për vitin 2023 (134,365,187,814 lekë pa TVSH), është konsiderueshëm më i ulët (21%) se fondi limit i procedurave të shpallura për vitin 2022 (170,200,854,721 lekë pa TVSH).

Në grafikun e mëposhtëm, paraqitet numri i procedurave të shpallura në mënyrë krahasimore sipas llojit të procedurës, respektivisht në vitin 2022 dhe 2023.




**Grafiku 11**

Përsa i përket të dhënave mbi vlerat e fondit limit për procedurat e shpallura në vitin 2023 krahasuar me vlerat e fondit limit për procedurat e shpallura në vitin 2022 sipas llojit të procedurës, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 11

| Vlerat e Fondit Limit të njoftimeve të procedurave mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël -Krahasime viti 2022 me vitin 2023, sipas llojit të procedurës së prokurimit | | |
|---|---|---|
| **Lloji i procedurës** | **Viti 2022** | **Viti 2023** |
| **Procedurë e Hapur** | **48,133,758,110** | **52,455,088,775** |
| **E hapur për Shërbimet Sociale dhe shër-bimet e tjera specifike** | **40,113,896** | **-** |
| **E Hapur mbi Kufirin e lartë monetar** | **81,464,153,241** | **67,804,540,314** |
| **E Hapur e Thjeshtuar** | **10,514,963,892** | **9,874,198,004** |
| **Shërbim Konsulence+Konk.Projekt** | **2,113,307,703** | **2,597,904,871** |
| **E kufizuar** | **3,574,219,674** | **32,598,656** |
| **E kufizuar për Rindërtimin** | **15,689,910,055** | **214,432,678** |
| **E kufizuar mbi kufirin e lartë** | **7,234,348,405** | **1,386,424,517** |
| **E kufizuar mbi kufirin e lartë për Rindër-timin** | **1,436,079,745** | **-** |
| **Vlera totale Fondi limit** | **170,200,854,721** | **134,365,187,814** |

Nga analiza e vlerave krahasuese të paraqitura në tabelën e mësipërme, vërehet se ulja e konsiderueshme e vlerës së fondit limit në vitin 2023, krahasuar me fondin limit në vitin 2022, vjen si pasojë e uljes së konsiderueshme të numrit dhe të vlerës së procedurave të prokurimit në kuadër të procesit të rindërtimit për pasojat e tërmetit të vitit 2019.

Nga ana tjetër, duhet mbajtur në vëmendje që procedurat për rindërtimin kanë natyrë të përkohshme dhe janë të dedikuara për një qëllim të caktuar dhe, si të tilla, ulja e numrit të tyre është e pritshme. Në grafikun e mëposhtëm, paraqiten numri i procedurave të shpallura në mënyrë krahasimore dhe vlerat e fondit limit, respektivisht për vitin 2022 dhe 2023.




Grafiku 12

Në tabelën e mëposhtme, paraqitet numri i procedurave të shpallura në mënyrë të detajuar,respektivisht në periudhën Janar – Dhjetor 2022 dhe Janar – Dhjetor 2023, sipas muajve.

**Tabela 12**

| Numri i Procedurave të Shpallura në Sistemin e Prokurimit Publik Janar-Dhjetor 2023 | | |
|---|---|---|
| **Viti** | **2022** | **2023** |
| **Janar** | 164 | 315 |
| **Shkurt** | 350 | 514 |
| **Mars** | 396 | 570 |
| **Prill** | 699 | 433 |
| **Maj** | 856 | 537 |
| **Qershor** | 529 | 403 |
| **Korrik** | 423 | 385 |
| **Gusht** | 758 | 345 |
| **Shtator** | 657 | 427 |
| **Tetor** | 594 | 667 |
| **Nentor** | 488 | 319 |
| **Dhjetor** | 580 | 335 |
| **Totali** | 6,494 | 5,250 |

Në grafikun e mëposhtëm, paraqitet publikimi i procedurave sipas muajve përkatës përgjatë 2023.




| | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2022 | 164 | 350 | 396 | 699 | 856 | 529 | 423 | 758 | 657 | 594 | 488 | 580 |
| 2023 | 315 | 514 | 570 | 433 | 537 | 403 | 385 | 345 | 427 | 667 | 319 | 335 |

**Grafiku 13**

Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, megjithëse numri më i madh i procedurave të shpallura për vitin 2023, rezulton në muajin Tetor, në total vërehet një numër më i lartë publikimesh të procedurave gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit dhe sidomos në muajt Shkurt, Mars dhe Maj, krahasuar me vitin 2022.

Pavarësisht se rezulton një numër i lartë i shpalljeve në muajin tetor, nga analiza e procedurave të shpalluara përgjatë gjithë vitit 2023, vihet re se një numër i konsiderueshëm i tyre (115 nga 667) janë procedura për Marrëveshje Kuadër, pra që lidhen me angazhime buxhetore të vitit 2024 e në vijim.

Në këtë kuptim, në përgjithësi vërehet një rritje e performancës së Autoriteteve Kontraktore duke pasur parasysh edhe faktin që, për shkak të specifikave të legjislacionit buxhetor dhe parashikimeve që lidhen me vitin ushtrimor, publikimi i procedurave të prokurimit në fund të vitit për vitin në vijim ose në fillim të vitit të ri buxhetor, krijon premisa për përdorim sa më efektiv të fondeve buxhetore.

## 2.4. Statistika sipas njoftimeve të fituesit

Në këtë pjesë të raportit, do të pasqyrohen të dhënat respektive në lidhje me publikimin e njoftimeve të fituesve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe do të bëhet analiza e këtyre të dhënave.

### 2.4.1. Statistika mbi numrin e njoftimeve të fituesve të shpallura gjatë vitit 2023, sipas tipit të kontratës

Nga të dhënat që gjenerohen nga SPE, konstatohet se numri total i njoftimeve të fituesit të procedurave të prokurimit të shpallura gjatë vitit 2023 në Sistemin e Prokurimit Elektronik, sipas tipit të kontratave, shërbim, mall, punë, është **4,007** në total.

Në formë tabelore, të dhënat për procedurat e prokurimit mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël, të ndara sipas tipit të kontratës të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues në SPE gjatë vitit 2023, janë si më poshtë:

**Tabela 13**

| Njoftimet e fituesve sipas tipit të kontratës<br>Janar- Dhjetor 2023 | | | |
|---|---|---|---|
| **Lloji i Procedurës** | **Shërbime** | **Mallra** | **Punë Civile** |
| **Procedurë e hapur** | **207** | **504** | **470** |
| **E hapur mbi kufirin e lartë monetar** | **126** | **218** | **16** |
| **E Hapur e Thjeshtuar** | **741** | **1259** | **354** |
| **Shërbim Konsulence** | **96** | **-** | **-** |
| **E kufizuar** | **4** | **2** | **2** |
| **E kufizuar mbi kufirin e lartë** | **3** | **3** | **-** |
| **E kufizuar për Rindërtimin** | **1** | **-** | **1** |
| **TOTAL** | **1,178** | **1,986** | **843** |

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se, numri më i lartë i procedurave të përfunduara me fitues është për kontratat e "Mallrave" me 1,986 fitues ose 49.5% të totalit të fituesve, më tej "Shërbime", me 1,178 fitues ose 29.5 % të totalit të fituesve, dhe"Punë publike", me 843 fitues ose 21 % të totalit të fituesve.

**Tabela 14**

| Fondi limit i procedurave të përfunduara me fitues sipas tipit të kontratës<br>Viti 2023 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shërbime** | | **Mallra** | | **Punë publike** | |
| **Lloji i Procedurës** | **Fondi limit njoftimefituesi** | **Lloji i Procedurës** | **Fondi limit njoftime fituesi** | **Lloji i Procedurës** | **Fondi limit njoftime fituesi** |
| **Procedurë e hapur** | **3,383,181,395** | **Procedure e Hapur** | **7,314,828,024** | **Procedure e Hapur** | **37,552,639,233** |
| **E hapur mbi kufirin e lartë monetar** | **22,091,180,377** | **E hapur mbi kufirin e lartë monetar** | **18,436,172,705** | **E hapur mbi kufirin e lartë monetar** | **23,297,483,775** |
| **E Hapur e Thjeshtuar** | **2,100,039,541** | **E Hapur e Thjeshtuar** | **4,134,826,531** | **E Hapur e Thjeshtuar** | **1,786,705,075** |
| **Shërbim Konsulence** | **2,467,782,443** | **Shërbim Konsulence** | **0** | **Shërbim Konsulence** | **0** |
| **E kufizuar** | **14,207,571** | **E kufizuar** | **28,340,820** | **E kufizuar** | **806,403,183** |
| **E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar** | **1,377,883,886** | **E kufizuar mbi Kufirin e lartë** | **804,284,623** | **E kufizuar mbi Kufirine lartë** | **0** |
| **E kufizuar per Rindërtimin** | **493,150** | **E kufizuar për Rindërtimin** | **0** | **E kufizuar për Rindërtimin** | **26,513,314** |
| **TOTALI** | **31,434,768,363** | **TOTALI** | **30,718,452,703** | **TOTALI** | **63,469,744,580** |

Sa i takon raportit në vlerë, sikurse vërehet nga tabela me sipër, vlera më e madhe është fituar në procedurat për "Punë Publike", ndjekur nga procedurat e prokurimit për mallra dhe më pas për shërbime.
Në grafikun e mëposhtëm jepet e shprehur në përqindje fondi limit i procedurave të fituara sipas tipit të kontratës.




**Grafiku 14**

## 2.4.2. Statistika mbi numrin e procedurave të përfunduara me fitues të shpallura gjatë vitit 2023, sipas llojit të procedurës së prokurimit

Tabela e mëposhtme paraqet procedurat e përfunduara me fitues gjatë vitit 2023 të ndara sipas llojit të procedurës, fondit limit të fituar dhe vlerës së fituar:

**Tabela 15**

| Të dhëna për procedurat e prokurimit të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues Janar - Dhjetor 2023 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Lloji procedurës | Nr | Fondi limit total Lekë pa TVSH | Fondi i Fituar Lekë pa TVSH | % që zë fondi i ofruar ndaj fondit limit të publikuar | Fondi i kursyer | % që zë fondi I kursyer ndaj fondit limit total |
| Procedurë e hapur | 1,181 | 48,250,648,652 | 41,197,967,153 | 85% | 7,052,681,499 | 15% |
| E hapur mbi kufirin e lartë monetar | 360 | 63,824,836,858 | 58,245,520,420 | 91% | 5,579,316,438 | 9% |
| E Hapur e Thjeshtuar | 2,354 | 8,021,571,147 | 7,049,003,433 | 88% | 972,567,714 | 12% |
| Shërbim Konsulence | 96 | 2,467,782,443 | 2,273,165,377 | 92% | 194,617,066 | 8% |
| E kufizuar | 8 | 848,951,574 | 815,123,161 | 96% | 33,828,412 | 4% |
| E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar | 6 | 2,182,168,509 | 2,165,511,246 | 99% | 16,657,262 | 1% |
| E kufizuar për Rindërtimin | 2 | 27,006,464 | 23,608,272 | 87% | 3,398,192 | 13% |
| TOTAL | 4,007 | 125,622,965,646 | 111,769,899,062 | 89.0% | 13,853,066,584 | 11.0% |

Sikundër vërehet nga të dhënat e mësipërme, vlera më e lartë e kursimit ndaj fondit limit të publi-

kuar, është tek “Procedura e Hapur”, që zë edhe përqindjen më të madhe prej 15% të vlerës totale të kursyer për procedurat mbi kufirin monetar për prokurime me vlerë të vogël e ndjekur nga procedura e kufizuar për rindërtim me 13% kursim.

Nga ana tjetër, sa i takon përqindjes së ulët të kursimit të fondit limit të evidentuar tek procedura “E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar” dhe “E Kufizuar” duhet theksuar se nëpërmjet këtyre procedurave janë fituar kryesisht Marrëveshje Kuadër me kohëzgjatje më shumë se një vit për implementimin e të cilave është e nevojshme zhvillimi i minikonkurseve nga ana e AK përgjegjëse në varësi të nevojave që ka gjatë gjithë kohëzgjatjes së MK.

Në këtë kuptim, vlera reale e marrëveshjes kuadër nuk mund të matet me të dhënat e një viti, por mund të përllogaritet vetëm në përfundim të afatit të saj të vlefshmërisë, duke përllogaritur edhe fondin e kursyer pas nënshkrimit të minikontratave.

Diagrama e mëposhtme paraqet, raportin në përqindje të numrit të procedurave të prokurimit publik, të përfunduara me fitues, të ndara sipas llojit të procedurës për vitin 2023.




**Grafiku 15**

Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme numrin më të madh të procedurave e zë procedura “E Hapur e Thjeshtuar” me 2,354 njoftime fituesish të publikuar ose 58.7% të numrit total të procedurave të përfunduara me fitues.
Ndërkohë, sikurse tregohet në grafikun e mëposhtëm, vlera më e madhe e fituar është në procedurën e hapur mbi kufirin e lartë monetar dhe e hapur.




**Grafiku 16**

### 2.4.3. Statistika mbi numrin e njoftimeve të fituesve të shpallura gjatë vitit 2022, krahasuar me vitin 2023

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, jepen të dhënat statistikore në lidhje me njoftimet e fituesve të 2022 krahasuar me 2023.

**Tabela 16**

| Krahasime Numri i Njoftimeve të Fituesve të publikuar në SPE për vitin 2022 me vitin 2023 | | |
|---|---|---|
| Viti | 2022 | 2023 |
| Numri i Procedurave | 4,507 | 4,007 |
| Vlera totale Fondi limit | 134,398,774,490 | 125,622,965,646 |
| Vlera totale e Fituar | 123,108,499,233 | 111,769,899,062 |

Në grafikun e mëposhtëm, jepen të dhënat statistikore në lidhje me njoftimet e fituesve të 2022 krahasuar me 2023.




**Grafiku 17**

Sikurse vërehet nga tabela dhe grafiku i mësipërm, numri i procedurave të përfunduara me fitues gjatë vitit 2023 (4007) është më i ulët se në 2022 (4507), sikurse edhe vlera e këtyre procedurave është më e ulët.

Nga ana tjetër, në tabelën e mëposhtme pasqyrohet në mënyrë krahasimore raporti ndërmjet procedurave të përfunduara me fitues ndaj numrit total të procedurave të shpallura për vitin 2022 dhe 2023.

**Tabela 17**

| Raporti i Procedurave të Fituara ndaj Procedurave të Shpallura 2022-2023 | | |
|---|---|---|
| Viti | 2022 | 2023 |
| Procedurat e përfunduara me fitues | 4507 | 4007 |
| Procedurat e Shpallura në SPE | 6494 | 5250 |
| Raporti në Përqindje | 69.40% | 76.30% |

Sikurse vërehet nga tabela, ky raport është dukshëm më i lartë në 2023 me 76.3% të procedurave të përunduara me fitues krahasuar me 2022 që është 69.4%, duke vënë edhe njëherë në dukje përmirësimin e performancës të autoriteteve dhe enteve kontraktore në përdorimin e fondeve publike.

Në formë grafike ky raport shprehet si më poshtë:




**Grafiku 18**

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, paraqitet numri i njoftimeve të fituesve të publikuar në SPE, në mënyrë të detajuar, respektivisht në periudhën Janar-Dhjetor 2022 dhe Janar –Dhjetor 2023, sipas muajve.

**Tabela 18**

| Krahasim i numrit të Njoftim Fituesve Publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik në periudhën Janar - Dhjetor 2022 me periudhën Janar - Dhjetor 2023 | | |
|---|---|---|
| **Viti** | **2022** | **2023** |
| **Janar** | **254** | **280** |
| **Shkurt** | **214** | **288** |
| **Mars** | **302** | **392** |
| **Prill** | **236** | **397** |
| **Maj** | **321** | **383** |
| **Qershor** | **471** | **324** |
| **Korrik** | **572** | **284** |
| **Gusht** | **409** | **277** |
| **Shtator** | **360** | **265** |
| **Tetor** | **468** | **311** |
| **Nentor** | **420** | **416** |
| **Dhjetor** | **480** | **390** |
| **Totali** | **4,507** | **4,007** |

Nga analiza e bashkërenduar e tabelave vihet re se, shpërndarja e njoftimeve të fituesit sipas muajve

reflekton shpërndarjen e shpalljes së procedurave.




**Grafiku 19**

Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, gjatë vitit 2023 numri më i madh i njoftimeve të fituesve është publikuar gjatë 6 mujorit të I-r**ë të vitit**, sidomos gjatë muajit Prill edhe si rezultat i numrit të lartë të procedurave të shpalluara në 3 muajt e par**ë të vitit siç u analizua më sipër.**

Gjithashtu, nga sa më sipër vërehet se, numri më i lartë i njoftimeve të fituesve është publikuar në muajin Nëntor 2023, duke reflektuar në këtë m**ë**nyrë edhe numrin më të madh të procedurave të shpallura që u shënua në muajin Tetor 2023.

Këto të dhëna janë tregues të performancës së sistemit të prokurimit në përgjithësi, që reflekton përmirësim të planifikimit të procedurave dhe realizimit të tyre në kohë duke ndjekur dhe reflektuar ritmin e shpalljes së procedurave, duke patur numër më të lartë në fillim të vitit dhe duke pësuar sërish rritje dy muajt e fundit të vitit ku reflektohet dhe zhvillimi i procedurave për vitin në vijim.

## 2.5. Statistika për kontratat e nënshkruara

Në këtë pjesë të raportit, do të pasqyrohen të dhënat respektive në lidhje me publikimin e njoftimeve të Kontratave të Nënshkruara dhe Marrëveshjeve Kuadër në SPE, si dhe do të bëhet analiza e këtyre të dhënave.

### 2.5.1. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2023, sipas Tipit të kontratës

Numri total i njoftimeve të kontratave të nënshkruara dhe marrëveshjet kuadër të procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2023 në sistemin e prokurimit elektronik publikuar në faqen zyrtare të APP është 3,750 në total.

Njoftimet e kontratave të nënshkruara, sipas llojit të procedurave dhe tipit të kontratave paraqiten si më poshtë:

**Tabela 19**

| Njoftime Kontratash të Nënshkruara për Periudhën Janar-Dhjetor 2023 | | | |
|---|---|---|---|
| Lloji i Procedurës | Shërbime | Mallra | Punë Publike |
| Procedurë e hapur | 164 | 474 | 448 |
| E hapur për Shërbimet Sociale | 1 | - | - |
| E hapur mbi kufirin e lartë monetar | 120 | 184 | 15 |
| E Hapur e Thjeshtuar | 723 | 1,162 | 358 |
| Shërbim Konsulence | 87 | - | - |
| E kufizuar | 2 | - | 5 |
| E kufizuar mbi kufirin e lartë mon-etar | 1 | - | - |
| E kufizuar per Rindërtimin | 4 | - | 2 |
| TOTAL | 1,102 | 1,820 | 828 |

Në diagramën e mëposhtme paraqitet numri i njoftimeve të kontratave të nënshkruara, të ndara sipas tipit të kontratës, të shpallura në SPE për vitin 2023, shprehur në përqindje.




**Grafiku 20**

Nga të dhënat e pasqyruara më sipër, rezulton se numri më lartë i kontratave të nënshkruara është tipi “Mallra” me 1,820 kontrata ose 49% të kontratave në total, më tej “Shërbime”, me 1,102 kontrata ose 29% të totalit, si dhe “Punë publike”, me 828 kontrata ose 22% të totalit.

Ndërkohë, më poshtë pasqyrohet raporti në vlerë i kontratave të nënshkruara sipas tipit të tyre.




**Grafiku 21**

Siç vihet re edhe nga grafiku, sa i takon vlerës, fondin limit më të lartë, kontratat e tipit “Punë Publike” me 52%, pasuar nga kontratat e tjera të tipit “shërbime” me 24.2% dhe “mallra” me 23.4%.

### 2.5.2. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave gjatë vitit 2023, sipas llojit të procedurës së prokurimit

Njoftimet e kontratave të nënshkruara sipas vlerës totale dhe llojit të procedurësparaqiten si më poshtë:

**Tabela 20**

| Të dhëna për Kontratat e Nënshkruara Janar - Dhjetor 2023 | | | |
|---|---|---|---|
| Llojet e procedurave | Numri i kontratave të nënshkruara | Fondi limit total i fituar (vlera ne Leke pa TVSH) | Vlera totale e fituar (Kontraktuar) (vlera në Lekë pa TVSH) |
| Procedurë e hapur | 1,086 | 41,809,027,600 | 36,181,093,026 |
| E hapur për Shërbimet Sociale | 1 | 40,113,896 | 38,080,000 |
| E hapur mbi kufirin e lartë monetar | 319 | 54,937,575,391 | 50,203,733,303 |
| E Hapur e Thjeshtuar | 2,243 | 7,727,416,564 | 6,832,724,429 |
| Shërbim Konsulence | 87 | 2,226,501,491 | 2,073,150,758 |
| E kufizuar | 7 | 1,787,885,196 | 1,612,989,809 |
| E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar | 1 | 41,459,369 | 41,096,516 |
| E kufizuar per Rindërtimin | 6 | 95,871,004 | 91,362,207 |
| TOTAL | 3,750 | 108,665,850,511 | 97,074,230,048 |

Siç vërehet nga të dhënat e analizuara në tabelat e mësipërme rezulton se, numri i kontratave, që rezulton 3,750 në total, është më i vogël se numri i njoftimeve të fituesve 4,007 në total, me një diferencë midis tyre prej 257 njoftimesh. Kjo diferencë shpjegohet me faktin se, pavarësisht përfundimit me fitues të procedurave, kontrata mund të mos jetë nënshkruar ende deri në datë 31 Dhjetor 2023, pasi janë procedura të zhvilluara për vitin në vijim.

Në tabelat e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për numrin e kontratave të nënshkruara si dhe mar-

rëveshjet kuadër në vitin 2023, fondin limit përkatës dhe vlerat e kontraktuara.

**Tabela 21**

| Statistika mbi kontratat e nënshkruara Janar-Dhjetor 2023 | | | |
|---|---|---|---|
| **Lloji i Kontratës** | **Numri i Kontratave** | **Fondi Limit Total** | **Fondi Total i Fituar** |
| **Marrëveshje Kuadër** | **939** | **25,853,667,601** | **22,938,364,176** |
| **Kontrata të Nënshkruara** | **2,811** | **82,812,182,911** | **74,135,865,872** |
| **TOTAL** | **3,750** | **108,665,850,512** | **97,074,230,048** |

Sikurse vërehet nga të dhënat e pasqyruara në tabelën e mësipërme, nga 3750 kontrata të nënshkruara në total për vitin 2023, 939 ose **25%** prej tyre janë për Marrëveshje Kuadër.

Sqarojmë, se kjo e dhënë llogaritet në bazë të loteve të prokuruara në SPE dhe njoftimeve të publikuara për secilin prej tyre.

### 2.5.3. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave dhe MK të nënshkruara gjatë vitit 2023, krahasuar me vitin 2022

Në tabelën e mëposhtëm, jepen të dhënat statistikore në lidhje me njoftimet e kontratave tënënshkruara dhe marrëveshjet kuadër për vitin 2022 krahasuar me vitin 2023.

**Tabela 22**

| Krahasimi i Kontratave të nënshkruara 2022 - 2023 | | |
|---|---|---|
| **Viti** | **2022** | **2023** |
| **Numri i Procedurave** | **3,992** | **3,750** |
| **Vlera totale Fondi Limit** | **111,357,310,340** | **108,665,850,511** |
| **Vlera totale e Fituar** | **103,646,865,355** | **97,074,230,048** |

Në grafikun e mëposhtëm, jepen të dhënat statistikore në lidhje me njoftimet e kontratave të nënshkruara dhe marrëveshjet kuadër për vitin 2022 krahasuar me vitin 2023.




**Grafiku 22**

Sa më sipër, vlen të theksohet fakti se në vitin 2023 janë nënshkruar 242 kontrata dhe marrëveshje kuadër më pak se në vitin 2022. Gjithashtu, fondi limit i kontratave të nënshkruara dhe marrëveshjet kuadër në vitin 2023 është më i ulët se në vitin 2022.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, paraqiten krahasimi i numrit të njoftimeve të kontratave dhe marrëveshjeve kuadër të nënshkruara, të shpallura në Sistemin e Prokurimit Elektronik, në mënyrë të detajuar, respektivisht për periudhën Janar-Dhjetor, viti 2022 me vitin 2023.

**Tabela 23**

| Krahasime Numri i njoftim i lidhjes së kontratës të shpallura në Sistemin e Prokurimit Elektronik Janar - Dhjetor 2022 me Janar - Dhjetor 2023 | | |
|---|---|---|
| **Viti** | **2022** | **2023** |
| **Janar** | **213** | **250** |
| **Shkurt** | **269** | **262** |
| **Mars** | **276** | **365** |
| **Prill** | **213** | **299** |
| **Maj** | **291** | **416** |
| **Qershor** | **312** | **323** |
| **Korrik** | **315** | **272** |
| **Gusht** | **403** | **270** |
| **Shtator** | **392** | **244** |
| **Tetor** | **415** | **302** |
| **Nentor** | **390** | **348** |
| **Dhjetor** | **503** | **399** |
| **Totali** | **3,992** | **3,750** |

Grafiku i mëposhtëm pasqyron publikimet e njoftimit të lidhjes së kontratës sipas muajve përgjatë 2023.




**Grafiku 23**

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se, numri më i madh i njoftimeve për lidhjen e kontratës është publikuar në 6 mujorin e parë të vitit dhe muajin Maj duke reflektuar edhe trendin e shpalljes së procedurave dhe publikimit të njoftimeve të fituesve.

Në këtë drejtim, vihet re që ka përmirësim krahasuar me vitin 2022, pasi ka rritje të numrit të kontratave të lidhura në muajt e parë të vitit, i cili është tregues i rritjes së performancës.

Nga ana tjetër, një trend rritës vihet re edhe në tremujorin e fundit të vitit, i cili shpjegohet me faktin e lidhjes së kontratave dhe marrëveshjeve kuadër për vitin pasardhës.

## 2.6 Marrëveshjet Kuadër

Gjatë vitit 2023, autoritetet kontraktore kanë vijuar të përdorin procedurat e prokurimit për Marrëveshje Kuadër, kryesisht për mallra dhe shërbime të vazhdueshme.

Konkretisht, të dhënat në lidhje me përdorimin e këtij instrumenti, paraqiten si më poshtë:

**Tabela 24**

| Procedura të shpallura në SPE për të lidhur MK Janar - Dhjetor 2023 | | |
|---|---|---|
| Lloji i procedurës | Nr. Procedura | Fondi limit total |
| Procedurë e hapur | 325 | 10,777,713,389 |
| E hapur mbi kufirin e lartë monetar | 157 | 27,929,319,851 |
| E Hapur e Thjeshtuar | 519 | 2,154,494,430 |
| Shërbim Konsulence | 5 | 312,684,539 |
| E kufizuar | 4 | 32,598,656 |
| E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar | 3 | 1,386,424,517 |
| E kufizuar për Rindërtimin | 6 | 210,722,892 |
| TOTAL | 1,019 | 42,803,958,274 |

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me procedurat e vazhduara të Marrëveshjeve Kuadër në sistem sipas tipit të kontratës për vitin 2023.

**Tabela 25**

| Procedura që kanë vazhduar SPE për MK Janar - Dhjetor 2023 | | |
|---|---|---|
| Tipi i Kontratës | Nr. procedura | Fondi limit total |
| Shërbime | 292 | 14,376,602,830 |
| Mallra | 438 | 17,178,080,147 |
| Punë Civile | 16 | 4,098,677,306 |
| TOTAL | 746 | 35,653,360,283 |

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me procedurat e vazhduara me Marrëveshje Kuadër për vitin 2022, krahasuar me procedurat e vazhduara me Marrëveshje kuadër të vitit 2023.

**Tabela 26**

| Krahasime Publikime Marrëveshje Kuadër të vazhduara Janar - Dhjetor | | |
|---|---|---|
| **Viti** | **2022** | **2023** |
| **Numri i Procedurave** | **763** | **746** |
| **Vlera totale Fondi limit** | **56,651,491,617** | **35,653,360,283** |

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat krahasuese të vitit 2023, me të dhënat e vitit 2022, respektivisht në numër dhe në vlerë.




**Grafiku 24**

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me shpalljet me Marrëveshje Kuadër të finalizuara me njoftim fituesi në sistem për vitin 2023.

**Tabela 27**

| Procedura prokurimi për Marrëveshje Kuadër të përfunduara me fitues Janar - Dhjetor 2023 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Llojet e procedur-ave** | **Nr Total i Proce-durave** | **Fondi limit total i prokuruar (vlera në Lekë)** | **Fondi total i ofruar (Tenderuar) (vlera në Lekë)** | **% që zë fon-di i ofruar ndaj fondit limit të prokuruar** | **Fondi total i kursyer (vlera në Lekë)** | **% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit të proku-ruar** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Procedurë e hapur** | **249** | **8,753,529,258** | **7,073,935,894** | **80.81%** | **1,679,593,364** | **19.19%** |
| **E hapur mbi kufirin e lartë monetar** | **115** | **22,606,630,210** | **20,297,667,904** | **89.79%** | **2,308,962,307** | **10.21%** |
| **E Hapur e Thjeshtuar** | **381** | **2,012,685,830** | **1,698,934,776** | **84.41%** | **313,751,054** | **15.59%** |
| **Shërbim Konsulence** | **10** | **1,079,280,322** | **964,163,490** | **89.33%** | **115,116,832** | **10.67%** |
| **E kufizuar** | **5** | **42,548,391** | **41,745,243** | **98.11%** | **803,148** | **1.89%** |
| **E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar** | **5** | **2,182,168,509** | **2,165,511,246** | **99.24%** | **16,657,262** | **0.76%** |
| **E kufizuar per Rindërtimin** | **2** | **27,006,464** | **23,608,272** | **87.42%** | **3,398,192** | **12.58%** |
| **TOTAL** | **767** | **36,703,848,983** | **32,265,566,825** | **87.91%** | **4,438,282,159** | **12.09%** |

Diferenca midis numrit të procedurave të shpallura me ato të përfunduara me njoftim fituesi në sistem, shpjegohet me argumentin se shumë procedura të shpallura në vitin 2023, vijojnë me shpalljen e fituesit apo me lidhjen e Marrëveshjeve Kuadër në vitin pasardhës.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me Marrëveshje Kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në sistem për vitin 2022, krahasuar me Marrëveshje Kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në sistem për vitit 2023.

**Tabela 28**

| Viti | 2022 | 2023 |
|---|---|---|
| **Numri i Procedurave** | **740** | **767** |
| **Vlera totale Fondi limit** | **59,310,160,580** | **36,703,848,983** |
| **Vlera totale e Prokuruar** | **55,040,750,642** | **32,265,566,825** |

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme, rezulton se numri total i procedurave Marrëveshje Kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në sistemin e prokurimit elektronik është 767 (27 procedura Marrëveshje Kuadër më shumë krahasuar me vitin 2022 ku ishin 740 procedura përfshi edhe procedurat për tërmetin).

Numri më i lartë procedurave marrëveshje kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në raport me numrin e procedurave të shpallura shpjegohet me faktin se ato mund të jenë shpallur si procedura në vitin 2022 dhe të kenë përfunduar me fitues në 2023.

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat krahasuese të vitit 2022, me të dhënat e vitit 2023, respektivisht në numër dhe vlerë.




**Grafiku 25**

Përsa i përket minikontratave të nënshkruara në bazë të Marrëveshjeve Kuadër, të aplikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik gjatë vitit 2023, rezultojnë 3700 në total.

**Tabela 29**

| Minikontrata të referuara nga shpalljet në Sistem | | | |
|---|---|---|---|
| 2022 | | 2023 | |
| Numri i Minikontratave | Vlera e Minikontratave | Numri i Minikontratave | Vlera e Minikontratave |
| 4,038 | 85,526,757,960 | 3,700 | 11,368,529,555 |

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen të dhënat mbi Marrëveshjet Kuadër të fituara që nga viti 2015.

Siç vërehet nga grafiku, që prej vitit 2018 kemi një rritje të numrit të Marrëveshjeve Kuadër dhe gjatë tre viteve të fundit kurba e rritjes së marrëveshjeve kuadër është konstante.




**Grafiku 26**

Duke pasur parasysh që legjislacioni i prokurimit publik parashikon mundësinë e zhvillimit të marrëveshjeve kuadër me afat deri në 4 vjet, përdorimi i këtij mjeti nga ana e autoriteteve kontraktore mund të konsiderohet si një nga faktorët që ka ndikuar në uljen e numrit total të procedurave të shpallura, duke qenë se në vitet e fundit një pjesë e mirë e nevojave të AK-ve mbulohen nëpërmjet këtyre marrëveshjeve.

## 2.7. Të dhëna mbi procedurat e prokurimit te kryera gjate vitit 2023 në kuadërtë procesit të rindërtimit për shkak të Tërmetit të datës 26 Nëntor 2019

Në mbështetje të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", edhe gjatë vitit 2023 autoritetet kontraktore përgjegjës (njësitë zbatuese), kanë zhvilluar procedurate prokurimit për përzgjedhjen e fituesve të marrëveshjes kuadër për procesin e rindërtimit në sistemin e prokurimit publik.

Nga të dhënat e analizuar nga sistemi i prokurimit elektronik, rezulton se:

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të shpallura gjatë vitit 2023 në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe në buletinet e posaçme në faqen zyrtare të APP, në kuadër të procesit të rindërtimit për shkak të Tërmetit të datës 26 Nëntor 2019,sipas tipit të kontratës, shërbim, mallra, punë është 7 procedura me fond limit 214,432,678 lekë pa TVSH.

Njoftimet e kontratave për procedurat e prokurimit në kuadër të procesit të rindërtimit janë publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, por gjithashtu, janë publikuar edhe në Buletinet e Posaçme të shpallurapër vitin 2023.

Numri i procedurave të publikuara gjatë vitit 2023 sipas tipit të kontratave paraqitet si më poshtë:

**Tabela 30**

| Njoftime Procedurash të publikuara- Viti 2023 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Shërbime | | Mallra | | Punë publike | |
| Lloji i Procedurës | Numri i njoftimeve procedura | Lloji i Procedurës | Numri i njoftimeve procedura | Lloji i Procedurës | Numri i njoftimeve procedura |
| E kufizuar për Rindërtimin | 6 | E kufizuar për Rindërtimin | - | E kufizuar për Rindërtimin | 1 |
| TOTALI | 6 | TOTALI | - | TOTALI | 1 |

Në tabelën e mëposhtme paraqitet fondi limit total për procedurat e publikuara sipas tipit të kontratave:

**Tabela 31**

| Fondi limit total | | | Tipi i kontratës | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Lloji i procedurës | Nr procedura /lote | Fondi limit total | Shërbime | Mallra | Punë publike |
| E kufizuar për Rindërtimin | 7 | 214,432,678 | 5,624,076 | | 208,808,602 |
| TOTALI | 7 | 214,432,678 | 5,624,076 | | 208,808,602 |

Nga të dhënat e mësipërme, vërehet se numri më i madh i procedurave për rindërtimin është për

shërbime gjë që shpjegohet me faktin e lidhjes së kontratave të mbikqyrjes dhe kolaudimit për punët e kryera gjatë 2022 dhe 2023. Ndërkohë, sa i takon vlerës, vlera me e madhe është për kontratat e punëve publike.

## 2.8. Statistika mbi kriteret e parashikuara nga ligji për vlerësimin e ofertës fituese për procedurat të finalizuara me njoftim fituesit gjatë 2023

APP ka analizuar përdorimin e kriterit të vlerësimit, duke përcaktuar si kriter bazë "oferta ekonomikisht e favorshme", e cila mund të identifikohet në bazë të çmimit (çmimi më i ulët) ose në bazë të kostos (bazuar në raportin çmim-cilësi).
Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 APP ka analizuar se cilin nga dy kriteret e parashikuara nga ligji, kanë përdorur AK-të për vlerësimin e ofertës fituese. Të dhënat e kësaj analize pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 32**

| STATISTIKA MBI KRITERIN E VLERËSIMIT TË OFERTAVE JANAR - DHJETOR 2023 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Emërtimi** | **Nr. Procedura / Lote** | **Fondi limit Lekë pa TVSH** | **Fondi Fituar Lekë pa TVSH** | **% Numrit të procedurave përkatëse ndaj totalit** | **% Fondit Limit përkatës ndaj totalit** | **% e vlerës përkatëse të fituar ndaj totalit** |
| **Procedura të fituara me oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në Kosto Janar-Dhjetor 2023** | **143** | **25,989,285,470** | **22,727,415,139** | **3.57%** | **20.69%** | **20.33%** |
| **Procedura të fituara bazuar në ofertat me çmimin më të ulët Janar-Dhjetor 2023** | **3,864** | **99,633,680,176** | **89,042,483,924** | **96.43%** | **79.31%** | **79.67%** |
| **TOTALI** | **4,007** | **125,622,965,646** | **111,769,899,062** | **100%** | **100%** | **100%** |

Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, sa i takon numrit të procedurave të fituara për të cilat është përdorur oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto, rezulton se kjo metodë vlerësimi ëhstë përdorur në 143 procedura gjatë vitit 2023. E shprehur në përqindje ky numër përbën 3.57% të numrit të procedurave ndaj totalit të procedurave.

Nga ana tjetër, theksojmë se në vlerë, në raport me fondin total të fituar këto procedura përbëjnë 20.33%

të procedurave të fituara.

**Tabela 33**

| Lloji i procedurave me oferta ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto për vitin 2023 | |
|---|---|
| **Lloji i procedurës** | **Numri i procedurave** |
| **Shërbim konsulence** | **89** |
| **E hapur mbi kufirin e lartë monetar** | **8** |
| **E hapur** | **39** |
| **E hapur e thjeshtuar** | **2** |
| **E kufizuar për Rindërtimin** | **2** |
| **E kufizuar** | **2** |
| **E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar** | **1** |
| **Totali** | **143** |

Sikurse vërehet në tabelën e mësipërme numrin më të lartë të procedurave në të cilat si metodë vlerësimi është zgjedhur "Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto" e përbëjnë procedurat "E hapur" dhe "Shërbim konsulence".

Duhet theksuar fakti se, krahasimisht me vitin 2022, ka një ulje të përdorimit të kriterit të vlerësimit të ofertave bazuar në kosto për faktin sepse gjatë 2023 ka pasur një ulje të ndjeshme të procedurave lidhur me procesin e rindërtimit, procedura në të cilat përdorej vetëm kriteri i vlerësimit "Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto".

Për sa më sipër, nevojitet rritje e ndërgjegjësimit dhe angazhimit nga ana e autoriteteve kontraktore me qëllim përdorimin e këtij kriteri vlerësimi duke pasur parasysh që ai shërben njëkohësisht edhe për të garantuar vlerën në para.

## 2.9. Statistika mbi numrin e anullimeve të procedurave të prokurimit mbi kufirin monetar për procedurën më vlerë të vogel gjatë 2023

Sikundër rezulton nga analiza e mësipërme, numri total i procedurave të anulluara pas publikimit të tyre në SPE për vitin 2023 është 1369 duke pësuar ulje të konsiderueshme krahasuar me 2022 ku ky numër ishte 1815.

Sipas arsyetimeve të kryera në sistemin e prokurimit elektronik, nga vetë autoritetet kontraktore në lidhje me anullimet për procedurat e shpallura pas publikimit sipas arsyeve ligjore të përcaktuar në legjislacion situata paraqitet si më poshtë:

**Tabela 34**

| Arsyeja e Anullimit të deklaruar në SPE | Raporti në % mbi totalin e procedurave të anulluara |
|---|---|
| Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP | 5% |
| Nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza | 6% |
| Nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë | 61% |
| Për shkak se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme | 19% |
| Për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar | 7% |
| Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021 | 2% |
| Totali | 100% |

Nga analizimi i të dhënave rezulton se, numri më i madh i anullimeve është bërë me arsyetimin *"Nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë"*, të cilat zënë rreth 61% të procedurave të anulluara.

Nga ana tjetër, vihet re një rritje e procedurave të anulluara nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik nga 3% që ka qenë në 2022 në 5% të anullimeve.

Po kështu vlen për t'u theksuar që është rritur gjithashtu edhe numri i anullimeve nga ana e titullarit të AK për arsye që lidhen me identifikimin e situatave të konfliktit të interesit apo të konstatimit nga ana e KVO të kritereve të hartuara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi duke dëshmuar për rritjen e përgjegjshmërisë të AK-ve gjatë procesit të prokurimit.

Në formë grafiku, të dhënat për arsyet e anullimit paraqiten si më poshtë:




**Grafiku 27**

## 2.10. Të dhëna mbi procedurat e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

Procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sikurse parashikuar në nenin 47 të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" mund të përdoret nga Autoritetet Kontraktore për plotësimin e nevojave të tyre vetëm në raste përjashtimore, në rrethana të veçanta dhe vetëm nëse plotësohen kushtet e parashikuara në këtë nen.

Kjo procedurë prokurimi zhvillohet me mjete elektronike në përputhje me nenin 17 të ligjit 162/2020 dhe VKM Nr. 384, datë 30.06.2021 "Për formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik".

Në këtë seksion analizohet në mënyrë të detajuar përdorimi i kësaj lloj procedure në vitin 2023 në raport me procedurat e tjera si edhe në raport me vitet e tjera.

Konkretisht, sikurse rezulton nga të dhënat e SPE, numri total i procedurave të prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, të fituara gjatë vitit 2023 është 120 ose 2.9%, i numrit total të procedurave të përfunduara me fitues (procedura mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël+negocim pa shpallje), pra vërehet një ulje e numrit të procedurave në krahasim me vitin 2022.

Në vlerë absolute, numri i procedurave negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për vitin 2023 është më i ulti krahasuar me numrin e këtyre procedurave ndër vite duke filluar nga 2010.

Në grafikun e mëposhtëm jepen të dhënat krahasimore të numrit të procedurave të fituara me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës (**120 procedura**) ndaj numrit total të procedurave të prokurimit të përfunduara me fitues (**4,127 procedura**) (procedura mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël +negocim pa shpallje).




**Grafiku 28**

Ndërkohë sa i përket vlerës së fituar me procedurën me negociim pa shpallje, kjo vlerë është 2% në raport me vlerën totale të fituar (procedura mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël +negocim pa shpallje).

Grafiku i mëposhtëm paraqet në përqindje fondin e prokuruar që zënë këto lloj procedurash në raport me fondin total.




**Grafiku 29**

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

**Tabela 35**

| Negocime Krahasime Janar - Dhjetor | | |
|---|---|---|
| **Viti** | **2022** | **2023** |
| **Numri i Procedurave** | **157** | **120** |
| **Vlera totale Fondi limit** | **1,273,811,249** | **3,463,677,562** |
| **Vlera totale e Fituar** | **1,261,433,790** | **2,319,016,309** |

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës të detajuar sipas tipit të kontratës, për vitin 2023.

**Tabela 36**

| Tipi i Kontratës | Nr | Fondi limit | Fondi Fituar |
|---|---|---|---|
| **Shërbime** | **41** | **2,185,386,949** | **1,064,904,624** |
| **Mallra** | **73** | **1,260,257,125** | **1,236,202,237** |
| **Punë Civile** | **6** | **18,033,488** | **17,909,448** |
| **TOTAL** | **120** | **3,463,677,562** | **2,319,016,309** |

Të dhënat në lidhje me numrin e procedurave të fituara me negocim pa shpallje paraprake të realizuara sipas muajve për vitin 2023, paraqiten si më poshtë:

**Tabela 37**

| Njoftime fituesish për procedurat me negocim pa shpallje paraprake Janar - Dhjetor 2023 | | | |
|---|---|---|---|
| **Muaji** | **Numri i procedurave** | **Fondi limit pa TVSH** | **Vlera e kontratës pa TVSH** |
| Janar | 2 | 3,776,532 | 3,764,033 |
| Shkurt | 8 | 209,761,547 | 208,450,452 |
| Mars | 15 | 1,584,733,393 | 1,546,653,311 |
| Prill | 7 | 135,676,742 | 132,304,493 |
| Maj | 6 | 23,824,442 | 23,003,892 |
| Qershor | 7 | 55,948,031 | 54,378,545 |
| Korrik | 7 | 11,954,017 | 11,857,534 |
| Gusht | 1 | 65,500,000 | 65,100,000 |
| Shtator | 7 | 1,132,760,648 | 36,483,195 |
| Tetor | 18 | 171,912,771 | 169,597,643 |
| Nëntor | 26 | 48,411,320 | 48,126,592 |
| Dhjetor | 16 | 19,418,119 | 19,296,620 |
| TOTAL | 120 | 3,463,677,562 | 2,319,016,309 |

Sikundër vihet re nga tabela e mësipërme, vlera më e madhe e fituar në procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për vitin 2023 shënohet në muajim Mars gjë që shpjegohet me procedurat e zhvilluara nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për efekt të procesit zgjedhor të vitit 2023.

Sa i takon rasteve të përdorimit të procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, nisur nga arsyet e deklaruara nga autoritetet kontraktore në SPE situata paraqitet në tabelën më poshtë:

**Tabela 38**

| Rastet e Përdorimit të Procedurave me Negocim pa Shpallje<br>Janar-Dhjetor 2023 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Arsyetimi | Nr. i Procedurave të fituara me Negocim pa Shpallje | % që zenë Rastet e Përdorimit të ndaj Totalit Negocim pa shpallje | Fondi Limit | Fondi i Fituar |
| **Kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje, ose kur ofertat apo kërkesat për pjesëmarrje të dorëzuara kanë qenë të papërshtatshme (LPP 47/1/a)** | **2** | **2%** | **10,856,532** | **10,851,034** |
| **Kur punët, mallrat apo shërbimet mund të ofrohen vetëm nga një operator ekonomik i caktuar (e drejtë autori/pronësi intelektuale/mungesë konkurrence) (LPP 47/1/b)** | **55** | **46%** | **255,656,607** | **254,685,605** |
| **Kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga AK/EK, afatet kohore për procedurat e tjera nuk mund të respektohen (LPP 47/1/c)** | **58** | **48%** | **3,134,944,437** | **1,991,453,696** |
| **Kur produktet e përfshira janë prodhuar vetëm për arsye kërkimi, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi. (LPP 47/2/a)** | **5** | **4%** | **62,219,986** | **62,025,974** |
| **TOTALI** | **120** | **100%** | **3,463,677,562** | **2,319,016,309** |

Nga analiza e të dhënave të pasqyruara në tabelë, rezulton se numri dhe vlera më e madhe e procedurave me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për vitin 2023 janë zhvilluar për arsye të nevojës ekstreme dhe rrethanave të paparashikueshme nga ana e AK, ndërkohë që, për arye të mungesës të kërkesave për pjesëmarrje apo ofertave apo paraqitjes së kërkesave për pjesëmarrje dhe ofertave të papërshtatshme në dy procedura të njëpasnjëshme kemi vetëm 2 raste të përdorimit të kësaj procedure.

Në formë grafiku këto të dhëna paraqiten si më poshtë:




**Grafiku 30**

Nga analizimi në kontekstin historik të të dhënave mbi numrin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, rezulton se ky numër për 5 vitet e fundit (2018-2023) është ulur në mënyrë drastike krahasuar me periudhën paraardhëse që nga viti 2010.




**Grafiku 31**

Vlen të theksohet se, minimizimi i rasteve të përdorimit të procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës gjatë 5 viteve të fundit, është rezultat i punës, ndërgjegjësimit dhe monitorimit të autoriteteve kontraktore nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Ky ndryshim pozitiv ka ardhur edhe si rezultat i automatizimit të procesit, duke e zhvilluar procedurën në SPE, duke filluar që nga krijimi i regjistrit, njoftimi i Operatorëve Ekonomikë, ofertimi, vlerësimi, dërgimi i mesazheve për kualifikimin, shpalljen e fituesit dhe publikimin online të njoftimit të lidhjes së kontratës.
Zhvillimi i kësaj procedure prokurimi në sistemin e prokurimit elektronik, që nga pasqyrimi në zërin përkatës të regjistrit të parashikimeve, ku autoritet kontraktore duhet të përshkruajnë edhe arsyet që detyrojnë përzgjedhjen e kësaj procedure sipas kushteve ligjore, ka rritur përgjegjësinë e këtyre të fundit në këtë drejtim.

Gjithashtu, ndikim kanë patur edhe rekomandimet dhe njoftimet e vazhdueshme nga Agjencia e Prokurimit Publik që të merren masat për publikimin e procedurave konkuruese në kohë, mundësisht Marrëveshje Kuadër për shërbime/mallra të vazhdueshme, pikërisht që autoritet kontraktore të mos gjenden pa shërbim/mall në fillim vitit.

## 2.11. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

Sipas parashikimeve në legjislacionin e prokurimit, Autoritetet Kontraktore përdorin procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për të blerë mallra, shërbime dhe punë, vlera e përllogaritur e të cilave gjatë gjithë vitit kalendarik është nga 100.000 lekë deri në 1.000.000 lekë pa t.v.sh.

Nga analizimi i të dhënave, rezulton se numri i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara gjatë vitit 2023 dhe fondet përkatëse, paraqiten si më poshtë:

**Tabela 39**

| Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël Janar-Dhjetor 2023 | |
|---|---|
| **Numri Total i procedurave të Prokurimit me Vlerë të Vogël të shpallura per vitin 2023** | **16,391** |
| **Fondi total limit i publikuar për procedurat e prokurimit me Vlerëtë Vogël (vlera në lekë)** | **6,596,242,471** |
| **Numri Total i procedurave të Prokurimit me Vlerë të Vogël të përfunduara me njoftim fituesi** | **12,574** |
| **Fondi total Limit për procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogëltë përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)** | **5,185,361,534 3** |
| **Vlera totale e fituar në procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogëltë përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)** | **4,375,990,315** |
| **% që zë vlera totale e fituar ndaj Fondit total limit të procedavetë përfunduara me fitues** | **84.4%** |
| **Fondi total i kursyer (vlera në lekë)** | **809,371,218** |
| **% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit total limit të procedurave tëpërfunduara me fitues** | **15.6%** |

Numri dhe vlerat e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara gjatë vitit 2023 krahasuar me ato të vitit 2022, paraqiten në tabelën më poshtë.

**Tabela 40**

| Procedura Prokurime me Vlerë të Vogël perfunduara me Fitues Krahasime Viti 2023 me Vitin 2022 | | |
|---|---|---|
| **Viti** | **2022** | **2023** |
| **Numri i Procedurave prokurim me vlerë të vogël** | **12,400** | **12,574** |
| **Vlera totale Fondi limit** | **4,925,155,213** | **5,185,361,534** |
| **Vlera e Fituar** | **4,272,218,663** | **4,375,990,315** |
| **Vlera e kursyer** | **652,936,550** | **809,371,218** |

Po të krahasojmë numrin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të përfunduara me fitues në vitin 2023 (12,574), me numrin respektiv në vitin 2022 (12,400), rezulton se gjatë vitit 2023 në numër janë përfunduar më shumë procedura me fitues.

Një tregues tjetër shumë i rëndësishëm që rezulton nga të dhënat në tabela, është diferenca midis fondit me të cilin janë shpallur procedurat, me vlerën me të cilin janë fituar ato dhe konkretisht kursimi është 15.6%.Gjithashtu, kursimi në vlerë absolute 809,371,218 lekë i realizuar në vitin 2023, është më i lartë se kursimi prej 652,936,550 lekë i realizuar në vitin 2022.

Këto të dhëna tregojnë se nga përmirësimet e herëpasherëshme që i bëhen kësaj procedure në SPE, sigurohet konkurueshmëri e lartë dhe e drejtë, duke sjellë në vemendje se kjo është e vetmja procedurë ku nuk shfaqet fondi limit, me qëllimin për të synuar ofertën sa më të përgjegjshme nga operatorët ekonomikë.

## 2.12 Statistika në lidhje me procedurat e krijuara në sistemin elektronik

Numri total i procedurave të prokurimit të vijuara me fitues, duke përfshirë edhe prokurimet me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronik për vitin 2023, është 16,701, të detajuara sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela 41**

| Lloji i procedurës | Numri Total i Procedurave/ lote të elektroniketë përfunduara me fitues | Vlera totale e fituar në procedurat e prokurimit të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë) |
|---|---|---|
| **Procedura Prokurimi konkurruese mbi kufirinmonetar për proceduratme vlerë të vogël** | **4,007** | **111,769,899,062** |
| **Prokurimit me Vlerë tëVogël** | **12,574** | **4,375,990,315** |
| **Procedura me Negocim pa Shpallje** | **120** | **2,319,016,309** |
| **Totali** | **16,701** | **118,464,905,686** |

Në diagramën e mëposhtme tregohet raporti i numrit të prokurimeve me vlerë të vogël, ndaj procedurave të prokurimit mbi kufirin monetar për procedurat me vlerë të vogël ku, sikurse del edhe nga treguesit e analizuar më sipër, del qartë numri që zënë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël ndaj procedurave të tjera.




**Grafiku 32**

Ndërkohë raporti në vlerë rezulton në të kundërt, ku fondi i procedurave me vlerë të vogël zë vetëm 3.7% të të gjithës fondit të fituar.




**Grafiku 33**

## 2.13 Sistmi dinamik blerje bileta transporti ajror ndërkombëtar

Autoritetet kontraktore përdorin Sistemin e thjeshtuar Dinamik të Blerjeve, si një mënyrë për të siguruar blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar. Ky sistem është i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë, që janë të regjistruar në sistemin e prokurimit elektronik dhe që kanë si objekt të ushtrimit të aktivitetit të tyre, shërbimin e transportit ajror ndërkombëtar.

Sikurse është parashikuar në udhëzimin përkatës të APP, autoritetet kontraktore kanë zbatuar procedurën, duke marrë në konsideratë për realizimin e shërbimit të gjithë operatorët ekonomikë të kualifikuar.

Nga analizimi i të dhënave, numri i procedurave të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar të zhvilluara gjatë vitit 2023 dhe fondet përkatëse, krahasuar me 2022 paraqitet si më poshtë:

**Tabela 42**

| Krahasime Sistemi dinamik blerje bileta të transportit ajror ndërkombëtar | | |
|---|---|---|
| **Viti** | **2022** | **2023** |
| **Numri Total i procedurave blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar** | **2,254** | **2,831** |
| **Numri Total i Procedurave të papërfunduara (anulluar, etj)** | **290** | **303** |
| **Numri Total i procedurave blerje e biletave të cilat kanëpërfunduar me fitues** | **1,959** | **2,524** |
| **Vlera totale e fituar në procedurat blerje e biletave të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)** | **302,460,125** | **371,001,881** |

Siç vihet re, numri i procedurave blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar të shpallur për vitin 2023, është më i madh krahasuar me vitin 2022, konkretisht kemi 577 procedura më shumë.




**Grafiku 34**

Grafiku i mëposhtëm paraqet raportin shprehur në përqindje të numri të procedurave të përfunduara me fitues për vitin 2023.




**Grafiku 35**

Grafiku i mëposhtëm paraqet raportin shprehur në përqindje të fondit të prokuruar të procedurave të përfunduara me fitues për vitin 2023.




**Grafiku 36**

Sikurse tregohet nga grafikët e mësipërm, në raportin në vlerë % më të madhe e zenë procedurat me vlerë mbi kufirin monetar (91.3%), ndërkohë që në raportin në numër procedurash % më të madhe e zenë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël (65%).

## 2.14. Statistika në lidhje me Autoritet Kontraktore që kanë krijuar procedura me vlerë të vogël dhe mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël

Numri total i autoriteteve dhe enteve kontraktore aktivë që kanë krijuar procedura prokurimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik gjatë vitit 2023 është 1217.
Numri i autoriteteve kontraktore që kanë krijuar vetëm procedura prokurimi me vlerë të vogël është 802 dhe vetëm 415 autoritete kontraktore kanë krijuar edhe procedura prokurimi me vlerë mbi kufirin monetar për prokurime me vlerë të vogël.

**Tabela 43**

| Lloji i Procedurës së Prokurimit të Shpallur në SPE | Numri i Autoriteteve Kontraktore |
|---|---|
| Autoritete Kontraktore që krijojnë vetëm procedura prokurimi me vlerë të vogël | 415 |
| Autoritete Kontraktore që krijojnë procedura prokurimi me vlerë mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël | 802 |
| TOTALI | 1217 |

Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i autoriteteve dhe enteve kontraktore aktive që kanë krijuar procedura prokurimi gjatë 2023 krahasur me 2022.

**Tabela 44**

| Autoritetet kontraktore | 2022 | 2023 |
|---|---|---|
| Numri i autoriteteve kontraktore | 1303 | 1217 |
| Numri i AK që kanë krijuar edhe procedura mbi kufirin e procedurave blerje me vlerë të vogël | 411 | 415 |

Më poshtë paraqiten 10 autoritetet kontraktore që kanë shpallur më shumë procedura/lote me vlerë mbi kufirin monetar për procedurat me vlerë të vogël, gjatë vitit 2023:

**Tabela 45**

| Nr. | Autoriteti Kontraktor | Numri i procedurave/ loteve me fond mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël | Numri i Procedurave/ Loteve të anulluara | Numri i Procedurave/ Loteve të vijuara |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë | 186 | 95 | 91 |
| 2 | Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara | 177 | 68 | 109 |
| 3 | Bashkia Shkodër | 137 | 21 | 116 |
| 4 | Spitali Universitar Shefqet Ndroqi Tiranë | 109 | 64 | 45 |
| 5 | Bashkia Tiranë | 101 | 12 | 89 |
| 6 | Spitali Rajonal Elbasan | 94 | 38 | 56 |
| 7 | Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat | 75 | 49 | 26 |
| 8 | Bashkia Krujë | 68 | 12 | 56 |
| 9 | Operatori i Sistemit të Transmetimit OST | 64 | 18 | 46 |
| 10 | Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit | 63 | 14 | 49 |

Sikurse vërehet nga të dhënat, Autoritetet Kontraktore që kanë më shumë anullime, janë ato që kanë fushë përgjegjësie shëndetësinë, dhe prokurojnë blerjen e medikamenteve, duke i ndarë në lote.

## 2.15. Statistika mbi ofertat e dorezuara gjatë 2023

Në tabelën e mëposhtme tregohet numrit i ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit me vlerë mbi 1.000.000 lekë, nga operatorët ekonomikë sipas llojit të procedurës:

**Tabela 46**

| Lloji i Procedurës | Tipi i Kontratës | Numri i procedurave | Numri Total i ofertave të dorëzuara | Mesatarja e Ofertave |
|---|---|---|---|---|
| Shërbim Konsulence | Shërbime | 89 | 532 | 5.97 |
| Konkurs projektimi | Shërbime | 6 | 1 | 0.17 |
| E hapur, mbi kufirin e lartë monetar | Shërbime | 133 | 269 | 2.0 |
| | Punë | 15 | 55 | 3.7 |
| | Mallra | 219 | 483 | 2.21 |
| E hapur | Shërbime | 206 | 505 | 2.45 |
| | Mallra | 500 | 1217 | 2.43 |
| | Punë | 439 | 3520 | 8.02 |
| E hapur e thjeshtuar | Shërbime | 693 | 2097 | 3.02 |
| | Mallra | 1243 | 3272 | 2.63 |
| | Punë | 328 | 1100 | 3.35 |
| E Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar | Shërbime | 3 | 14 | 4.7 |
| E Kufizuar | Shërbime | 6 | 24 | 4 |
| | Punë | 1 | 3 | 3 |
| Totali | | 3881 | 13092 | 3.37 |




**Grafiku 37**

Sikurse vihet re edhe nga të dhënat e mësipërme numri më i lartë i ofertave është në procedurat e prokurimit Shërbim Konsulence me mesataren 5.97, ndërsa numri më i ulët i ofertave është në procedurat Konkurs Projektimi me një mesatare 0.16 (vlen të theksohet që Konkursi i Projektimit është një procedurë atipike që zhvillohet në rrethana të caktuara dhe është njënumër shumë i vogël, vetëm 6 procedura gjatë vitit 2023).

Në tabelën e mëposhtme, paraqitet mesatarja e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit mbi kufirin monetar të procedurave blerje me vlerë të vogël sipas tipit të kontratës:

**Tabela 47**

| Tipi i Kontratës | Numri i procedurave | Numri total i ofertave te dorëzuara | Numri mesatar i ofertave |
|---|---|---|---|
| **Mallra** | **1962** | **4972** | **2.53** |
| **Punë** | **783** | **4678** | **5.97** |
| **Shërbime** | **1136** | **3442** | **3.03** |
| **Totali** | **3881** | **13092** | **3.37** |

Sikurse vihet re nga tabela e mëposhtme edhe në vitin 2022 mesatarja më e lartë e ofertave ka qenë në procedurën e prokurimit “Punë” dhe numri më i ulët i ofertave të dorëzuara është në procedurat e prokurimit “Mallra” dhe “Shërbime”. Në vitin 2023 kemi një rritje të ofertave të dorëzuara në krahasim me vitin 2022, në procedurat e prokurimit “Mallra” dhe “Punë”.

Tabela 48

| | Numri mesatar i ofertave | |
|---|---|---|
| Tipi i Kontratës | 2022 | 2023 |
| Mallra | 1.6 | 2.53 |
| Punë | 4.3 | 5.97 |
| Shërbime | 3.1 | 3.03 |

Sikurse vihet re edhe në tabelën e mësipërme mesatarja më e lartë e ofertave të dorëzuara është në tipet e kontratave Punë me 5.97 e cila tregon një konkurrencë të lartë dhe një numër të madh ofertash në këto tipe procedurash, ndërsa mesatarja më e ulët është në tipet e procedurave Mallra me 2.53.




**Grafiku 38**

Ndërkohë vlen për t'u theksuar se fondi limit i procedurave të punëve zë 48.3% krahas fondit total të të gjithë procedurave të prokurimit, ndërsa fondi limit i procedurave të mallrave zë vetëm 25.7%.




**Grafiku 39**

Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, mesatarja më e lartë e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë është në tipet e kontratave "Punë" dhe "Shërbime".

Përsa i përket procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, në tabelën e mëposhtme tregohet mesatarja e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë, sipas tipit të kontratës:

**Tabela 49**

| Lloji i Procedurës | Tipi i Kontratës | Numri i procedurave | Numri total i ofertave të dorëzuara | Numri mesatar i ofertave |
|---|---|---|---|---|
| Prokurim me vlerë të vogël | Mallra | 7416 | 125825 | 16.96 |
| Prokurim me vlerë të vogël | Shërbime | 4851 | 40609 | 8.4 |
| Prokurim me vlerë të vogël | Punë | 308 | 4289 | 13.9 |
| Totali | | 12575 | 170723 | 13.6 |

Përsa i përket Sistem Dinamik, Blerje biletash të transportit ajor, në tabelën e mëposhtme tregohet mesatarja e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë:

**Tabela 50**

| Lloji i Procedurës | Tipi i Kontratës | Numri i procedurave | Numri total i ofertave të dorëzuara | Numri mesatar i ofertave |
|---|---|---|---|---|
| Sistem Dinamik, Blerje biletash te trasportit ajor | Shërbime | 2481 | 10243 | 4.12 |
| Sistem Dinamik, Blerje biletash te trasportit ajor | Mallra | 47 | 201 | 4.27 |
| Totali | | 2528 | 10444 | 4.13 |

## 2.15.1.Statistika mbi procedurat e prokurimit me një ofertë të dorëzuar të përfunduara me fitues gjatë 2023

Nga të dhënat e nxjerra nga sistemi i prokurimit elektronik, rezulton se numri i procedurave të prokurimit mbi kufirin monetar për procedurën me vlerë të vogël, me një ofertë të dorëzuar dhe të finalizuara me njoftim fituesi është 1218. Në tabelën e mëposhtme tregohen të detajuara numri i procedurave me 1 ofertë të dorëzuar dhe të finalizuar me njoftim fituesi, sipas llojit të procedurës së prokurimit.

**Tabela 51**

| Lloji i procedurës së prokurimit | Numri i procedurave | Numri i procedurave me 1 oferte te dorezuar te finalizuara me njoftim fituesi/lidhje kontrate | Raporti i procedurave me një ofertë të dorëzuar të finalizuar me njoftim fituesi/ lidhje kontrate nga totali |
|---|---|---|---|
| Shërbim Konsulence | 115 | 0 | 0% |
| E hapur, mbi kufirin e lartë monetar | 480 | 112 | 23% |
| E hapur | 1555 | 274 | 18% |
| E hapur e thjeshtuar | 3079 | 832 | 27% |
| E Kufizuar | 4 | 0 | 0% |
| E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar | 3 | 0 | 0% |
| Konkurs projektimi | 7 | 1 | 14% |
| E Kufizuar për Rindërtim | 7 | 0 | 0% |
| Totali | 5250 | 1218 | 23% |

Sikurse vërehet nga tabela, në të gjitha procedurat Shërbim Konsulence dhe procedurat e kufizuara (përshirë ato mbi kufirin e lartë dhe për rindërtimin) janë paraqitur 2 ose më shumë oferta dhe asnjë prej tyre nuk ka 1 ofertues të vetëm.

Nga ana tjetër, në total numri i procedurave me një ofertë të dorëzuar dhe të finalizuara me njoftim fituesi për vitin 2023 përbën rreth 23% të numrit total të procedura të shpallura në SPE duke shënuar ulje krahasuar me vitin 2022 kur kjo shifër ka qenë 25%. Kjo tregon se, në 77% të procedurave të zhvilluara ka pasur pjesëmarrje të më shumë se një operatori ekonomik duke rritur konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik.

## 2.16. Statistika në lidhje me pjesëmarrjen e SME-ve në procedurat e prokurimit

Gjatë vitit 2023 APP ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për të kryqëzuar të dhënat që kanë respektivisht të dy institucionet me qëllim përllogaritjen e procedurave të prokurimit të fituara nga operatorë ekonomikë ndërmarrje të mesme dhe të vogla (SME).

Pjesëmarrja e SME-ve në procedurat e prokurimit dhe shpallja fitues e tyre në këto lloj procedurash është një tregues shumë i rëndësishëm për promovimin e konkurrencës në prokurimin publik.

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm paraqesin numrin e procedurave të prokurimit të fituara nga sme-të qoftë si pjesëmarrës të vetëm, në bashkime operatorësh me sme të tjera apo në bashkime operatorësh me biznese të mëdha apo operatorë të huaj në raport me numrin total të procedurave të shpallura me fitues.

**Tabela 52**

| Procedurat e fituara nga SME ndaj totalit të procedurave të fituara | | |
|---|---|---|
| OE SME/ BOE SME | 3,720 | 92.8% |
| BOE SME/ Të tjerë | 46 | 1.1% |
| Të tjerë | 241 | 6.1% |
| **Totali i Procedurave të fituara** | **4,007** | **100.0%** |




**Grafiku 40**

Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, procedurat e prokurimit të fituara nga SME (ofertues të vetëm apo bashkim operatorësh SME) përbëjnë 92.8% të totalit të procedurave të fituara.

Ndërkohë, SME-të janë operatorë fitues edhe në 1.1% të procedurave të fituara nëpërmjet bashkimit me operatorë të tjerë (biznes i madh apo të huaj) duke e çuar në total 93.9% numrin e procedurave të fituara nga këta lloj operatorësh.

## 2.17. Të dhëna mbi pjesëmarrjen e operatorët ekonomikë të huaj

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e procedurave në të cilat kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të huaj.

**Tabela 53**

| Pjesëmarrja e Operatorëve të huaj në krahasim me Operatorët Shqiptarë | |
|---|---|
| **Numri i Procedurave që kanë marë pjesë Operatorë të huaj** | **93** |
| **Numri i Procedurave që kanë marë pjesë Operatorë Shqiptarë** | **3,788** |
| **TOTALI** | **3,881** |

Siç vihet re, nga 3,881 procedura prokurimi publik të vazhduara, në 93 prej tyre kanë marrë pjesë 28 operatorë ekonomikë të huaj.




**Grafiku 41**

Në tabelën e mëposhtme detajohet numri i procedurave **të cilat janë fituar** nga operatorë ekonomikë të huaj.

Sic vihet re nga tabela, operatorët ekonomikë të huaj kanë fituar 18 procedura nga totali prej 4007 procedura të cilat përbëjnë 0.4% të procedurave. Ndërkohë shprehur në vlerën e fituar, përbën 3.1% të fondit të fituar ndaj fondit total.

**Tabela 54**

| | Numri i Procedurave të fituara | Raporti në % i procedurave të fituara/ totalit | Fondi Limit i Procedurave të fituara | Raporti në % i fondit limit/ totalit | Fondi i Fituar | Raporti në % i fondit të fituar/ totalit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| OE të huaj/ BOE OE të huaj-tjerë | 18 | 0.4% | 3,779,054,467 | 3% | 3,447,560,335 | 3.1% |
| OE Shqiptarë | 3,989 | 99.6% | 121,843,911,179 | 97% | 108,322,338,727 | 96.9% |
| TOTALI | 4,007 | 100.0% | 125,622,965,646 | 100% | 111,769,899,062 | 100.0% |

Më poshtë do paraqesim në formë grafiku raportin në përqindje që zënë procedurat e fituara nga opertaorët ekonomikë të huaj ndaj totalit si dhe grafikun që zë raporti në përqindje i fondit limit ndaj totalit.




**Grafiku 42**




**Grafiku 43**




Grafiku 44

## 2.17.1. Procedurat e fituara nga Operatorët Ekonomikë të huaj, sipas llojit të procedurës, paraqiten si me poshtë:

Në tabelën më poshtë detajohen procedurat e fituara nga operatorët ekonomikë të huaj klasifikuar sipas llojit të tyre.

Tabela 55

| Lloji i Procedurës | Nr. i Procedurave të Fituara | Fondi Limit | Fondi I Fituar |
|---|---|---|---|
| Procedurë e hapur | 6 | 173,845,095 | 133,936,196 |
| E hapur, e thjeshtuar | 5 | 27,138,181 | 23,505,141 |
| E hapur, mbi kufirin e lartë monetar | 4 | 3,147,715,724 | 2,901,776,438 |
| Shërbim konsulence | 3 | 430,355,466 | 388,342,560 |
| TOTALI | 18 | 3,779,054,467 | 3,447,560,335 |

Në grafikun më poshtë pasqyrohen llojet e procedurave të fituara nga operatorët ekonomikë të huaj.




Grafiku 45

## 2.17.2. Operatorët Ekonomikë të huaj nga shtetet anëtare të BE

Gjatë vitit 2023, kanë marrë pjesë dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit publik 7 operatorë ekonomikë të huaj nga shtetet anëtare të BE-së.

Nga këto, 2 kanë qenë nga Austria, 1 nga Greqia, 1 nga Sllovenia, 1 nga Italia, 1 nga Gjermania dhe 1 nga Franca. Më poshtë paraqiten grafikisht.




**Grafiku 46**

Të dhënat mbi procedurat e fituara nga këto operatorë ekonomikë paraqiten si më poshtë:

**Tabela 56**

| Shteti | Numri i Procedurave të Fituara | Fondi Limit | % e fondit limit/ fondit limit total | Fondi I Fituar | % e fondit të fituar/ fondit të fituar total |
|---|---|---|---|---|---|
| **Austri** | **2** | **413,688,799** | **61.9%** | **373,542,558** | **66.9%** |
| **Greqia** | **1** | **4,917,899** | **0.7%** | **4,784,362** | **0.9%** |
| **Sllovenia** | **1** | **219,945,000** | **32.9%** | **152,532,000** | **27.3%** |
| **Itali** | **1** | **13,000,000** | **1.9%** | **12,707,334** | **2.3%** |
| **BOE Gjermani dhe Francë** | **1** | **16,666,667** | **2.5%** | **14,800,002** | **2.7%** |
| **TOTALI** | **6** | **668,218,365** | **100%** | **558,366,256** | **100%** |

## 2.18. Statistika për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë gjatë vitit 2023

Në vijim të hyrjes në fuqi të ligjit 36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë" dhe miratimit të legjislacionit dytësor, gjatë vitit 2023 janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike njoftime kontratash për këto lloj procedurash.

Sikurse, rezulton nga tabela e mëposhtme, në vitin 2023, janë publikuar gjithsej 34 procedura në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, prej të cilave 12 procedura janë anulluar, 23 procedura kanë përfunduar me fitues dhe janë nënshkruar 17 kontrata (nga fituesit e 2022 dhe 2023).

Numri i procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë të shpallura në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe njoftimet e fituesit për vitin 2023, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 57**

| Procedura në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë | Numri i procedurave |
|---|---|
| **Njoftime kontratash** | **34** |
| **Procedura të anulluara** | **12** |
| **Njoftime Fituesish** | **23** |
| **Kontrata të nënshkruara** | **17** |

## 2.19. Statistika në lidhje me numrin e procedurave të dhënies me koncesion/ppp gjatë vitit 2023

Gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2023, nuk ka patur procedura të shpallura për koncesione dhe PPP, ndërkohë që kanë përfunduar me fitues 2 (dy) procedura koncesionare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

**Tabela 58**

| Procedura për dhënien me koncesion /PPP | Numri i procedurave | Vlera e Investimit |
|---|---|---|
| **Njoftime Kontratash** | **0** | |
| **Njoftime Fituesish** | **2** | **60,235,107,600 Lekë** |

## 2.20. Statistika në lidhje me procedurat e ankandit publik të zhvilluara gjatë vitit 2023

Gjatë vitit 2023 janë shpallur në Buletinin e Njoftimeve Publike edhe procedura të ankandit publik, procedura këto, të cilat zhvillohen vetëm në rrugë shkresore.

Konkretisht, të dhënat në lidhje me këtë procedurë paraqiten si më poshtë:

**Tabela 59**

| Procedura të ankandit publik | Numri | Vlera e ofertuar në lekë |
|---|---|---|
| **Numri i Procedurave të Shpallura** | **264** | |
| **Njoftime Fituesish Ankandi** | **133** | **756,682,948** |
| **Njoftime Kontratash të Nënshkruara Ankandi** | **55** | **127,127,415** |

Të shpërndarë sipas muajve, njoftimet e fituesit të procedurave të ankandit, paraqiten si më poshtë:

**Tabela 60**

| Muaji | Nr. procedurave | Vlera Fillestare me TVSH | Vlera e Ofertuar me TVSH |
|---|---|---|---|
| Janar | 4 | 6,980,450 | 6,934,800 |
| Shkurt | 14 | 5,638,723 | 8,107,775 |
| Mars | 11 | 12,107,807 | 13,408,400 |
| Prill | 6 | 2,487,349 | 2,487,894 |
| Maj | 14 | 20,555,431 | 20,736,931 |
| Qershor | 14 | 4,178,145 | 4,205,515 |
| Korrik | 12 | 457,007,575 | 458,802,746 |
| Gusht | 9 | 29,497,665 | 29,862,564 |
| Shtator | 16 | 58,539,283 | 60,195,734 |
| Tetor | 9 | 50,079,405 | 50,582,689 |
| Nentor | 12 | 23,179,046 | 23,668,860 |
| Dhjetor | 12 | 74,587,872 | 77,689,040 |
| Total | 133 | 744,838,750 | 756,682,948 |

Të shpërndarë sipas muajve, njoftimet e kontratave të nënshkruara të procedurave të ankandit, paraqitensi më poshtë:

**Tabela 61**

| VITI 2023 | Nr. Kontratave | Vl. Fillestare | Vl. Kontratës |
|---|---|---|---|
| Janar | 3 | 2,195,820 | 2,215,820 |
| Shkurt | 1 | 345,000 | 414,000 |
| Mars | 6 | 565,584 | 642,695 |
| Prill | 3 | 702,220 | 702,300 |
| Maj | 6 | 3,269,337 | 3,289,601 |
| Qershor | 4 | 1,471,385 | 1,972,990 |
| Korrik | 10 | 2,186,822 | 2,531,045 |
| Gusht | 3 | 17,579,413 | 17,763,073 |
| Shtator | 7 | 19,359,786 | 19,829,588 |
| Tetor | 8 | 5,096,000 | 6,135,970 |
| Nentor | 1 | 149,500 | 149,500 |
| Dhjetor | 3 | 71,116,315 | 71,480,833 |
| Totali | 55 | 124,037,181 | 127,127,415 |

Në analizimin e të dhënave të paraqitura në tabelat e mësipërme, duhet mbajtur në konsideratë fakti që në shumë raste ka rezultuar se një subjekt që është shpallur fitues në disa lote të procedurave të ankandeve, ka nënshkruar një kontratë, prandaj edhe numri i kontrave të lidhura është më i vogël se numri i njoftimeve të fituesit.

3

# OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, ZBATIMI DHE MONITORIMI I TYRE

Në Nëntor të vitit 2020, Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020-2023. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është garantimi i një sistemi prokurimi efiçent dhe efektiv në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës së lirë dhe të ndershme, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, duke promovuar dhe nxitur një sistem të qëndrueshëm që garanton vlerën për para.

Viti 2023 është viti i fundit në të cilin shtrihet kjo Strategji dhe viti në të cilin pritet të realizohen aktivitetet e parashikuara. Zbatimi i saj mbështetet tek reformat që duhen ndërmarrë në 5 shtyllat kryesore, materializuar në 5 Qëllime Politikash (QP), që synojnë përmirësimin e mëtejshëm dhe zhvillimin e sistemit të prokurimeve, konkretisht:

- Prokurim publik efiçent dhe i qendrueshëm;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor për koncesionet dhe partneritetin publik-privat;
- Riorganizimi i prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;
- Blerja e përqendruar;
- Përmirësimi i sistemit të shqyrtimit dhe kontrollit të ankesave.

Në përgjithësi, ka pasur një shkallë realizimi të kënaqshme sa i takon aktiviteteve dhe treguesve të performancës gjatë periudhës kohore që është parashikuar në këtë strategji. Strategjia përmban 10 tregues performance, nga të cilat janë nxjerrë të dhëna për 8 prej tyre dhe përmban në total 42 (dyzetë e dy) aktivitete nga të cilat:

- 27 (njëzet e shtatë) aktivitete për Qëllimin e Politikës 1 "Prokurim publik efiçent dhe i qëndrueshëm";
- 4 (katër) aktivitetet për Qëllimin e Politikës 2 "Përmirësimi i kuadrit ligjor për koncesionet dhe PPP"
- 3 (tre) aktivitetet për Qëllimin e Politikës 3 "Riorganizimi i prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë";
- 4 (katër) aktivitetet për Qëllimin e Politikës 4 "Blerja e përqendruar";
- 4 (katër) aktivitete për Qëllimin e Politikës 5 "Përmirësimi i sistemit të shqyrtimit dhe kontrollit të ankesave".

Gjatë 2023, ka pasur zhvillime në të gjitha Qëllimet e Politikave të Strategjisë dhe në përgjithësi ka pasur ecuri pozitive lidhur me të gjitha masat dhe aktivitetet e parashikuara, duke i kushtuar vëmendje realizimit të aktiviteteve të parealizuara, aktivitete të cilat ndodhen në proces si dhe ato të realizuara pjesësisht me qëllim që të arrihen një realizueshmëri e kënaqshme brenda shtrirjes kohore të strategjisë. Për këtë arsye, APP ka komunikuar vazhdimisht me institucionet përgjegjëse me qëllim realizimin me sukses të kësaj Strategjie.

Rëndësia e suksesit të kësaj strategjie nuk është e izoluar vetëm në qasjen sektoriale por edhe në perspektivën e Integrimit Evropian, duke qenë se fushat të cilat ajo mbulon dhe masat që përmbajnë, shërbejnë si njësi matëse për plotësimin e kritereve të përcaktuara në Kapitullin 5 "Prokurimi Publik".

Megjithatë, vijon të ketë aktivitete në proces realizimi apo aktivitete që duhet të realizohen, të cilat do të materializohen dhe reflektohen në Strategjinë e re, SKPP 2024-2030. Për këtë arsye, edhe SKPP 2024-2030 do të reflektojë ato objektiva specifikë dhe masa të cilat do të synohen të realizohen gjatë viteve të ardhshme.

APP si një nga institucionet kryesore përgjegjëse për realizimin e aktiviteteve dhe plotësimin e indikatorëve kyç të performancës është angazhuar maksimalisht duke realizuar në një shkallë të konsiderueshme aktivitetet e parashikuara për vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe është hartuar dhe miratuar raporti 1 (një) vjeçar për vitin 2022 si dhe është hartuar dhe miratuar raporti i monitorimit për 6 mujorin e parë për vitin 2023.

Gjatë 2023, Komiteti Drejtues i SKPP ka zhvilluar dy mbledhje në të cilat ka miratuar raportet përkatëse të monitorimit:

i. **Mbledhja e datës 21 Mars 2023, ku është miratuar Raporti i Monitorimit 1 vjeçar për vitin 2022 të SKPP 2020-2023;**
ii. **Mbledhja e datës 14 shtator 2023, ku është miratuar Raporti i Monitorimit 6 mujori i I (parë) për vitin 2023 të SKPP 2020-2023.**

Ne faqen zyrtare të APP gjenden të publikuara njoftimet dhe raportet përkatëse[8] të monitorimit të SKPP.

## 3.1. Strategjia e Re e Prokurimit Publik 2024-2030 dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e saj 2024-2027

Gjatë periudhës raportuese, APP është angazhuar maksimalisht lidhur me procesin e hartimit të strategjisë së re në fushën e prokurimeve publike. Është përgatitur draft materiali dhe koncept ideja, të cilat u përcollën pranë SASPAK dhe u miratuan në mbledhjen e Qershorit të Komitetit të Planifikimit Strategjik.

Ndërkohë në qershor 2023, doli Urdhri i Kryeministrit Nr. 77, datë 27.06.2023 "*Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Hartimin e Strategjisë Kombëtare për prokurimin Publik 2024-2030 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj 2024-2027*".
Procesi i hartimit është organizuar në disa faza duke përfshirë ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë, konsultime paraprake për metodologjinë e punës dhe formatin e strategjisë, analizën e situatës e cila ka rezultuar me identifikimin e problematikave në fushën e prokurimeve publike që do të trajtohen nga strategjia; përcaktimi i veprimtarive kryesore dhe masave të strategjisë; hartimin e planit të veprimit dhe kostimin e strategjisë, konsultimin publik dhe finalizimin e dokumentit.

Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030, është në koherencë të plotë me objektivat ndërkombëtarë për zhvillim të qëndrueshëm, me kuadrin ligjor të BE-së në këtë fushë si edhe me angazhimet e ndërmarra nga pala shqiptare në takimet e përbashkëta me palën evropiane, etj.

Procesi i hartimit të strategjisë, i mbështetur nga asistenca teknike e SIGMA-OECD, ka reflektuar edhe iniciativa të nisura dhe jo të finalizuara pjesë e Strategjisë së Prokurimit Publik 2020-2023, si dhe detyrimet në kuadër të procesit të integrimit dhe sidomos rekomandimet e BE-së të dala nga procesi *Screening*.

Ndërkaq, procesi i hartimit të kësaj strategjie është karakterizuar nga pjesëmarrja aktive e specialistëve të prokurimit publik, ekspertëve të fushës dhe grupeve të tjera të interesit, të cilët kanë kontribuar në arritjen e një shkalle të lartë të pajtueshmërisë me prioritetet strategjike dhe mënyrat për trajtimin e tyre.

8 https://www.app.gov.al/rreth-nesh/dokumente-strategjike/; https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=1b1e4d16-9de0-48b3-a901-218be6fa5720
https://www.app.gov.al/GetData/DoënloadDoc?documentId=fe591574-e2e8-471c-80c2-47157aeb003a

Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është garantimi i një sistemi prokurimi efiçent dhe efektiv në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës së lirë dhe të ndershme, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, duke promovuar dhe nxitur një sistem të qëndrueshëm që garanton vlerën për para.

Në fokus të SKPP 2024-2030 ndër të tjera përmendim rritjen e efiçencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik; mirë përdorimin e fondeve publike dhe reduktimin e shpenzimeve procedurale; nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, sidomos promovimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME); nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë; sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; garantimin e integritetit, rritjen e besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Ndërkohë, draft strategjia dhe draft plani i veprimit janë publikuar si në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet publike për konsultim publik ashtu edhe në faqen zyrtare të APP për komente dhe sugjerime shtesë.

## 3.2. Strategjitë Ndërsektoriale

Prokurimi Publik është gjithashtu pjesë e rëndësishme e katër Strategjive ndër sektoriale kryesore të Qeverisë Shqiptare, konkretisht,

(i) **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;**
(ii) **Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike;**
(iii) **Strategjia Ndër sektoriale Kundër Korrupsionit; dhe**
(iv) **Strategjia për Reformën në Administratën Publike.**

APP jep kontributin e saj institucional lidhur me fushën e prokurimit publik, sa herë kërkohet nga institucionet që monitorojnë zbatimin e këtyre strategjive. APP bashkëpunon me të gjitha drejtoritë e tjera pjesë e institucionit në kuadër të hartimit të një raporti periodik gjithëpërfshirës, ku të pasqyrohet gjithë aktiviteti i institucionit dhe realizimi i masave dhe detyrimeve të parashikuara në dokumentet strategjikë.

Gjatë kësaj periudhe treguesit e indikatorëve në fushën e prokurimit publik kanë qenë në nivelet e realizueshmërisë së plotë të tyre. Gjithashtu, janë raportuar aktivitete të ndryshme në të cilat ka qenë pjesë APP dhe që lidhën me zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në këto strategji. Nga institucioni jonë ëhstë depozituar informacion periodik sa herë që kërkohet nga institucionet monitoruese dhe koordinuese të këtyre strategjive, lidhur me realizimin e aktiviteteve përkatëse.

Gjithashtu APP ka qenë pjesë e diskutimeve dhe kontributeve konkrete lidhur me hartimin e strategjive të reja lidhur me menaxhimin e financave publike si dhe strategjinë e re kundër korrupsionit. Në të dy draft materialet janë parashikuar aktiviteteve lidhur me fushën e prokurimit publik si dhe indikatorë të cilët synojnë përmirësimin e sistemit të prokurimit publik.

4

# PROCESI I INTEGRIMIT EUROPIAN DHE BASHKËPUNIMI MË TË TRETËT

Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit europian, si edhe harmonizimi i sistemit të prokurimit në Shqipëri me praktikat më të mira europiane dhe ndërkombëtare është një nga drejtimet kryesore të veprimtarisë së Agjencisë së Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, APP, në cilësinë e kryesuesit të punës për Kapitullin 5 të acquis-së "Prokurimi Publik" ka marrë të gjitha masat e nevojshme për koordinimin e aktiviteteve të nevojshme në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga ky kapitull.

Konkretisht, APP ka mbajtur komunikim te vazhdueshëm me Kryenegociatorin e Shqipërisë për procesin e anëtarësimit në BE duke raportuar në mënyrë periodike mbi zhvillimet e ndodhura në këtë kapitull.

Sipas Raportit Screening për Grupkapitujt 1 "Themelorët" dhe Raportit të Komisionit Evropian 2023, Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në përafrimin e kuadrit ligjor në fushën e prokurimit publik me A*cquis* e BE-së, veçanërisht sa i takon prokurimeve në sektorin klasik, utilitar dhe rishikimin administrativ, duke pasur një nivel të lartë përafrimi. Gjithashtu, kuadri ligjor për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë vlerësohet me një nivel të lartë përafrimi. Megjithatë, kuadri ligjor për koncesionet dhe partneritetin publik privat është pjesërisht i përafruar me *Acquis.*

Lidhur me procesin e integrimit europian, APP në cilësinë e institucionit drejtues të kapitullit, ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me Drejtorinë për Anëtarësimin në BE pranë Kryeministrisë dhe institucionet anëtare të GNPIE për:

- Hartimin e kontributit të parë, të dytë dhe të tretë për progres raportin e Komisionit Evropian për vitin 2023;
- Hartimin e raportimit në kuadër të takimit të Këshillit të Stabilizim-Asociimit, i cili u zhvillua më datë 15 Mars 2023;
- Hartimin e raportit në kuadër të Nënkomitetit për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën, duke përfshirë mbrojtjen e shëndetit dhe konsumatorit, i cili u zhvillua më datë 30 Maj 2023;
- Raportimet javore në kuadër të procesit të monitorimit të masave të parashikuara në PKIE 2023-2025, për vitin 2023;
- Hartimin e Pozicionit Negociues për Kapitullin 5;
- Kontributin në kuadër të hartimit të Udhërrëfyesit "Për Shtetin e së Drejtës" si dhe Udhërrëfyesin "Për Administratën Publike";

- Zhvillimin e takimeve **të GNPIE;**
- Paketën e Semestrit të Integrimit Evropian 2023, sa i përket instrumentit të Raportimit dhe Vlerësimit për semestrin II (Prill-Qershor 2023), semestrin III (Korrik-Shtator 2023) dhe planifikimin Janar-Dhjetor 2023;
- Pasaportën e Kapitullit 5;
- Ngritjen e sistemit TIK për Integrimin Evropian;
- Adresimin e nevojave për ngritjen e kapaciteteve administrative për anëtarët e GNPIE për Kapitullin 5;
- Hartimin e PKABE 2024-2030 dhe PKIE 2024-2026;
- Hartimin e kontributeve sa herë është kërkuar nga institucionet e tjera, koordinuese në Kapitujt të tjerë të Acquis të tilla si Kriteri Ekonomik, Kapitulli 22, Kapitulli 30, Kapitulli 19, etj.

**Procesi *Screening:*** Në vijim të takimit dypalësh *screening*, për Kapitullin 5, të zhvilluar më datë 18 Nëntor 2022, në Bruksel, është punuar për përditësimin e Draft-Pozicionit Negociues për Kapitullin 5, me qëllim që të reflektoheshin dhe angazhimet e ndërmarra gjatë këtij takimi.

Në vijim të publikimit të Raportit "*Screening*" për Grupkapitujt 1 "Themelorët", në Korrik të 2023, Draft-Pozicioni Negociues u ristrukturua dhe u finalizua sipas këtij raporti si dhe me anë të një metodologjie të unifikuar nga Drejtoria për Anëtarësimin në BE në Kryeministri.

Për hartimin e këtij dokumenti, Kapitulli 5 është asistuar nga Projekti SEI, i cili gjithashtu do të vijojë të asistojë këtë Kapitull dhe në fazat e mëtejshme të procesit të negociatave.

# 5

# BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE TË TJERA

## 5.1. Marrëveshjet e Bashkëpunimit

Gjatë vitit 2023, APP ka vijuar bashkëpunimin periodik me institucionet, me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, si: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, nëpërmjet këmbimit të informacioneve respektive mbi operatorët ekonomikë fitues të procedurave të prokurimit dhe verifikimit të faktit nëse këta operatorë ekonomikë ushtrojnë veprimtarinë duke zbatuar kërkesat e legjislacionit në fuqi, sipas fushave respektive, që mbulon secili prej këtyre institucioneve.

Bashkëpunimi me këto institucione është i vazhdueshëm në drejtim të relatimit nga APP, të operatorëve ekonomikë që kanë përfituar fonde publike, dhe verifikimit nga AKU dhe ISHPSHSH nëse këta operatorë kanë qenë të penalizuar, për mosrespektim të kërkesave të legjislacionit të punës në fuqi.

Në këtë kuadër, nga këto institucione vijojnë të relatohen pranë APP raste, ku subjekte të ndryshëm janë dënuar me gjobë për shkelje të legjislacionit të punës ose rezultojnë të mos ushtrojnë aktivitetin në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Kjo ka sjellë që APP, të vijojë punën e saj për nisjen e procedimeve administrative për përjashtimin e këtyre operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike pasi, nga verifikimet e kryera ka rezultuar se një pjesë e mirë e tyre kanë marrë pjesë dhe janë shpallur fitues në procedura prokurimi, duke keqinformuar autoritetet.

Nga komunikimet me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU) kanë rezultuar tre raste të subjekteve të penalizuar me gjobë/nuk ushtrojnë aktivitetin sipas objektit të prokurimit, të cilët janë penalizuar/kontrolluar nga AKU në një datë të mëvonshme nga zhvillimi i procedurës së prokurimit, e për këtë arsye, vijojnë të mbahen në konsideratë nëse do të rezultojnë fitues në procedurat në vijim.

Nga komunikimi me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPPSHSH) janë relatuar dy raste ku subjekti ka rezultuar se, është dënuar me gjobë. Në përfundim të hetimit administrativ është marrë vendimi për përjashtimin e të dy operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike.

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës, APP edhe gjatë këtij viti ka komunikuar me këtë institucion, duke i përcjellë për hetim disa raste të denoncuara nga subjekte të ndryshëm, me pretendime për marrëveshje të fshehta në oferta, duke vënë theksin se, nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, në procesin e prokurimit publik është një nga parimet kryesore të këtij procesi, në funksion të mirëpërdorimit të fondeve publike, dhe rritjes së eficencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik.

Midis APP dhe Komisionit t**ë** Prokurimit Publik ka vijuar komunikimi dhe bashkëpunimi edhe këtë vit në kuadër të realizimit të detyrimeve ligjore dhe angazhimeve të përbashkëta të marra përsipër nga Memorandumi i bashkëpunimit dypalësh.

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, i cili synon forcimin e bashkëpunimit midis palëve, në funksion të zbatimit të parashikimeve të Kodit Zgjedhor si dhe të legjislacionit të prokurimit publik, në funksion të mirëpërdorimit të fondeve publike në procedurat e prokurimit publik, pritet nga KQZ dërgimi i listës me personat fizikë ose juridikë, të cilët gjatë procesit të zgjedhjeve vendore, 14 Maj 2023, i kanë bërë dhurime një subjekti zgjedhor apo kandi-

datëve Kjo listë do të dërgohet sapo të përfundojë procesi i verifikimit dhe mbledhjes së të dhënave për raportet financiare të dorëzuar nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore.

Duke qenë se, APP dhe AKSIK, në përmbushje të funksioneve dhe detyrave institucionale, kryejnë veprimtari në fusha të përbashkëta, që lidhen me prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", në vitin 2023, ndërmjet dy institucioneve u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi.

Marrëveshja ka si qëllim bashkëpunimin në funksion të ndërgjegjësimit të autoriteteve kontraktore në mirëzbatimin e legjislacionit të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe për mirëzbatimin e rregullave, procedurave dhe kërkesave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë kryerjes së këtyre procedurave.
Bashkëpunimi do të realizohet ndër të tjera, nëpërmjet organizimit të trajnimeve të përbashkëta për autoritetet kontraktore që kryejnë prokurime në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar, si dhe nëpërmjet kryerjes së monitorimeve të përbashkëta, me qëllim verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë nga ana e autoriteteve kontraktore, gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si përsa i përket zbatimit të rregullave të prokurimit, ashtu edhe zbatimin e rregullave, procedurave dhe kërkesave që lidhen me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë kryerjes së këtyre procedurave.
APP, në bashkëpunim me AKSIK, zhvilluan trajnimin me temë: "Prokurimet në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, rastet e prokurimeve që përmbajnë informacion të klasifikuar". Ku nga përfaqësues të APP u prezantuan çështjet e përzgjedhura si me interes nga APP, për temën e trajnimit.
Qëllimi i këtij trajnimi, ishte njohja me Ligjin Nr. 36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë", dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1170, datë 24.12.2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë", si dhe sqarimi i problematikave të hasura nga institucionet në cilësinë e autoriteteve kontraktore, që zhvillojnë procedura në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.
Në trajnim morën pjesë përfaqësues të institucioneve si: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, Institucioni i Presidentit, Kuvendi, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit, Shërbimi Informativ i Shtetit, dhe Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).
Problematikat e ngritura nga përfaqësuesit e autoriteteve kontraktore kishin të bënin me paqartësitë që hasnin gjatë zbatimit të rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, kryesisht lidhur me afatet që duhet të respektohen në zbatim të legjislacionit, si dhe me përzgjedhjen e procedurës përkatëse të prokurimit, për të cilat u sqaruan nga përfaqësuesit e AKSIK dhe të APP.

Në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit të nënshkruar me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ka vijuar bashkëpunimi për përcjelljen e informacioneve të kërkuara lidhur me subjekte të ndryshëm, në process verifikimi nga ky institucion. Gjithashtu, është komunikuar për dërgimin në APP të të gjitha rasteve kur, gjatë kontrolleve të deklaratave të interesave privatë të subjekteve, do të rezultojnë se janë në konflikt interesi/kategorinë e ndalimit absolut të lidhjes së kontratave/nënkontratave të funksionarëve publikë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367/2005 dhe kanë fituar fonde publike.

Gjatë vitit 2023, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me ASPA dhe DAP për hartimin e kurrikulave të reja të trajnimit në kuadër të procesit të profesionalizimit të prokurimit publik. Në këtë kuadër, është organizuar edhe Trajnimi i Trajnerëve të rinj në këtë fushë si edhe pilotimi i kurrikulës së nivelit bazë.

APP ka një bashkëpunim të vazhdueshëm edhe me Shkollën e Magjistraturës me të cilën ka nënshkruar edhe një memorandum bashkëpunimi me qëllim ofrimin e trajnimeve në fushën e prokurimit publik për magjistratët, gjyqtarë dhe prokurorë, në kuadër të trajnimit të tyre të vazhduar, por edhe për oficerët e policies gjyqësore. Gjatë vitit 2023, janë zhvilluar disa sesione të tilla informuese në lidhje me legjislacionin e prokurimit dhe zbatimin e tij.

Gjithashtu, APP ka bashkëpunuar vazhdimisht me Drejtorinë e RIA pranë Kryeministrisë, me qëllim finalizimin e dokumentit RIA të projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik".

## 5.2. Bashkëpunimi me Institucione të Huaja

Gjatë këtij viti, APP ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me SIGMA/OECD në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të prokurimit publik në Shqipëri. APP është duke bashkëpunuar me SIGMA në kuadër të ndryshimeve në ligjin 162/2020 dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, me qëllim përafrimin e mëtejshëm me Direktivat e BE-së. Për këtë qëllim, gjithashtu janë hartuar dhe tabelat e përputhmërisë të cilat pasqyrojnë shkallën e përafrueshmërisë të ndryshimeve në këtë ligj me Direktivat përkatëse.

Gjithashtu, SIGMA është duke asistuar dhe në hartimin e një draft-ligji të ri për koncesionet dhe PPP-të, me qëllim që të jetë në një shkallë të madhe i përafruar me Direktivën e BE 2014/23. Në këtë kuadër, SIGMA ka përgatitur tabelën e përputhshmërisë dhe një analizë të boshllëkut ligjor, të cilat shërbyen si intrumenta për të hartuar draftin e parë, puna për të cilin ka nisur gjatë 2023.

SIGMA po asiston gjithashtu në procesin e hartimit të Strategjisë së re në fushën e prokurimit publik dhe të Udhërrëfyesit për përdorimin e kriterit të vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto.

Po ashtu, Prezenca e OSBE ka bashkëpunuar ngushtësisht me APP dhe me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe Departamentin e Administratës Publike (DAP) për të zhvilluar një program trajnimi gjithëpërfshirës dhe të certifikuar që synon profesionalizimin e funksionit të prokurimit publik në Shqipëri në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Aktualisht, Udhërrëfyesi i Profesionalizimit është finalizuar dhe kurrikulat e trajnimit janë finalizuar. Në vijim, gjatë muajit Mars 2023, u realizua procesi i Trajnimit të Trajnerëve për prokurimin publik, në bashkëpunim me OSBE dhe ASPA, ku ishin 45 aplikantë, nga të cilët 20 u përzgjodhën për t'iu nënshtruar trajnimit të detyrueshëm 8-ditor, nga të cilët 19 u shpërblyen me certifikatën e trajnerit të prokurimit publik. Pas përfundimit të trajnimit të trajnerëve dhe certifikimit të tyre, si dhe kurrikulave të finalizuara, në Qershor 2023, nisi pilotimi i sesioneve trajnuese për nivelin bazë, për punonjësit e AK-ve, i cili vijoi dhe gjatë muajit Korrik, dhe u përmbyll ne muajin Shtator.

Gjithashtu, APP ka bashkëpunuar me UNOPS në kuadër të "Rapid Public Procurement Assessment Mission/Misionit për Vlerësimin e Shpejtë të Prokurimit Publik". Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, APP ka komunikuar me përfaqësuesit e UNOPS të cilët kryen një vlerësim të sistemit të prokurimit publik në Shqipëri.

Në kuadër të procesit të Aderimit në Marrëveshjen e Organizatës Botërore të Tregtisë për Prokurimin Qeveritar (GPA), APP, nëpërmjet Drejtorisë së Zbatimit të Politikave Strategjike dhe Integrimit, është duke bashkëpunuar me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), e cila është duke dhënë asistencën e saj teknike në këtë proces.

Po ashtu, APP bashkëpunon vazhdimisht me Byronë e Prokurimeve Publike të Maqedonisë së Veriut, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, veçanërisht në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit dhe GPA.

Gjithashtu, ka pasur bashkëpunim të ngushtë me Bankën Botërore, në kuadër të ndryshimeve ligjore përsa i përket eficencës së energjisë dhe përdorimit të kritereve dhe specifikimeve teknike në funksion të saj në procedurat e prokurimit publik, projekt nga i cili përfitues i drejtëpërdrejtë është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkëpunues është edhe APP.

Së fundmi, gjatë periudhës APP ka raportuar në mënyrë të vazhdueshme pranë MFE në lidhje me çështje që lidhen me tregtinë, marrëveshjen CEFTA etj.

## 5.3. Profesionalizimi

Profesionalizimi i prokurimit me qëllim garantimin e cilësisë dhe qendrueshmërisë institucionale sa i takon prokurimit publik është një nga objektivat kryesore të veprimtarisë së APP, parashikuar edhe në Strategjinë e Prokurimit Publik 2020-2023.

Në këtë kuadër, në bashkëpunim me OSBE, ASPA dhe DAP, në vijim të hartimit të Udhërrëfyesi të Profesionalizimit janë finalizuar kurrikulat e trajnimit për 4 (katër) nivele: nivel bazë, të mesëm, të avancuar dhe nivelin ekspert.

Në vijim, gjatë muajit Mars 2023, u realizua procesi i Trajnimit të Trajnerëve për prokurimin publik, në bashkëpunim me OSBE dhe ASPA, ku ishin 45 aplikantë, nga të cilët 20 u përzgjodhën për t'iu nënshtruar trajnimit të detyrueshëm 8-ditor, nga të cilët 19 u certifikuan si trajnerë në fushën e prokurimit publik.

Pas certifikimit të trupës së trajnerëve, ka filluar procesi i pilotimit të kurrikulës bazë, ku trajnerët e certifikuar kanë zhvilluar 9 trajnime gjithsej në periudhën kohore qershor dhjetor 2023 dhe janë trajnuar rreth 247 përfaqësuesish të administratës publike që merren me procedurat e prokurimit publik.

APP do të vijojë bashkëpunimin e ngushtë me ASPA dhe DAP në kuadër të ngirtjes së rrjetit të profesionistëve në fushën e prokurimit publik.

## 5.4. Procesi i aderimit të Shqipërisë në GPA të OBT

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit 156/2022 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e kushteve të aderimit të RSH në marrëveshjen e prokurimit publik të Organizatës Botërore të Tregtisë", ka vijuar procesi lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në GPA-OBT.

Më 20 prill 2023, me shkresën nr.1015/2 Prot, Presidenti i RSH autorizoi Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme për lëshimin e plotfuqishmërisë për grupin negociator të RSH për negocimin e marrëveshjes së GPA-s me OBT-në që u realizua në muajin Maj.

Me qëllim forcimin e kapaciteteve të anëtarëve të grupit të punës dhe të personave përgjegjës që do të merren drejtpërdrejt me procesin, në datat 15 dhe 16 Mars në Tiranë u zhvillua seminari/workshopi ku pjesëmarrës ishin kryesisht përfaqësues të institucioneve drejtpërdrejt të involvuara me procesin, të tilla si përfaqësues të APP, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Dy anëtarë të Sekretariatit Teknik të GPA-OBT prezantuan për pjesëmarrësit në seminar, çështje teknike dhe aspekte të ndryshme lidhur me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në GPA-OBT.

Në datat 6-7 qershor 2023, delegacioni shqiptar, i kyesuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik dhe nga përfaqësues të tjerë të APP si dhe i shoqëruar nga Sekretari i Parë i Misionit të Republikës së Shqipërisë në Gjenevë, kreu 10 (dhjetë) takime dypalëshe me delegacione të vendeve anëtare në këtë marrëveshje. Takimet dypalëshe u kryen në kontekstin e takimit formal dhe informal të Komitetit mbi GPA.

Ndërkohë, APP dhe grupi negociator përgatitën përgjigjet e pyetësorit të çështjeve për GPA, të cilat iu depozituan pranë Seretariatit Teknik të GPA-OBT në korrik 2023. Pyetësori u shpërnda nga Sekretariati tek anëtarët e GPA për komente dhe sqarime shtesë dhe përgjatë muajit tetor-nëntor 5 (pesë) anëtarë, konkretisht SHBA, BE, Australia, Mbretëria e Bashkuar dhe Hong Kong Kina kanë depozituar kërkesat e tyre për sqarime dhe komente shtesë.

Me asistencën edhe të ekspertëve të EBRD, të cilët po na mbështesin në këtë proces, është punuar lidhur me hartimin e përgjigjeve, të cilat u dërguan pranë Sekretariatit të GPA-OBT në dhjetor 2023 për t'u shpërndarë tek anëtarët e GPA.

Ndërkohë, në datat 7 dhe 8 nëntor 2023, një delegacion i palës shqiptare me përfaqësues të APP, Misionit të RSH në Gjenevë, Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, zhvilloi një seri takimesh dypalëshe me disa delegacione të anëtarëve në Marrëveshjen e Prokurimit Publik të Organizatës Botërore të Tregtisë (GPA), si dhe mori pjesë në takimin formal dhe informal të Komitetit të GPA-së, të datës 8 nëntor 2023.

Diskutimet kryesore në takimet bilaterale të zhvilluara me përfaqësuesit e BE-së, Zelandës së Re, Kanadasë, SHBA-së, Australisë, Japonisë, Maqedonisë së Veriut, Mbretërisë së Bashkuar, Zvicrës dhe me Kryetarin e Komitetit GPA dhe Sekretariatin GPA, u fokusuan kryesisht: (i) tek paraqitja e arritjeve të bëra deri tani në procesin e aderimit në GPA; (ii) vlerësimin lidhur me dërgimin e pyetësorit si dhe mbështetjen e plotë të tyre për aderimin tonë në GPA; (iii) informimin e palëve lidhur me përgatitjen e ofertës ekonomike dhe përgatitjen e përgjigjeve shtesë; si dhe (iv) për të mësuar mbi qëndrimin dhe pritshmërinë e tyre ndaj angazhimit dhe ofertës sonë.

Ndërkohë, Grupi i Punës me asistencën e EBRD po vijon punën edhe me hartimin e draft-Ofertës Ekonomike të mbulimit të tregut.

6

# INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2023

Gjatë vitit 2023, fokusi i punës së APP ka qenë hartimi i ndryshimeve ligjore në fushën e prokurimit publik. Konkretisht, projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i cili u miratua nga Këshilli i Ministrave në muajin Dhjetor.

Nevoja për hartimin e këtij projektligji erdhi si rezultat i domosdoshmërisë së përmirësimit të kuadrit legjislativ për prokurimin publik, duke analizuar problematikat e dala gjatë zbatimit në praktikë të ligjit 162/2020 prej muajit Mars 2021, nga autoritetet kontraktore, operatorët ekonomikë dhe organet audituese, me qëllim lehtësimin e procesit të prokurimit, por edhe duke synuar përafrimin e mëtejshëm të Ligjit me Direktivat e BE, kjo si pjesë dhe e angazhimeve të marra në vijim të takimit dypalësh në kuadër të procesit "screening" për Kapitullin 5 "Prokurimi Publik", të zhvilluar më datë 18 Nëntor 2022.

Pas hartimit të draftit, APP e ka përcjellë atë për veprime të mëtejshme pranë Këshillit të Ministrave. Drafti, pasi ka kaluar procesin e konsultimit publik, si dhe atë të bashkërendimit me Ministritë e linjës, është ripunuar disa herë pas kontributeve dhe mendimeve të dhëna nga ministritë e linjës dhe institucione e organizma të tjerë ndërkombëtar.

## 6.1. Akte Nënligjore

- Hartimi i akteve nënligjore
-

Gjatë këtij viti, APP ka punuar për finalizimin e draftit të projektvendimit mbi përcaktimin e tarifës për procedurën e ankimit. Puna për hartimin e tij ka nisur që prej vitit 2022, kur është hartuar drafti fillestar, për të cilin është vijuar më tej komunikimi dhe bashkëpunimi me Komisionin e Prokurimit Publik, si organi i ngarkuar me ligj për shqyrtimin e ankimit administrativ.

Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 236, datë 20.04.2023 "*Për Përcaktimin e Rregullave dhe pagimit të tarifës së ankesës, për ankimin për një procedurë prokurimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik".*

- Hartimi i udhëzimeve/rekomandimeve për autoritetet/entet kontraktore dhe operatorët ekonomikë
- Në ushtrim të detyrave funksionale edhe gjatë këtij viti nga APP është punuar për hartimin e rekomandimeve/udhëzimeve/sqarimeve të dhëna në ndihmë të autoriteteve/enteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, në funksion të mirëzbatimit të legjislacionit të prokurimit publik.

Konkretisht, gjatë këtij viti janë hartuar **2 (dy)** Sjellje në Vëmendje**, 1 (një)** Udhërrëfyes, si dhe **1** (një) ndryshim në manualin teknik, që shoqëron Udhëzimin e APP nr. 07, datë 30.07.2021 "Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike.

**Tabela 62**

| Sjellje në Vëmendje | Udhërrëfyes | Udhëzim |
|---|---|---|
| **2** | **1** | **1** |

Nëpërmjet akteve të mësipërme, APP ka sjellë në vëmendje të autoriteteve kontraktore:

**- respektimin e afateve ligjore për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit.**

**- Komunikimet, që bëjnë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik gjatë prokurimit të biletave të transportit ajror ndërkombëtar, të jenë sipas parashikimeve në udhëzimet e APP dhe manualeve teknike, respective. (Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike, të ndryshuar dhe Manuali Nr. 1, datë 24.12.2021 "Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik").**

**- Me ndihmën e Bankës Botërore është hartuar dhe publikuar Udhërrëfyesi "Mbi zbatimin e prokurimit të gjelbër në procedurat e prokurimit publik" në zbatim të LPP, Strategjisë Kombëtare të Prokurimit Publik 2020-2023, objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe evropiane, objektivave të legjislacionit për mjedisin, duke patur si objektiv kryesor përcaktimin e udhëzimeve ligjore dhe metodologjike për krijimin e një kuadri mbështetës për zbatimin e prokurimit publik të gjelbër në Shqipëri.**

Nëpërmjet këtij udhërrëfyësi, APP ka patur si qëllim të nxisë autoritetet/entet kontraktore të përdorin Prokurimin Publik të Gjelbër në procedurat e prokurimit publik.

7

# INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2023

Në zbatim të detyrave që i ngarkon legjislacioni në fushën e prokurimit publik, APP ka trajtuar një numër të konsiderueshëm praktikash, të cilat kanë pasur të bëjnë me dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve/enteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve/enteve kontraktore apo edhe të operatorëve ekonomikë për përjashtimin e subjekteve të ndryshme nga e drejta për të fituar kontrata publike në fushën e prokurimeve publike.
Gjatë vitit 2023, APP ka patur komunikime me institucione të ndryshme dhe operatorë ekonomikë, kryesisht me:

i) **Komisionin e Prokurimit Publik, për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik, në funksion të efikasitetit të këtij sistemi;**
ii) **Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe organe të tjera audituese në vend, në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë për vlerësimin e gjetjeve në fushën e prokurimit publik, të këtyre institucioneve gjatë auditimeve të kryera në autoritetet kontraktore, si dhe për cështje të lidhura me sistemin e prokurimit publik;**
iii) **autoritete të ndryshme kontraktore dhe operatorë ekonomikë, të cilët kanë kërkuar mendime dhe sqarime për paqartësi mbi çështje në fushën e prokurimit publik;**
iv) **institucione të qeverisjes qendrore (ministri), në kuadër të dhënies së mendimeve mbi projektakte, që kalojnë për miratim në Këshillin e Ministrave, në fushën e prokurimit publik/koncensioneve/partneritetit publik privat dhe ankandeve publike;**
v) **Institucionet e Prokurorisë, në lidhje me informacione të ndryshme të kërkuara nga ana e tyre mbi procedurat e prokurimit të kryera nga autoritete të ndryshme kontraktore, studio të ndryshme ligjore, të cilat në bazë të së drejtës për informim kanë kërkuar vënien në dispozicion të dokumentave të procedurave të prokurimit apo kanë kërkuar informacion mbi procedura të caktuara prokurimi, organet e medias vizive apo gazetarë të ndryshëm, etj.**
vi) **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministrisë, mbi verifikimin e kërkuar për operatorë ekonomikë të caktuar, nëse ka patur një vendim përjashtimi për to nga APP.**
vii) **Operatorë ekonomikë, të cilët paraqesin denoncime në lidhje me procedurat e prokurimit apo kërkesa/vërtetime të ndryshme.**

Konkretisht, numri total i praktikave të paraqitura për mendim, sqarim apo informacione nga institucione të ndryshme, **në rrugë shkresore**, për çështje që lidhen me procesin e prokurimit publik, koncesioneve/PPP-ve, dhe ankandeve publike **gjatë vitit 2023 është 210 praktika**.

Përveç trajtimit të kërkesave të paraqitura në rrugë shkresore, APP ka qenë e angazhuar maksimalisht për trajtimin e menjëhershëm të çdo kërkese të paraqitur edhe në adresën e saj elektronike.

Duke ju referuar numrit të **kërkesave elektronike** gjatë këtij viti rezultojnë se, janë trajtuar rreth **370 të tilla.** APP i është përgjigjur në mënyrë të shpejtë çdo kërkese për paqartësi që autoritetet kanë gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, apo vështirësi që operatorët ekonomikë hasin gjatë procesit të prokurimit.

Në formë tabelore, këto të dhëna janë si më poshtë:

**Tabela 63**

| Praktikat e shqyrtuara, në kuadër të asistencës ligjore | |
|---|---|
| **Lloji i kërkesës** | **Numri** |
| Kërkesa për dhënie mendimi/sqarimi/komunikim me institucione të tjera, në rrugë shkresore | 95 |
| Kërkesa për dhënie mendimi mbi projevendimet/projektligjet e paraqitura | 21 |
| Verifikime të kërkuara nga ASIK | 10 |
| Vërtetime të lëshuara për operatorët ekonomikë që nuk janë në proces përjashtimi | 2269 |
| Kërkesa të paraqitura nga Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor/SPAK/inst të ndryshme | 25 |
| Ankesa nga operatorë ekonomikë | 34 |
| Shkresa të adresuara gabimisht/përcjellë nga APP pranë institucioneve përkatëse | 25 |
| Kërkesa për dhënie mendimi/sqarimi/komunikim me institucione të tjera, në rrugë elektronike | 370 |

## 7.1. Veprimtaria asistuese e APP

Në kuadër të këtij procesi, për periudhën **Janar-Dhjetor 2023**, nga **5250** procedura të shpallura në Sistemin e Prokurimit Elektronik, janë asistuar në total **2618** procedura prokurimi, nga të cilat **97** me kërkesë paraprake të autoriteteve kontraktore përpara publikimit dhe **2528** pas publikimit të tyre në SPE[9].

Nga **2528** procedura që janë asistuar nga APP pas publikimit përbëjnë **48%** të procedurave të publikuara. Nga procedurat e asistuara, pas publikimit të tyre në SPE, 209 procedura janë anulluar dhe 2319 procedura kanë vijuar procesin e prokurimit.

### 7.1. 1. Analizimi i të dhënave të procedurave të asistuara

Nga procedurat që kanë vijuar procesin e prokurimit, rezulton se:

- 45% e procedurave të asistuara janë procedura të shpallura nga institucionet e qeverisjes qendrore;
- 35% e procedurave të asistuara janë procedura të shpallura nga institucionet vendore;
- 13% e procedurave të asistuara janë procedura të shpallura nga shoqëritë anonime;
- 7% e procedurave të asistuara janë procedura të shpallura nga institucionet e pavarura.

Vlera në përqindje e procedurave të asistuara, krahasuar me vitin 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

9 Përzgjedhja e procedurave që asistohen bëhet bazuar në fondin limit të tyre, duke i dhënë prioritet procedurave me fond limit më të lartë.

**Tabela 64**

| Procedurat | Viti 2022 | Viti 2023 |
|---|---|---|
| **Procedura te publikuara** | **6494** | **5250** |
| **Procedura te asistuara** | **2953** | **2528** |
| **% e procedurave të asistuara kundrejt atyre të publikuara ne SPE** | **45.5%** | **48%** |

Sikurse vihet re, gjatë vitit 2023, APP ka asistuar pothuajse gjysmën e procedurave të publikuara në SPE.

Paraqitja grafike e të dhënave të mësipërme është si më poshtë:




**Grafiku 47**

Nga analiza e bërë, rezulton në rritje edhe numri i procedurave të asistuara me kërkesë paraprake të autoriteteve kontraktore përpara publikimit, pothuajse sa dyfishi i vitit paraardhës, në numër total **97** procedura për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, i cili rezultonte në numër total 59 procedura. Më poshtë, paraqiten disa nga treguesit të cilët konsiderohen si indikatorë të rëndësishëm, për të vlerësuar rezultatin e këtij procesi në vazhdim.

### 7.1.2. Analizimi i të dhënave në lidhje me procedurat që rezultojnë pa problematika, kundrejt procedurave të asistuara

a) **Analizimi i të dhënave të vitit 2023 në krahasim me vitin 2022**

Nga 2319 procedura që janë asistuar pas shpalljes në SPE[10], gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023:

- 37.4% e procedurave të asistuara, kanë rezultuar përgjithësisht në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për prokurimin publik, apo me fushat specifike ku ekzekutimi i objektit të kontratës që prokurohet shtrin veprimtarinë e tij;

10 Në analizë nuk është përfshirë numri i procedurave të anulluara, si dhe lotet trajtohen si një procedurë e vetme.

- 62.6% e procedurave të asistuara, kanë rezultuar me konstatime në lidhje me përmbushjen e kushteve të legjislacionit të zbatueshëm dhe për të cilat u janë dërguar rekomandimet përkatëse autoriteteve kontraktore.

Paraqitja grafike e këtyre të dhënave është si më poshtë:




Grafiku 48

Nisur nga të dhënat e analizuara, rezulton se ka një rritje të lehtë të vlerës në përqindje të numrit të procedurave që rezultojnë pa konstatime në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022. Konkretisht, përqindja e procedurave pa konstatime në raport me procedurat e asistuara është në nivelin 37.4% dhe atyre me konstatime, në nivelin 62.6%, ndërkohë që në vitin 2022, këto përqindje kanë qenë respektivisht në nivelet 37% dhe 63%.

Ndërkohë, në analizim të vlerës absolute të procedurave pa konstatime rezulton se për vitin 2023 janë 943 procedura krahasuar me vitin 2022 që kanë qënë 1020 procedura.

Kjo ulje në vlerë absolute e numrit të procedurave pa konstatime, ka ardhur si pasojë se krahas asistimit dhe kontrollit të dokumentave standarte të tenderit, tashmë si pjesë e procesit të asistimit janë edhe procesverbalët e argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe të kritereve për kualifikim, ku merren në analizë dhe cilësia e argumentimit duke rekomanduar autoritetet për argumentimin kryesisht teknik më të plotë. Rrjedhimisht kjo analizë më e detajuar ka sjellë rritje të numrit të procedurave që rezultojnë me konstatime.

Megjithëse, numri i procedurave me konstatime nga APP mbetet ende i lartë, në një pjesë të mirë të procedurave rekomandimet e APP janë të natyrës argumentuese (jo konstatime për kritere të paligjshme).

**b) Analizimi i të dhënave sipas tipologjisë së autoriteteve kontraktore.**

Nga analiza e raportit të procedurave që kanë rezultuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe atyre që kanë rezultuar me konstatime, kundrejt procedurave të asistuara, të ndara sipas tipologjisë së autoriteteve kontraktore, rezulton duke u renditur si më poshtë:

- Për institucionet qendrore dhe institucionet e tyre të varësisë, 39% e procedurave të asistuara, paraqiten pa konstatime dhe 61% e tyre kanë rezultuar me konstatime;
- Për institucionet e pavarura, 28% e procedurave të asistuara paraqiten pa konstatime dhe 72% e tyre kanë rezultuar me konstatime;

- Për institucionet vendore dhe institucionet e tyre të varësisë, 27% e procedurave të asistuara paraqiten pa konstatime dhe 73% e tyre kanë rezultuar me konstatime;
- Për shoqëritë anonime me kapital shtetëror, 21% e procedurave të asistuara paraqiten pa konstatime dhe 79% e tyre kanë rezultuar me konstatime.

Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se niveli i vlerës në përqindje e procedurave pa problematika është më i lartë tek institucionet qendrore dhe në varësi të tyre, konkretisht 39% të procedurave të asistuara, dhe niveli më i ulët rezulton të shoqëritë anonime me kapital shtetëror, konkretisht 21% të procedurave të asistuara

.

Paraqitja grafike e këtyre të dhënave është si më poshtë:




**Grafiku 49**

### 7.1.3. Analizimi i të dhënave në lidhje me reagimin/reflektimin e autoriteteve kontraktore, ndaj rekomandimeve të APP.

#### a) Analizimi i të dhënave të vitit 2023 në krahasim me vitin 2022

Nga analizimi i nivelit të reagimit të autoriteteve kontraktore, kundrejt rekomandimeve që APP jep në lidhje me problematikat e konstatuara në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, veçanërisht të kritereve të veçanta për kualifikim, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrje/konkurim në prokurim, rezulton se për periudhën që analizohet Janar-Dhjetor 2023, nga procedurat e asistuara, për të cilat APP ka dërguar rekomandimet janë:

- në 66% të rasteve, autoritetet kontraktore kanë reflektuar ndaj rekomandimeve të APP;
- në 34% të rasteve, autoritetet nuk kanë reaguar ose nuk kanë reflektuar rekomandimet e APP.

Në një këndvështrim krahasimor në lidhje me vitin 2022, ku niveli në përqindje i reflektimeve ka qenë 69.2% dhe niveli në përqindje i mos reflektimeve në 30.8%, rezulton se në vitin 2023 niveli i reflektimit të autoriteteve kontraktore ndaj rekomandimeve të dhëna nga APP rezulton pothuajse në të njëjtat nivele.

Më poshtë, jepen të dhënat krahasimore, për vitet 2022-2023, në lidhje me numrin e procedurave për të cilat janë dërguar rekomandime nga APP dhe numrin e procedurave për të cilat AK kanë reflektuar rekomandimet:

**Tabela 65**

| Procedurat | Viti 2022 | Viti 2023 |
|---|---|---|
| **Procedura për të cilat janë dërguar rekomandime nga APP** | **1762** | **1585** |
| **Procedura për të cilat AK kanë reflektuar rekomandimet** | **1219** | **1044** |
| **% e procedurave me reflektime kundrejt procedurave me rekomandime** | **69.2%** | **66%** |

## b) **Analizimi i të dhënave sipas tipologjisë së autoriteteve kontraktore**

Raporti i reflektimeve dhe mosreflektimeve, kundrejt rekomandimeve të dërguara nga APP, rezulton i ndryshëm për institucionet, sipas tipologjisë së tyre.
Konkretisht:

- Për shoqëritë anonime me kapital shtetëror, raporti i nivelit të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, është në masën 77%, ndërkohë që raporti i nivelit të mosreflektimeve ndaj rekomandimeve të APP është në masën 23%.
- Për institucionet e pavarura, raporti i nivelit të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, është në masën 78%, ndërkohë që raporti i nivelit të mosreflektimeve ndaj rekomandimeve të APP është në masën 22%.
- Për institucionet qëndrore dhe institucionet e tyre të varësisë, raporti i nivelit të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, është në masën 70%, ndërkohë që raporti i nivelit të mosreflektimeve ndaj rekomandimeve të APP është në masën 30%.
- Për insitucionet vendore dhe institucionet e tyre të varësisë, raporti i nivelit të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, është në masën 55%, ndërkohë që raporti i nivelit të mosreflektimeve ndaj rekomandimeve të APP është në masën 45%.

Paraqitja grafike e këtyre të dhënave është si më poshtë:




**Grafiku 50**

Nga sa më lart, rezulton se institucionet e pavarura kanë përqindjen më të lartë të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, konkretisht 78% të procedurave me konstatime, ndërkohë që institucionet e qeverisjes vendore kanë përqindjen më të ulët të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, konkretisht, 55% të procedurave me konstatime.

### 7.1.4. Analizimi i të dhënave në lidhje me mesataren e numrit të ofertave të paraqitura dhe ofertave të kualifikuara në procedurat e asistuara nga APP.

Një tregues shumë i rëndësishëm që vlerësohet nga monitorimi i procedurave të asistuara është edhe niveli i pjesëmarrjes së Operatorëve Ekonomikë, si tregues i drejtpërdrejtë i konkurrencës në procedurat e prokurimit publik.

Nga shqyrtimi i të dhënave në lidhje me numrin e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e asistuara nga APP, për periudhën Janar-Dhjetor 2023, për të cilat janë dërguar rekomandime, rezulton se:

- Në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 4.5 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 2.99 oferta.
- Në procedurat që kanë reflektuar pjesërisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 4.45 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 2.8 oferta.
- Në procedurat që nuk kanë reaguar/reflektuar rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 2.7 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.69 oferta.

Grafikisht, mesatarja e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e asistuara, të ndara sipas reagimeve/reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, paraqiten si më poshtë:




**Grafiku 51**

Nga analizimi i mësipërm, rezulton se mesatarja më e lartë e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara është në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, respektivisht në nivelin 4.5 oferta të paraqitura dhe 2.99 oferta të kualifikuara.

Pra, nga sa më sipër vihet re se sa më shumë autoritetet kontraktore reflektojnë rekomandimet e dërguara, në drejtim të hartimit të kritereve sa më konkuruese, aq më e lartë rezulton mesatarja e ofertave të dorëzuara dhe atyre të kualifikuara.

Në këtë kuptim, hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve sa më të qarta, transparente dhe konkurruese ndikon në rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit.
Të dhënat mbi pjesëmarrjen janë analizuar edhe sipas tipologjisë së autoriteteve kontraktore. Konkretisht:

Nga shqyrtimi i të dhënave në lidhje me numrin e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e autoriteteve kontraktore **të nivelit qendror**, që janë asistuar nga APP për periudhën Janar-Dhjetor 2023 për të cilat janë dërguar rekomandime, rezulton se:

- Në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 5.1 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 3.37 oferta.
- Në procedurat që kanë reflektuar pjesërisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 4.86 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 2.84 oferta.
- Në procedurat që nuk kanë reaguar/reflektuar rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 2.04 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.29 oferta.

Nga analizimi i mësipërm, rezulton se për autoritetet kontraktore të nivelit qendror, mesatarja më e lartë e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara është në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, respektivisht në nivelin 5.1 oferta të paraqitura dhe 3.37 oferta të kualifikuara.

Grafikisht, mesatarja e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e asistuara të institucioneve qëndrore, paraqiten si më poshtë:




**Grafiku 52**

Nga shqyrtimi i të dhënave në lidhje me numrin e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e autoriteteve kontraktore **të nivelit vendor**, që janë asistuar nga APP, për periudhën Janar-Dhjetor 2023, për të cilat janë dërguar rekomandime, rezulton se:

- Në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 5.08 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 3.28 oferta.

- Në procedurat që kanë reflektuar pjesërisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 4.53 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 3.24 oferta.

- Në procedurat që nuk kanë reaguar/reflektuar rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 3.54 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 2.27 oferta.

Nga analizimi i mësipërm, rezulton se për autoritetet kontraktore të nivelit vendor, mesatarja më e lartë e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara është në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, respektivisht në nivelin 5.08 oferta të paraqitura dhe 3.28 oferta të kualifikuara.

Grafikisht, mesatarja e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e asistuara, të ndara sipas reagimeve/reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, paraqiten si më poshtë:

**Grafiku 53**




Nga shqyrtimi i të dhënave në lidhje me numrin e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e autoriteteve kontraktore të pavarura, që janë asistuar nga APP, për periudhën Janar-Dhjetor 2023, për të cilat janë dërguar rekomandime, rezulton se:

- Në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 3.17 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.9 oferta.

- Në procedurat që kanë reflektuar pjesërisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 3 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.67 oferta.

- Në procedurat që nuk kanë reaguar/reflektuar rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 1.91 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.23 oferta.

Nga analizimi i mësipërm, rezulton se për autoritetet kontraktore të pavarura, mesatarja më e lartë e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara është në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, respektivisht në nivelin 3.17 oferta të paraqitura dhe 1.9 oferta të kualifikuara.

Grafikisht, mesatarja e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e asistuara, të ndara sipas reagimeve/reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, paraqiten si më poshtë:

**Grafiku 54**




Nga shqyrtimi i të dhënave në lidhje me numrin e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e autoriteteve kontraktore **shoqëri anonime**, që janë asistuar nga APP, për periudhën Janar-Dhjetor 2023, për të cilat janë dërguar rekomandime, rezulton se:

- Në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 2.79 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.74 oferta.
- Në procedurat që kanë reflektuar pjesërisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 2.35 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.35 oferta.
- Në procedurat që nuk kanë reaguar/reflektuar rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 1.9 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.12 oferta.

Nga analizimi i mësipërm, rezulton se për autoritetet kontraktore të pavarura, mesatarja më e lartë e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara është në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, respektivisht në nivelin 2.79 oferta të paraqitura dhe 1.74 oferta të kualifikuara.

Grafikisht, mesatarja e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e asistuara, të ndara sipas reagimeve/reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, paraqiten si më poshtë:

**Grafiku 55**




Ndër të tjera, nga analizimi **i raportit të ofertave të kualifikuara dhe atyre të skualifikuara**, kundrejt ofertave të paraqitura, në procedurat e asistuara nga APP, për periudhën Janar-Dhjetor 2023, rezulton se:

- Në procedurat që kanë rezultuar pa problematika, përqindja e ofertave të kualifikuara është 66% e ofertave të paraqitura, ndërkohë që përqindja e ofertave të skualifikuara është 34%.

- Në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, përqindja e ofertave të kualifikuara është 65% e ofertave të paraqitura, ndërkohë që përqindja e ofertave të skualifikuara është 35%.

- Në procedurat që kanë reflektuar pjesërisht rekomandimet e APP, përqindja e ofertave të kualifikuara është 64% e ofertave të paraqitura, ndërkohë që përqindja e ofertave të skualifikuara është 36%.

- Në procedurat që nuk kanë reaguar/reflektuar rekomandimet e APP, përqindja e ofertave të kualifikuara është 61% e ofertave të paraqitura, ndërkohë që përqindja e ofertave të skualifikuara është 39%.

Grafikisht, raporti i ofertave të kualifikuara dhe atyre të skualifikuara, kundrejt ofertave të paraqitura, në procedurat e asistuara, të ndara sipas reagimeve/reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, paraqiten si më poshtë:

**Grafiku 56**




Nga sa më lart, rezulton se përqindja e ofertave të kualifikuara është më e lartë në procedurat që kanë rezultuar pa problematika, konkretisht në nivelin 66%, ndërkohë që niveli më i ulët i ofertave të kualifikuara rezulton në procedurat që nuk kanë reaguar/reflektuar rekomandimet e APP, konkretisht në nivelin 61%.

Rrjedhimisht, vihet re një lidhje e drejtë midis nivelit më të lartë të kualifikimit të ofertave, me procedurat të cilat APP i ka gjykuar në përputhje me dispozitat ligjore të prokurimit publik.

# 8

# VERIFIKIMI I ZBATIMIT TË LIGJSHMËRISË SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK

## 8.1. Verifikimi ex-post i zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit, Koncesioneve/PPP dhe Ankandeve publike

Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" (LPP), APP verifikon (*ex post*) zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit ose anulimit të procedurës.

Gjatë këtij viti, procesi i verifikimit është iniciuar mbi këto baza:

- Kryesisht, me nismën e APP, nëpërmjet hartimit të planeve të verifikimit;
- Reklamim nga të tretët;
- Raste të evidentuara nga APP nëpërmjet komunikimit shkresor me autoritete të ndryshme kontraktore;
- Indicie nga raportet e organeve audituese (kryesisht Kontrolli i Lartë i Shtetit), si dhe nga institucione të tjera, si Komisioni i Prokurimit Publik (KPP).

Sa i takon verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, është proceduar si vijon:

➢ ***Verifikimi i procedurave ku hetimi administrativ është iniciuar kryesisht, nëpërmjet hartimit të planeve të verifikimit*.**

Së pari, gjatë kësaj periudhe është përfunduar verifikimi i procedurave të prokurimit, objekt i Planit të Verifikimit të nisur në fund të vitit 2022.

Konkretisht, subjekt i planit në fjalë të verifikimit ishin **12 autoritete kontraktore** për procedura prokurimi me vlerë të vogël, të cilat janë denoncuar nga operatorë ekonomikë. Këta të fundit kanë pretenduar mosrespektim të legjislacionit të prokurimit publik dhe kanë kërkuar nga APP, kryerjen e hetimit administrativ. Zbatimi i këtij plani u strukturua dhe u realizua në dy faza.

Konkretisht, u vijua si fillim komunikimi me autoritetet kontraktore përkatëse për verifikimin e gjashtë procedurave dhe, më pas, në përfundim të këtij procesi nëpërmjet vendimeve përkatëse përfundimtare, u vijua komunikimi për verifikimin e gjashtë procedurave të tjera.

Për një procedurë është vendosur mbyllja e hetimit administrativ, duke qenë se, nuk rezultuan shkelje të dispozitave ligjore të prokurimit, të cilat çojnë në marrjen e masave administrative sipas nenit 132 të LPP. Ndërsa, për procedurat e tjera objekt i këtij plani, në përfundim të hetimit administrativ është propozuar marrja e masës disiplinore për personat e evidentuar përgjegjës.

Me qëllim ndërgjegjësimin e autoriteteve kontraktore në mirë-zbatimin e legjislacionit të prokurimit, **në përfundim të planit të verifikimit, është publikuar në faqen e internetit të APP, Njoftimi Nr. 7931/3 Prot., datë 09.06.2023 "Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë", drejtuar të gjithë autoriteteve kontraktore.**

Së dyti, në muajin Korrik u miratua një tjetër plan verifikimi me fokus katër drejtime. Konkretisht:

**1. Mbi monitorimin e procesit të planifikimit të nevojave dhe realizimit të tyre në kohë**.

Duke analizuar të dhënat e raporteve vjetore, si dhe raporte të organizmave ndërkombëtarë, është vënë re nevoja për një vlerësim të situatës sa i takon procesit të planifikimit nga autoritetet/entet kontraktore të nevojave të tyre dhe finalizimit në kohë të procedurave të prokurimit.

Në këtë mënyrë, u vlerësua që planifikimi i procedurave të prokurimit, si një aspekt i rëndësishëm i prokurimit, të jetë pjesë e analizimit të problematikave të mundshme që lidhen me këtë proces.

Për këtë qëllim, është përpunuar informacioni mbi procesin e planifikimit të procedurave të prokurimit të parashikuara në regjistrin e parashikimeve nga autoritetet/entet kontraktore, shoqëruar me të dhëna konkrete mbi procedura dhe autoritete/ente kontraktore, për të cilat mund të jenë evidentuar problematika, konkretisht, informacion i gjeneruar nga sistemi i prokurimit elektronik sa i takon regjistrit të parashikimeve për vitin 2022, lidhur me elementë regjistri (pa përfshirë blerjet me vlerë të vogël, blerjet dinamike të biletave për transportin ajror ndërkombëtar dhe negocimet pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës), të parashikuar nga autoritete kontraktore, por të parealizuara brenda afatit të planifikuar.

Në plan u përfshin për vlerësim të mëtejshëm **50 autoritete kontraktore**, të cilat rezultojnë me numrin më të lartë të elementëve të regjistrit të parealizuar, respektivisht për gjashtë-mujorin e parë (Janar – Qershor) dhe të dytë (Korrik – Dhjetor) të vitit 2022, njëkohësisht rezultojnë edhe të përsëritur në të dy gjashtë-mujorët.

**2. Mbi analizimin e situatës lidhur me argumentimin konkret të specifikimeve teknike/kritereve të kualifikimit në procesverbalin përkatës**.

Legjislacioni i ri i prokurimit publik parashikon publikimin në sistemin e prokurimit elektronik, të procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Publikimi i këtij procesverbali është një masë e shtuar jo vetëm në kuadër të transparencës, por edhe me qëllim që autoritetet/entet kontraktore të respektojnë detyrimet ligjore të prokurimit për të argumentuar teknikisht dhe ligjërisht domosdoshmërinë e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për publikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në këtë mënyrë, duke marrë shkas nga ky detyrim i ri ligjor dhe për të parë si respektohet nga autoritetet/entet kontraktore në praktikë, u vlerësua që pjesë e një analizimi të jetë edhe situata sa i takon argumentimit konkret të specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit, në procesverbalin përkatës të publikuar me dokumentet e tenderit.

Për këtë qëllim, u përpunua informacion me listën e autoriteteve kontraktore bashkë me të dhënat e procedurave përkatëse të prokurimit, për të cilat, autoritetet nuk kanë argumentuar në procesverbal specifikimet dhe secilin prej kritereve të vendosura.
Për të analizuar këtë situatë rast pas rasti dhe për të parë nëse autoritetet kontraktore argumentojnë në procesverbal domosdoshmërinë e çdo kërkese të përcaktuar për objektin e prokurimit, pavarësisht se vetë kërkesa mund të jetë në përputhje dhe proporcionale me objektin e kontratës, u vlerësua që të fokusohemi në procesverbalet përkatëse, të publikuara me dokumentet e tenderit.

Subjekt i qëllimit të kësaj analize janë të gjithë autoritetet kontraktore të evidentuara në kuadër të procesit të asistimit që u bëhet autoriteteve në fazën e shpalljes së procedurave, gjithsej **13 autoritete kontraktore** lidhur me **19 procedura prokurimi**.

**3. Mbi monitorimin e procedurave të denoncuara nga operatorë ekonomikë.**

Në planin në fjalë të verifikimit janë përfshirë edhe procedura prokurimi të denoncuara nga operatorë ekonomikë. Konkretisht, u vlerësua të përfshihen për verifikim të mëtejshëm, pretendimet e parashtruara për procedura prokurimi mbi kufirin monetar të procedurave me vlerë të vogël, duke qenë se, këto të fundit kanë qenë në mënyrë të vazhdueshme objekt verifikimi nga APP.

Subjekt i planit në drejtim të monitorimit të procedurave të denoncuara nga operatorë ekonomikë janë **6 autoritete kontraktore**.

**4. Mbi raste të administruara në institucion, si rezultat i komunikimeve të institucionit me autoritete kontraktore.**

Së fundmi, në plan janë përfshirë edhe raste të administruara në institucion nga **2 autoritete kontraktore**.

- Zbatimi i këtij plani është strukturuar në dy faza. Në fazën e parë u vlerësua që të përfshihet analizimi i situatës që lidhet me argumentimin konkret të specifikimeve teknike/kritereve të kualifikimit në procesverbalet përkatës, si dhe verifikimi i procedurave/rasteve të denoncuara në institucion nga operatorë ekonomikë dhe autoritete/institucione të ndryshme.

Ndërsa, në fazën e dytë është parashikuar vijimi me monitorimin e procesit të planifikimit të nevojave dhe realizimit të tyre në kohë.

Aktualisht, ka përfunduar zbatimi i fazës së parë të planit, sa i takon analizimit të situatës që lidhet me argumentimin konkret të specifikimeve teknike/kritereve të kualifikimit në procesverbalet përkatëse në 19 procedura prokurimi, lidhur me 13 autoritete kontraktore.

Gjithashtu, ka përfunduar verifikimi për 8 autoritete kontraktore, të përfshira në plan, për rastet e denoncuara/përcjella nga operatorët ekonomikë/autoritetet kontraktore.
Njëkohësisht, ka nisur zbatimi i fazës së dytë të këtij plani, në kuadër të të cilit është kërkuar informacion nga autoritetet kontraktore subjekt monitorimi, mbi arsyet e mos-realizimit brenda afatit të planifikuar (Janar-Dhjetor 2022), për elementë të parashikuar në regjistrin e parashikimeve të vitit 2022.

➢ ***Verifikimi i procedurave të përcjella për kompetencë dhe të denoncuara në APP, nga palë të treta.***

- KPP i ka propozuar në disa raste APP nisjen e hetimit administrativ, në vendimet e marra gjatë trajtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë në procedura të ndryshme prokurimi. Në këtë mënyrë, është kërkuar nga autoritetet përkatëse të dërgojnë informacion mbi veprimet e kryera dhe dokumentacionin përkatës provues lidhur me këto veprime, përsa është propozuar për hetim nga KPP.

Gjatë kësaj periudhe, është përfunduar trajtimi për konstatime në vendimet e KPP për 12 autoritete kontraktore lidhur me 13 procedura prokurimi.

- Denoncime për procedura prokurimi janë paraqitur edhe në Platformën e Bashkëqeverisjes nga katër operatorë ekonomikë (të paraqitura edhe në formë shkresore nga tre prej tyre), për të cilët janë përgatitur përgjigjet përkatëse. Procedurat e denoncuara nga njëri prej operatorëve janë përfshirë për verifikim në planin e verifikimit (të miratuar në muajin Korrik), verifikimi i të cilave ka përfunduar dhe APP ka dalë me vendimet përkatëse.

Ndërkohë, pretendimet e dy operatorëve të tjerë ekonomikë lidhen me procedura prokurimi me vlerë të vogël, të cilat do të vlerësohen më tej për verifikim, duke qenë se, fokus i është dhënë procedurave me vlerë mbi kufirin e procedurave me vlerë të vogël. Gjithashtu, operatori i katërt është sqaruar lidhur me pretendimet e paraqitura dhe parashikimet e legjislacionit të prokurimit lidhur me këto pretendime.

Gjatë kësaj periudhe janë paraqitur në formë shkresore kërkesa për hetim nga operatorë të ndryshëm ekonomikë, të cilat do të vlerësohen më tej për qëllime verifikimi.

- ➢ Verifikimi i procedurave të evidentuara nga vetë APP nëpërmjet komunikimeve të ndryshme me autoritetet kontraktore.

Në kuadër të komunikimit shkresor të institucionit me **dy autoritete kontraktore** dhe dokumentacionit të administruar/. në kuadër të këtij komunikimi, janë vërejtur problematika të autoriteteve kontraktore në procesin e vlerësimit të ofertave.

- ***Verifikim i indicieve nga raportet përfundimtare të organeve audituese***
  - ➢ Veprimtaria e punës së APP, ndërmjet të tjerash, është fokusuar edhe në verifikimin e gjetjeve të evidentuara nga auditimet e kryera dhe të paraqitura në institucion.

Gjetjet e përcjella në raportet përfundimtare të auditimit kanë shërbyer si indicie për verifikim, në kuadër të bashkëpunimit me organet audituese, e parashikuar në Ligjin Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Mbi këtë bazë, gjatë kësaj periudhe, pranë APP janë përcjellë raportet përkatëse të auditimit nga institucionet audituese në vend, dhe janë marrë në shqyrtim gjetjet për procedurat e prokurimit të audituara, të përfshira në këto raporte.

Gjatë periudhës së raportimit ka përfunduar verifikimi i gjetjeve të pasqyruara në 5 raporte auditimi, ku subjekt auditimi kanë qenë **5 autoritete kontraktore**, lidhur me **89 procedura prokurimi**. Në përfundim të verifikimit, APP ka dalë me vendime për masa penalizuese.

Në vijim, në formë tabelore, paraqiten të dhëna mbi verifikimet e kryera dhe të përfunduara gjatë vitit 2023:

**Tabela 66**

| Të dhëna mbi verifikimet e procedurave të prokurimit publik në vitin 2023 | |
|---|---|
| **Autoritete Kontraktore, subjekt verifikimi** | **48** |
| **Procedura prokurimi të verifikuara** | **145** |

Të dhëna mbi llojet e procedurave të prokurimit të verifikuara, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 67**

| Lloji i procedurës së prokurimit publik | Numri |
|---|---|
| **Procedurë e hapur** | **67** |
| **Procedurë e kufizuar** | **3** |
| **Kërkesë për propozim** | **7** |
| **E hapur e thjeshtuar** | **14** |
| **Shërbim konsulence** | **2** |
| **Me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës** | **1** |
| **Procedurë prokurimi me vlerë të vogël** | **51** |
| **TOTALI** | **145** |

- **Masat administrative dhe raportimi**

**Masat administrative**

- Gjatë këtij viti, nga verifikimet e kryera **për procedurat e prokurimit publik**, APP ka konkluduar me vendime për masa penalizuese, konform parashikimeve ligjore në **29 raste**.

U është tërhequr vëmendja autoriteteve kontraktore, në 15 raste për shmangien e situatave të njëjta në të ardhmen, ndërsa për 6 raste është mbyllur hetimi administrativ.

Të dhëna në formë tabelore, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 68**

| Vendimmarrja e APP në përfundim të verifikimeve të procedurave të prokurimit publik | |
|---|---|
| Vendime me masa administrative (gjobë dhe/ose propozim për masë disiplinore) | 29 |
| Vendime për mbyllje hetimi administrativ/ tërheqje vëmendje dhe orientim i përgjithshëm | 21 |

Të dhëna mbi masat administrative (gjobë/propozim masë disiplinore) të vendosura nga APP, në përfundim të verifikimeve të procedurave të prokurimit publik, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 69**

| Gjobë | Propozim për masë disiplinore |
|---|---|
| për 77 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi | për 75 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi |

Të dhëna mbi vendimet, sipas rolit të personit në procedurat e prokurimit të verifikuara dhe sipas numrit të autoriteteve kontraktore, pasqyrohen në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 70**

| Penalizime me gjobë | |
|---|---|
| **Roli i zyrtarit** | **Numri i Autoriteteve Kontraktore** |
| Anëtar i njësisë së prokurimit/specialist i fushës/ anëtar i hartimit të specifikimeve teknike | 4 Autoritete Kontraktore |
| Person përgjegjës për përllogaritjen e fondit limit | 3 Autoritete Kontraktore |
| Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave | 6 Autoritete Kontraktore |
| Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël | 1 Autoritet Kontraktor |

**Tabela 71**

| Propozim për masë disiplinore | |
|---|---|
| **Roli i zyrtarit** | **Numri i Autoriteteve Kontraktore** |
| Anëtar i grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit/përcaktimin e numrit të punonjësve, mbi bazën e të cilit është përllogaritur fondi limit | 2 Autoritete Kontraktore |
| Person Përgjegjës për Prokurimin | 4 Autoritete Kontraktore |
| Anëtar i njësisë së prokurimit/ anëtar i hartimit të termave të referencës dhe specifikimeve teknike | 4 Autoritete Kontraktore |
| Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave | 7 Autoritete Kontraktore |
| Anëtar i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave | 3 Autoritete Kontraktore |
| Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël | 12 Autoritete Kontraktore |

**- Raportimi i Masave**

Sipas kuadrit rregullator të prokurimit publik, autoritetet kontraktore kanë detyrimin për të raportuar në APP, mbi veprimet e ndërmarra në zbatim të masave të dhëna nga kjo e fundit, në vendimet e hetimit administrativ të procedurave dhe vendimet për verifikimin e gjetjeve si rezultat i indicieve nga raportet përfundimtare të auditimit.

Vlen të theksohet se, në shumicën e rasteve autoritetet kontraktore kanë dërguar informacion mbi veprimet e marra në zbatim të vendimeve të APP, megjithëse në disa raste APP i është dashur të përsërisë kërkesën për informacion.

**a)** Sa i takon vendimeve të dhëna nga APP, për dënimin me gjobë të personave përgjegjës, nga informacioni i administruar ka rezultuar se:

- është informuar APP për ekzekutim të gjobave të vendosura në **5 vendime**;

- në pritje të informacionit të mëtejshëm nga autoriteti kontraktor për **2 vendime**.

**b)** Sa i takon vendimeve të dhëna nga APP, për propozim mase disiplinore ndaj personave përgjegjës, nga informacioni i administruar ka rezultuar se:

- është dhënë masë disiplinore vërejtje/vërejtje me shkrim/vërejtje me paralajmërim/ pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pages për një periudhë deri në dy vjet tërheqje vëmendje, në **16 autoritete kontraktore**;

- është ndërprerë ecuria disiplinore nga **2 autoritete kontraktore**;

- është informuar APP për ankim në gjykatë nga **2 autoritete kontraktore**;

- në pritje të informacionit përkatës nga **6 autoritete kontraktore**.

**Tabela 72**

| Vendime të APP për penalizim me gjobë | 7 vendime (patur në konsideratë që ka vendime njëkohësisht me masa administrative gjobë dhe propozim për masë disiplinore) |
|---|---|
| Informacion për ekzekutim | 5 vendime |
| Në pritje të informacionit nga autoritetet kontrakto-re | 2 vendime |

**Tabela 73**

| Vendime të APP për propozim mase disiplinore | 26 vendime (patur në konsideratë që ka vendime njëkohësisht me masa administrative gjobë dhe propozim për masë disiplinore) |
|---|---|
| Është dhënë masë disiplinore vërejtje/vërejtje me shkrim/vërejtje me paralajmërim/tërheqje vëmendje/ pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet | 16 autoritete kontraktore |
| Është ndërprerë ecuria disiplinore | 2 autoritete kontraktore |
| Është informuar APP për ankim në gjykatë | 2 autoritete kontraktore |
| Në pritje të informacionit nga autoritetet kontrakto-re | 6 autoritete kontraktore |

## 8.2. Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të ankandit publik, Koncesioneve/ PPP dhe prokurimeve në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Në zbatim të detyrave të ngarkuara nga Ligji nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar (LKPPP), Ligji Nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar (LAP), Ligji Nr. 36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë" (LPFMS), veprimtaria e APP fokusohet në hetimin administrativ, nëpërmjet verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të koncesioneve/PPP, ankandit publik dhe prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, pas fazës së nënshkrimit të kontratës.

- Sa i takon verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë në procedurat e ankandit publik, gjatë vitit 2023 ka përfunduar faza e dytë e planit të verifikimit, lidhur me verifikimin e procedurave të ankandit publik të zhvilluara nga autoritetet shitëse gjatë vitit 2021.

  Konkretisht, ka përfunduar hetimi administrativ për:

  - Subjekte të audituara **6 Autoritete Shitëse**;
  - **6 procedura ankandi publik**.

Të pasqyruara në formë tabelare si vijon:

**Tabela 74**

| Autoritete shitëse të audituara | Procedura Ankandi të audituara | Llojet e procedurave |
|---|---|---|
| 6 autoritete shitëse | 6 procedura ankandi publik | Procedurë e hapur |

Në kuadër të procesit të monitorimit, pas gjetjeve të evidentuara, APP ka hartuar dhe publikuar një rekomandim "Mbi problematikat e konstatuara gjatë verifikimit të procedurave të ankandit publik", drejtuar të gjithë autoriteteve shitëse dhe të gjithë operatorëve ekonomikë, me qëllim orientimin e autoriteteve shitëse në drejtim të zbatimit me rigorozitet të legjislacionit të ankandit publik.

### Masat administrative dhe raportimi

- **Masat administrative**

  Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023, nga hetimet administrative të kryera mbi zbatimin e ligjshmërisë së **procedurave të ankandit publik**, APP ka konkluduar me vendime për masa penalizuese, konform parashikimeve ligjore në **6 raste**.

**Të dhënat statistikore** mbi masat administrative të vendosura nga APP, **në përfundim të hetimit administrativ**, paraqiten në vijim:

**Tabela 75**

| Gjobë | Propozim për masë disiplinore |
|---|---|
| për 5 punonjës në 1 Autoritet Shitës, subjekt verifikimi | për 19 punonjës në 5 Autoritete Shitëse, subjekt verifikimi |

Nisur nga roli i personit në procedurën e prokurimit të verifikuar, **të dhënat sipas numrit të autoriteteve shitëse**:

**Tabela 76**

| Penalizime me gjobë | |
|---|---|
| Roli i zyrtarit | Numri |
| Anëtar i njësisë së ankandit | 1 Autoritet Shitës |

**Tabela 77**

| Propozim për masë disiplinore | |
|---|---|
| **Roli i zyrtarit** | **Numri** |
| **Anëtar i njësisë së ankandit** | **5 Autoritete Shitëse** |

- **Raportimi i Masave**

Bazuar në vendimin e APP, autoritetet shitëse kanë detyrimin për të raportuar në APP, mbi veprimet e ndërmarra në zbatim të masave të dhëna nga kjo e fundit, në vendimet e hetimit administrativ të procedurave dhe vendimet për verifikimin e gjetjeve si rezultat i indicieve nga raportet përfundimtare të auditimit.

- Sa i takon vendimit të dhënë nga APP, në përfundim të hetimit administrativ të kryer prej saj, për **dënimin me gjobë** të anëtarëve të njësisë së ankandit, rezulton se, autoriteti shitës ka raportuar se, anëtarët e njësisë së ankandit kanë ankimuar në gjykatë vendimin.

- Sa i takon vendimit të dhënë nga APP, në përfundim të hetimeve administrative të kryera prej saj, **për propozim mase disiplinore** ndaj anëtarëve të njësisë së ankandit pranë 5 autoriteteve shitëse, rezulton se, këto autoritete kanë raportuar pranë APP mbi zbatimin e masës.

- **Raportimi i autoriteteve shitëse mbi veprimtarinë e ankandit publik dhe adresimi i problematikave**

Në respektim të detyrimit të LAP, rezulton se, pranë APP kanë dërguar raportimin për veprimtarinë e ankandit të 6-mujorit të parë të vitit 2023, 20 autoritete shitëse. Nga analizimi i raportimeve rezulton që pjesa më e konsiderueshme e procedurave të shpallura, janë anulluar.

Referuar raportimeve të dërguara nga autoritetet shitëse, arsyeja kryesore për anulimin e procedurave ka qenë mosparaqitja e asnjë operatori ekonomik të interesuar, ose mosparaqitja e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues në ditën e nënshkrimit të kontratës. Objekti i shitjes së procedurave të ankandit ka qenë kryesisht: tokë arë, skrap, etj.

Raportimi për 6 mujorin e dytë të vitit, sipas parashikimeve ligjore vijon të bëhet në muajin Janar të vitit pasardhës.

Në përfundim të analizës mbi rezultatet e verifikimeve dhe raportimeve u arrit në dy konkluzione kryesore:

1. Në kuadër të përmbushjes së detyrave të saj, gjatë komunikimit me autoritetet shitëse lidhur me problematikat e evidentuara gjatë zhvillimit të procedurave të ankandit publik, si dhe analizimit të informacioneve të raportuara prej tyre, APP ka vlerësuar se kuadri rregullator i ankandit publik ka nevojë për ndryshime dhe përmirësime, që adresojnë këto problematika, si dhe për të qenë në koherencë me parashikimet e reja legjislative, ku LAP ndërvepron, siç është ligji për prokurimin publik.

Në vijim, duke marrë në konsideratë edhe problematikat e evidentuara gjatë procesit të monitorimit të 8 procedurave të ankandit, objekt hetimi administrativ, APP vlerësoi si të nevojshme adresimin e tyre pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke rikërkuar marrjen në konsideratë të iniciativës për përmirësimin e kuadrit rregullator të ankandit publik.

2. Duke qenë se, legjislacioni i ankandit publik ka ndër qëllimet kryesore të tij, nxitjen e pjesëmarrjes së blerësve në procedurat e ankandit publik dhe në veçanti të biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe i jep mundësinë si personave fizikë, ashtu edhe atyre juridikë për të qenë ofertues në një procedurë ankandi, APP ka vlerësuar se, disa nga kriteret e përcaktuara në udhëzimin Nr. 2, datë 03.03.2017 *"Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje"*, të Ministrit të Mjedisit. nuk janë në harmoni me frymën dhe përcaktimet e legjislacionit të ankandit publik.

Në këtë kuptim, APP ka vlerësuar adresimin e kësaj problematike pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke sugjeruar të merret në konsideratë iniciativa për rishikimin e këtij udhëzimi.

- Sa i takon verifikimit të **zbatimit të ligjshmërisë në fushën e koncesioneve/ppp**, në vitin 2023 është hartuar plan verifikimi për një procedurë koncesionare, ku aktualisht hetimi administrativ është në proces.

Vlen të thekohet gjithashtu, se APP është pjesë e grupit të punës për hartimin e ligjit të ri të koncesioneve/ppp dhe ka punuar ngushtësisht me ekspertë të Sigmas për draftimin e pjesës proceduriale të këtij akti, me qëllim përafrimin e tij me Direktivat e BE në fushën e koncesioneve/ppp.

- Sa i takon **prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë**, përgjatë vitit 2023 është punuar në vijimësi për krijimin e infrastrukturës së nevojshme sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, si nga ana e kapaciteteve administrative për pajisjen e punonjësve me CSI, ashtu edhe të infrastrukturës së nevojshme teknike.

Aktualisht, pritet të përfundojë procesi i implementimit dhe akreditimit të Sistemit të Komunikimit të Informacionit, në të cilin do të operohet/prodhohet/përpunohet informacioni i klasifikuar "Sekret shtetëror", **për të vijuar me hartimin e planit të verifikimit të procedurave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, sipas legjislacionit në fuqi.**

- **Publikimi i Vendimmarrjes**

Pas daljes së vendimit, në programin e transparencës, në faqen zyrtare të internetit të APP, është publikuar për të gjithë të interesuarit, formati me të dhënat përkatëse të çdo vendimi. Formati ka pasqyruar informacionin përkatës, si: numrin dhe datën e vendimit, autoritetin kontraktor/shitës, subjekt verifikimi, numrin dhe llojin e procedurave të verifikuara, përmbledhje të gjetjeve kryesore dhe masat e dhëna nga APP, konform legjislacionit në fuqi.

# 9
# MONITORIMI I KONTRATAVE

## 9.1. Të dhëna mbi raportimin e planeve të zbatimit të kontratave nga Autoritetet Kontraktore.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, janë administruar në formë elektronike ose/dhe shkresore, **5258** plane të zbatimit të kontratave/minikontratave të nënshkruara, nga **463** autoritete kontraktore të ndryshme. Referuar të dhënave të paraqitura nga AK në formularët përkatës, rezulton se nga **5258** plane zbatimi të regjistruara gjatë kësaj periudhe:

- \- **2316** plane zbatimi janë për **kontrata,**
- **- 2508** janë plane zbatimi për **minikontrata** (kontrata bazuar në një marrëveshje kuadër),
- \- **434** plane zbatimi janë për **kontrata prokurimi me vlerë të vogël**.

Nisur nga numri total i kontratave dhe minikontratave të nënshkruara në përfundim të procedurave të prokurimit mbi kufirin e prokurimeve me vlerë të vogël, për periudhën Janar-Dhjetor 2023, (përfshirë edhe kontratat e lidhura në përfundim të procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës), konkretisht **6598** kontrata/minikontrata (sipas të dhënave në SPE), rezulton se nga APP janë administruar për këtë periudhë, **4824** plane zbatimi kontratash/minikontratash, që është në nivelin **73.1 %** të kontratave/minikontratave të lidhura. Për kontratat e lidhura gjatë periudhës së fund –vitit, kryesisht gjatë muajit Dhjetor, AK vijojnë të dërgojnë planet e zbatimit edhe gjatë muajit Janar 2024 e në vijim.

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhëna krahasimore në lidhje me **numrin total të planeve** të zbatimit të kontratës (përfshirë kontratat/minikontratat/blerjet e vogla) të dërguara nga AK për periudhën Janar-Dhjetor 2022 dhe Janar-Dhjetor 2023.




**Grafiku 57**

Rritja e konsiderueshme e numrit të planeve të zbatimit të kontratës të dërguara në APP gjatë vitit 2023, krahasuar me vitin 2022, është rezultat i punës ndërgjegjësuese që APP ka bërë, duke theksuar rëndësinë e një plani zbatimi për ndjekjen cilësore të performancës së kontratës.

Nga numri total prej **5258** planesh zbatimi, të dërguara nga autoritetet kontraktore, sipas të dhënave të paraqitura në formularët përkatës, rezulton se:

- **5036** janë plane të zbatimit, për kontrata të lidhura gjatë **vitit 2023,** nga të cilat **2225** janë për kontrata, **2395 janë** për minikontrata **dhe 416** janë për kontrata prokurimi me vlerë të vogël;
- **220** janë plane të zbatimit, për kontrata të lidhura **gjatë vitit 2022,** nga të cilat **90** janë për kontrata, **112** janë për minikontrata dhe **18** janë për kontrata prokurimi me vlerë të vogël;
- **2** janë plane zbatimi për kontrata të lidhura gjatë vitit **2021,** nga të cilat **1** është për minikontratë;

Nga analizimi i planeve të zbatimit të kontratës, i kemi pasqyruar ato të ndara sipas tipit të kontratës, institucioneve, periudhës kohore të dërgimit, si më poshtë:

- **Plane zbatimi të grupuara sipas tipit të kontratës**.

Numri i planeve të zbatimit të kontratës, të administruara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, i ndarë sipas tipit të kontratës (shërbim, mall, punë), rezulton si më poshtë:

- **3416** janë plane zbatimi për kontrata/marrëveshje kuadër të tipit *Mallra.*
- **1299** janë plane zbatimi për kontrata/ marrëveshje kuadër të tipit *Shërbime*.
- **543** janë plane zbatimi për kontrata/ marrëveshje kuadër të tipit *Punë publike*.

Të dhënat e mësipërme, në formë grafike paraqiten si më poshtë:

**Grafiku 58**




- Plane zbatimi të grupuara sipas llojit të AK

Ndërkohë, numri i planeve të zbatimit të kontratës, të ndara sipas tipologjisë së institucioneve që kanë dërguar këto plane zbatimi, rezulton si më poshtë:

- **3106** janë plane zbatimi për kontrata të lidhura nga institucione të nivelit **qendror**;
- **1177** janë plane zbatimi për kontrata të lidhura nga institucione të nivelit **vendor;**

- **494** janë plane zbatimi për kontrata të lidhura nga institucione **të pavarura;**
- **481** janë plane zbatimi për kontrata të lidhur nga **shoqëri anonime.**

Të dhënat e mësipërme, paraqiten sipas grafikut të mëposhtëm:




**Grafiku 59**

- Plane zbatimi të grupuara sipas muajit të dërgimit

Gjithashtu, numri i planeve të zbatimit të kontratës, të administruara për periudhën Janar-Gusht 2023, i ndarë sipas muajve, paraqitet si më poshtë:

- **381** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Janar**;
- **388** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Shkurt**;
- **468** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Mars**;
- **323** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Prill**;
- **518** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Maj**;
- **439** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Qershor**;
- **469** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Korrik**;
- **326** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Gusht**;
- **509** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Shtator;**
- **418** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Tetor;**
- **482** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Nëntor**;
- **537** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Dhjetor.**

Të dhënat e mësipërme, paraqiten sipas grafikut të mëposhtëm:




**Grafiku 60**

Nga shqyrtimi i këtij grafiku rezulton se në muajin **Dhjetor** rezulton numri më i lartë i planeve të zbatimit të kontratës, respektivisht **537 plane zbatimi**, ndërsa gjatë muajit Prill rezulton numri më i ulët, konkretisht **323 plane zbatimi**.

APP ka regjistruar të dhënat e 5258 planeve të zbatimit të kontratës, të dërguara pranë APP.

Hartimi i planit të zbatimit të kontratës ka një rol të rëndësishëm në procesin e ndjekjes së ecurisë së zbatimit të kontratës, për të siguruar mirëzbatimin e saj, sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, dhe për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. Plani i zbatimit të kontratës është dokumenti që ndihmon personat përgjegjës të ngarkuar për monitorimin e kontratës për të ndjekur në mënyrë sistematike përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

## 9.3. Të dhëna mbi korrektësinë e zbatimit të kontratave të raportuara nga AK-të nëpërmjet formularëve të raportimit, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023.

Autoritetet kontraktore dërgojnë në formë shkresore dhe/ose elektronike në adresën monitorimi.kontratat@app.gov.al, raportimet për ecurinë e zbatimit të kontratave të lidhura prej tyre, ku raportohet në formë të përmbledhur, sipas formularit standard të raportimit, sipas rasteve, nëse kontratat kanë përfunduar me sukses, apo nëse janë hasur problematika gjatë zbatimit të tyre, si edhe masat që janë marrë, për zgjidhjen e problematikave.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2023, janë administruar formularët e raportimit për zbatimin e **3280 kontratave**, të dërguara nga **280** autoritete kontraktore, prej të cilave:

- **2049** formularë raportimi janë për kontrata të lidhura **në vitin 2023;**
- **1155** formularë raportimi janë për kontrata të lidhura **në vitin 2022;**
- **67** formularë raportimi janë për kontrata të lidhura **në vitin 2021**;
- **2** formularë raportimi janë për kontrata të lidhura **në vitin 2020;**
- **4** formularë raportimi janë për kontrata të lidhura **në vitin 2019;**
- **1** formular raportimi janë për kontrata të lidhura **në vitin 2018;**
- **2** formularë raportimi janë për kontrata të lidhura **në vitin 2017.**
-

Për sa më sipër, vihet re që raportimi i autoriteteve kontraktore është bërë edhe për kontrata të lidhura gjatë viteve të mëparshme, që është një tregues i punës ndërgjegjësuese që ka bërë APP, për këtë proces.

Duke krahasuar të dhënat me vitin 2022, ku numri i raporteve të dërguara është 2622, rezulton se ka një rritje të numrit të formularëvë të raportimit për zbatimin e kontratës, të dërguara nga AK në periudhën Janar – Dhjetor 2023. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhëna krahasimore në lidhje me raportimin e AK për vitet  2022 dhe 2023.




**Grafiku 61**

Nga totali i **3280** kontratave/MK të raportuara në periudhën Janar – Dhjetor 2023, rezulton se:

- **2288** kontrata**,** ose afërsisht **69.75 %** e kontratave të raportuara**,** janë kontrata/MK të tipit ***Mall;***
- **711** kontrata, ose afërsisht **21.68%** e kontratave të raportuara**,** janë kontrata/MK të tipit ***Shërbim;***
- **- 281** kontrata, ose afërsisht **8.57 %** e kontratave të raportuara**,** janë kontrata/MK të tipit ***Punë.***

Në Tabelën dhe Grafikun e mëposhtëm, paraqiten të dhënat në lidhje me numrin e kontratave/MK të raportuara për periudhën Janar- Dhjetor 2023, të ndara sipas tipit të kontratës (*shërbim/mall/punë*).

**Tabela 78**

| KONTRATAT/MK TË RAPORTUARA NGA AUTORITETET KONTRAKTORE SIPAS TIPIT TË KONTRATAVE/MK, PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023 | | |
|---|---|---|
| **TIPI I KONTRATËS/MK** | **NUMRI I KONTRATAVE/MK TË RAPORTUARA** | **NUMRI NË (%) I KONTRATAVE/MK TË RAPORTUARA** |
| **MALLRA** | **2288** | **69.75 %** |
| **SHËRBIME** | **711** | **21.68%** |
| **PUNË PUBLIKE** | **281** | **8.57 %** |
| **TOTALI** | **3280** | **100%** |




**Grafiku 62**

Nga totali i **3280** kontratave të raportuara, rezulton se:

- **1754** prej tyre janë raporte për minikontrata (kontrata bazuar në një marrëveshje kuadër).
- **1526** prej tyre janë për kontrata, nga të cilat 263 janë për kontrata me blerje të vogël, ose nën 100 mijë lekë.

Të dhënat e raportuara në **3280** formularët e raportimit për zbatimin e kontratës të dërguara pranë APP, janë regjistruar nga APP, duke pasqyruar problematikat e raportuara, si dhe çdo informacion të nevojshëm për përpunimin e këtyre të dhënave.

Gjithashtu, APP ka komunikuar në vazhdimësi me autoritetet kontraktore për mangësitë e konstatuara në raportet e zbatimit të kontratave, me rreth **1467 komunikime me email dhe 61 me shkresa zyrtare,** ku është kërkuar informacion shtesë mbi ecurinë e zbatimit të kontratave, plotësimin e mangësive respektive të formularëve, ridërgimin e tyre pas likujdimit të plotë të detyrimit financiar, si dhe duke sjellë në vëmendje të autoriteteteve kontraktore respektimin e detyrimeve ligjore në lidhje me zbatimin e kontratave, sipas kushteve me të cilat janë prokuruar.

Njëkohësisht, lidhur me mangësitë dhe problematikat kryesore të evidentuara gjatë shqyrtimit të formularëve të raportimit për zbatimin e kontratave, APP hartoi një rekomandim drejtuar autoriteteve kontraktore, duke synuar shmangien e tyre në të ardhmen dhe mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik që lidhet me zbatimin e kontratave.

## 9.4. Problematika të evidentuara nga AK gjatë zbatimit të kontratave nga analizimi i formularëve standardë të raportimit të ecurisë së zbatimit të kontratave.

Nga analizimi i të dhënave të formularëve standardë të raportimit të zbatimit të kontratave, të administruar në APP, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, rezulton se janë raportuar problematika **për 98 kontrata**, gjatë zbatimit të tyre. Nisur nga numri total prej **3280** raportimeve për zbatimin e kontratës, të dërguara pranë APP, rezulton se rreth **2.99 %** e kontratave të raportuara kanë patur problematika gjatë zbatimit të kontratës.

Konkretisht:

- Për **39 kontrata**, AK kanë aplikuar penalitete ndaj kontraktorëve përkatës, nga të cilat:
- - në **35** raste, penalitetet janë aplikuar për shkak të mosrespektimit të afatit të zbatimit të kontratës,
- - në **4** raste, penalitetet janë aplikuar për shkak të vonesave të shkaktuara, për arsye të ndreqjes së mospërmbushjeve të konstatuara nga AK.
- Për **1 kontratë**, raportohen vonesa në dorëzimin e mallit, por që në vijim malli është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar nga AK, në përmbushje të detyrimeve. Në këtë rast, APP ka sjellë në vëmendje të AK aplikimin e penaliteteve për vonesat përtej afatit të kontratës, sipas parashikimeve të saj.
- Për **5 kontrata**, raportohen vonesa për marrjen në dorëzim të mallit, pasi komisioni i marrjes në dorëzim nuk është paraqitur. AK raporton njëkohësisht zgjatje të afatit të kontratës për këto kontrata. Gjithashtu, **për 1 kontratë** raportohet se është vonuar marrja në dorëzim e mallit, për shkak të vonesave në përgjigjen e analizave të mallrave.
- Për **15 kontrata**, raportohen vonesa në fillimin e zbatimit të kontratës, apo në zbatimin e saj, si dhe pezullim punimesh, nga të cilat:
- - në **3** raste këto vonesa janë shkaktuar nga vetë AK (lirimi i ambjenteve, dorëzimi i materialeve të nevojshme për zbatimin e kontratës)
- - në **12** raste për shkak rishikimi apo saktësimi të projektit, problematika që lidhen me lirimin e sheshit të ndërtimit, apo marrjen e lejeve të nevojshme për ecurinë e punimeve objekt kontrate, apo problematikave që ndikonin në realizimin e kontratës.
- Për **11 kontrata**, raportohet mospërmbushje e detyrimeve kontraktuale dhe zgjidhje e kontratës.
- Për **6 kontrata**, AK raportojnë mospërmbushje dhe kanë njoftuar operatorin ekonomik, duke kërkuar zbatimin e kontratës.
- Për **4 kontrata**, raportohet ndërprerja e kontratës, ku në 3 raste ndëprerja ka ardhur për shkak të situatës së konfliktit të interesit të kontraktorit, i cili është zgjedhur deputet, dhe në një rast, për shkak se kontraktori është dënuar me vendim nga Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- Për **1 kontratë,** raportohet ndërprerje e kontratës, për shkak të problematikës në likujdimin e faturës tatimore.
- Për **1 kontratë** raportohet ndërprerje e kontratës, për paaftësi paguese të AK.
- Për **13 kontrata**, është raportuar ndërprerje e kontratës, apo përfundimi i kontratës përpara afatit të parashikuar dhe jo në vlerën e parashikuar, për arsye të përfundimit të procedurës konkurruese që zhvillohej nga organi qendror blerës / për shkak të rritjes së çmimit të karburantit, ku sasitë e parashikuara janë ezauruar përpara afatit të kontratës / ndryshimit të nevojave të AK / për shkak të reduktimit të shpenzimeve.
- Për **1 kontratë** raportohet se kontraktori ka kërkuar ndryshimin e projektit me pretendimin se është i pazbatueshëm, por kjo kërkesë nuk është miratuar nga AK, i cili raporton se do ndjekë hapat sipas legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i të dhënave të raportuara gjatë zbatimit të kontratës nga AK, mbi datën e shlyerjes së plotë të detyrimit financiar dhe parashikimin në kontratë për afatin e shlyerjes (për rastet kur këto të dhëna janë plotësuar nga AK), rezulton se në rreth **7.4 %** të kontratave të raportuara ka patur vonesa në shlyerjen e detyrimeve financiare nga AK.

Problematika e shlyerjes me vonesë vijon të mbetet, edhe pse APP ka rekomanduar AK që të respektojnë parashikimet e kontratës dhe legjislacionin në fuqi në lidhje me kryerjen e pagesave (në Rekomandimin Nr.6818 Prot., datë 06.10.2022, *"Mbi mënyrën e hartimit të raportimit të zbatimit të kontratave"* dhe në Rekomandimin Nr.8638/2 Prot., date 13.11.2023 "*Për zbatimin e kontratave*, drejtuar autoriteteve/enteve kontraktore).

## 9.5. Modifikimet e Kontratave

Nga shqyrtimi i 3280 formularëve të raportimit për zbatimin e kontratave, të dërguara për periudhën Janar – Dhjetor 2023, rezulton se 88 AK raportojnë se:

- Për **143 kontrata**, ose përafërsisht 4.4 % e kontratave të raportuara**,** AK kanë bërë modifikim të afatit të zbatimit të kontratës, prej të cilave në 16 raste raportohet njëkohësisht edhe rishikim/përmirësim projekti, pa ndryshim të vlerës së kontratës.

  Autoritetet kontraktore kanë raportuar se shtyrja e afatit të zbatimit të kontratës, kryesisht ka ardhur për shkak të kushteve të këqija atmosferike, vonesave në transportin ndërkombëtar dhe si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022, rishikimit të projektit, moslirimit të sheshit të ndërtimit apo kushteve të tjera të paparashikuara që kanë penguar realizimin në kohë të kontratës, si dhe ezaurimi jo i plotë i vlerës së kontratës brenda afatit fillestar të saj. Në 18 raste, AK nuk kanë dhënë arsyet e shtyrjes së afatit. Në këto raste, është dërguar email për plotësimin e formularëve të raportimit në lidhje me arsyet e shtyrjes së afatit të kontratave.
- Për **22 kontrata**, AK kanë raportuar se kanë bërë modifikim të vlerës së kontratës, ku në 7 raste është bërë njëkohësisht edhe shtyrja e afatit të kontratës. Në 2 raste, modifikimi i vlerës ka ardhur si pasojë e indeksimit të çmimit, në 11 raste modifikimet kanë ardhur si pasojë e hyrjes në fuqi të një akti nënligjor që ndikonte kushtet e kontratës (ndryshimi i pagës minimale, si dhe çmimit të karburantit), në 9 raste modifikimi i vlerës është kryer për shkak të punimeve/shërbimeve/mallrave shtesë që kanë ardhur si pasojë e rishikimit të projektit, modifikimit të sasive të zërave të artikujve objekt kontrate, pas verifikimeve në terren, apo domosdoshmërisë së ofrimit të furnizimeve/shërbimeve, që kanë ardhur për shkak të rrethanave të paparashikueshme.
- Për **7 kontrata**, AK kanë raportuar modifikim të kontratës përsa i përket ndryshimit të zërave apo volumeve të punimeve, apo rishikime/përmirësime në projekt, por që nuk kanë sjellë ndryshim të vlerës së kontratës, si dhe për **4 kontrata**, raportohet modifikim i sasive/zërave të artikujve/shërbimeve, pa ndryshim të vlerës së përgjithshme të kontratës.
- Për **4 kontrata**, AK kanë raportuar saktësim të termave të kontratës (saktësim i afatit/vlerës).
- Për **3 kontrata**, AK kanë raportuar ndryshim të kontraktorit (për shkak të ristrukturimit, apo ndryshimit të emrit të shoqërisë).
- Për **8 kontrata,** AK kanë raportuar modifikime të tjera, që lidhen me ndryshimin e drejtuesit teknik të projektit, administratorit të shoqërisë, ose ndryshim të komisionit për ndjekjen e kontratës.
- Për **1 kontratë**, AK ka raportuar që likujdimi i vlerës së plotë të kontratës nga vitit 2023 që ishte parashikuar, do të bëhet në vitin 2024.

Sipas tipit të kontratës së modifikuar, rezulton se:
- 57 modifikime janë për kontrata të tipit “Mall”;
- 48 modifikime janë për kontrata të tipit “Shërbim”;
- 87 modifikime janë për kontrata të tipit “Punë”.

Në total, referuar raportimeve të dërguara nga AK, rezulton që numri i kontratave të modifikuara është 192, që përbëjnë rreth 5.85 % të kontratave të raportuara për vitin 2023.

Numri i kontratave të modifikuara, sipas të dhënave të formularëve të raportimit, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Ndërkohë, referuar të dhënave në SPE, rezulton se gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, janë publikuar si **zë regjistri** në SPE **59 modifikime** kontratash për 26 AK. Prej këtyre:
- në 31 raste është modifikuar afati i kontratës,
- në 27 raste është modifikuar vlera e kontratave, ku **në 12 raste njëkohësisht edhe afati i tyre**,
- në 1 rast është modifikuar kontraktori fillestar, si rrjedhojë e ristrukturimit të kompanisë.

Ripas tipit të kontratës së modifikuar, rezulton se:
- 14 modifikime janë për kontrata të tipit “Mall”;
- 17 modifikime janë për kontrata të tipit “Shërbim”;
- 28 modifikime janë për kontrata të tipit “Punë”.

Gjithashtu, APP është njoftuar nëpërmjet Formularit të Njoftimit të Modifikimit të Kontratës/Marrëveshjes Kuadër gjatë Zbatimit**,** për **71 modifikime** kontratash, **nga 30 AK,** nga të cilat:
- për 36 kontrata njoftohet modifikimi i afatit,
- për 32 kontrata njoftohet modifikimi i vlerës, ku në 13 raste njëkoëhsisht edhe i afatit të kontratës,
- për 3 kontrata njoftohen modifikime që lidhen me ndryshimin e kontraktorit.

Nga 71 njoftime modifikim kontratash, 30 modifikime nuk rezultojnë të pasqyruara si zë regjistri në SPE. Në lidhje me këto njoftime, APP ka sjellë në vëmendje të AK parashikimet ligjore në rastin e modifikimit të kontratës.

Në total, referuar raportimeve dhe njoftimeve të dërguara nga AK, si dhe të dhënave në SPE, rezulton që numri i kontratave të modifikuara është 248.

Raportimi i ecurisë së zbatimit të kontratave nga ana e autoriteteve kontraktore është një proces i rëndësishëm dhe luan rol në ndërgjegjësimin e autoriteteve kontraktore për ndjekjen me rigorozitet të zbatimit të kontratave të lidhura prej tyre, sipas kushteve të prokuruara dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## 9.6. Hartimi i Planit të Monitorimit të Kontratave

Në vijim të detyrave funksionale, APP harton planet e monitorimit të kontratave. Këto plane synojnë ndërgjegjësimin e autoriteteve kontraktore për zbatimin me rigorozitet të legjislacionit të prokurimit publik, në procesin e ndjekjes së zbatimit të kontratave të lidhura prej tyre, përmirësimin e punës së autoriteteve kontraktore, por edhe marrjen e masave për personat, të cilët nuk kanë kryer detyrat e ngarkuara me ligj për ndjekjen e zbatimit të kontratës.

Gjatë vitit 2023, në ushtrim të funksioneve të saj, APP ka zhvilluar hetime administrative për monitorimin e zbatimit të kontratave bazuar në 3 plane monitorimi, të hartuara respektivisht për çdo 6 mujor, ku i fundit është ende në proces. Konkretisht:

1. Bazuar në **Planin e Monitorimit Nr. 7628 Prot., datë 09.12.2022**, me objekt "*Monitorimi i zbatimit të kontratave të lidhura nga autoritete të ndryshme kontraktore (bazuar në marrëveshjet kuadër që janë nënshkruar gjatë periudhës 2020-2021 nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ish Agjencia e Blerjeve të Përqendruara*", APP ka kryer hetim administrativ në 6 autoritete kontraktore, në lidhje me zbatimin e **8 kontratave të lidhura**.

Në përfundim të hetimit administrativ, APP ka vendosur:

- të dënojë me **gjobë 17 personat** përgjegjës për shkeljet e konstatuara,
- të propozojë marrjen e **masës disiplinore ndaj 12 punonjësve**, si dhe për 1 AK masa është propozuar ndaj **punonjësve të Sektorit të Shërbimeve dhe Projekteve** , emrat e të cilëve nuk cilësoheshin në kundërshtimet e AK.

Vendimet e mësipërme janë publikuar në faqen zyrtare të APP-së.

Në përfundim të planit të monitorimit, APP hartoi një rekomandim në lidhje me mangësitë dhe problematikat e evidentuara për këto AK, në ndjekjen e zbatimit të kontratës, i cili është publikuar në faqen zyrtare të APP. Kjo synon të informojë autoritetet/entet kontraktore, me qëllim shmangien e rasteve të ngjashme në proceset e ndjekjes së zbatimit të kontratave që janë lidhur prej tyre.

2. Bazuar në **Planin e Monitorimit Nr. 4852 prot., datë 21.06.2023 (Faza I),** me objekt "*Monitorimi i zbatimit të kontratave me objekt "Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash", të lidhura nga autoritete të ndryshme kontraktore, bazuar në marrëveshjet kuadër sipas procedurave të realizuara gjatë vitit 2022 nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara*", APP ka kryer hetim administrative në 8 autoritete kontraktore, lidhur me zbatimin e **12 kontratave**.

Në përfundim të hetimit administrativ, APP ka vendosur:

- të dënojë me **gjobë 15 personat** përgjegjës për shkeljet e konstatuara,
- të propozojë marrjen e **masës disiplinore ndaj 56 punonjësve**, si dhe për 1 AK ndaj **punonjësve të Sektorit të Logjistikës**, emrat e të cilëve nuk cilësoheshin në kundërshtimet e AK, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës objekt hetimi.

Vendimet e mësipërme janë publikuar në faqen zyrtare të APP-së.

3. Bazuar në **Planin e Monitorimit Nr. 8302/1 Prot., datë 02.11.2023 (Faza II),** me objekt "*Monitorimi i zbatimit të kontratave me objekt "Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash", të lidhura nga autoritete të ndryshme kontraktore, bazuar në marrëveshjet kuadër sipas procedurave të realizuara gjatë vitit 2022 nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara*", APP ka filluar hetimin administrativ në 8 AK, lidhur me zbatimin e **12 kontratave.**

Hetimi administrativ sipas këtij plani monitorimi është ende në proces. Konkretisht, janë dërguar kërkesat për kundërshtime për 4 AK, ndërkohë për 4 AK e tjera hetimi është në fazën e shqyrtimit të dokumentacionit shtesë të paraqitur nga autoritetet kontraktore.

## 9.7. Hartimi i akteve të nevojshme për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë procesit të monitorimit të kontratave.

APP, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik, që lidhet me modifikimin e kontratave gjatë kohëzgjatjes së tyre, ka hartuar rekomandimet si më poshtë:

1. **Rekomandimin Nr. 3166 Prot., datë 14.04.2023** "*Mbi njoftimin për modifikimin e kontratave / marrëveshjeve kuadër gjatë kohëzgjatjes së tyre*".

Hartimi i këtij rekomandimi ka si qëllim t'ju vijë në ndihmë autoriteteve kontraktore për të zbatuar me rigorozitet detyrimet ligjore që lidhen me dërgimin pranë APP të formularëve të njoftimit të modifikimeve të kryera në kontratat e lidhura prej tyre, për publikimin e tyre në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe për pasqyrimin e këtyre modifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2. **Rekomandimin Nr. 5529/1 Prot., datë 18.07.2023** "*Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, të nënshkruara në bazë të marrëveshjeve kuadër*".

Në përfundim të hetimit administrativ, sipas Planit të Monitorimit Nr. 7628 Prot., datë 09.12.2022, me objekt "*Monitorimi i zbatimit të kontratave të lidhura nga autoritete të ndryshme kontraktore (bazuar në marrëveshjet kuadër që janë nënshkruar gjatë periudhës 2020-2021 nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ish Agjencia e Blerjeve të Përqendruara*", nisur nga problematikat dhe mangësitë e evidentuara gjatë këtij hetimi, që lidhen me ndjekjen e zbatimit të kontratës, hartimi i këtij rekomandimi synon t'ju vijë në ndihmë autoriteteve kontraktore në raste të ngjashme.

3. **Rekomandimin Nr. 8638/2 Prot., datë 13.11.2023** "*Mbi zbatimin e kontratave*".

Rekomandimi i mësipërm adreson mangësitë dhe problematikat kryesore që janë evidentuar gjatë shqyrtimit të formularëve të raportimit për zbatimin e kontratave të dërguara nga autoritetet kontraktore pranë APP në formë shkresore apo elektronike, duke synuar shmangien e tyre në të ardhmen dhe mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik që lidhet me zbatimin e kontratave.

4. Gjithashtu, në vijim të punës për ndryshimin e ligjit të prokurimit publik, përsa i përket zbatimit të kontratave, APP ka bërë **propozimet përkatëse për ndryshimet ligjore**, me argumentimin përkatës për nevojën e këtyre ndryshimeve, bazuar në praktikën e deritanishme mbi problematikat e hasura gjatë raportimit të autoriteteve kontraktore, si dhe në propozimet e bëra nga autoritete të ndryshme kontraktore, gjatë takimeve informuese të zhvilluara me to gjatë vitit 2022.

# 10

# PËRJASHTIMI I OPERATORËVE EKONOMIKË

## 10.1. Shqyrtimi i kërkesave për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta per fituar kontrata publike

Gjatë vitit 2023, në ushtrim të funksioneve të saj, APP ka marrë në marrë në shqyrtim **60 kërkesa/ informacione** për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike.

Ndërkohë, nuk ka patur kërkesa/informacion për përjashtim të operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në koncensione/partneritet publik privat apo nga ankandet publike.

Në formë tabelore, po i paraqesim si më poshtë:

**Tabela 79**

| Rastet/Informacionet e shqyrtuara për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, sipas propozuesit | |
|---|---|
| Propozime të iniciuara nga Operatorët Ekonomikë | 12 |
| Propozime të iniciuara nga Autoritetet Kontraktore | 34 |
| Propozime të iniciuara nga Komisioni i Prokurimit Publik | 4 |
| Propozime të iniciuara nga KLSH/Inspektimi Financiar | 6 |
| Ekzekutim i Urdhërit të Prokurorit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar "Për ekzekutimin e vendimit penal Nr. 34, datë 26.05.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë | 1 |
| Nga raportimet e ardhura në APP, për zbatimin e kontratave | 3 |
| TOTALI | 60 |

**Nga kërkesat/informacionet e administruara, rezulton se**:
- **26** prej tyre_referohen për keqinformim dhe paraqitje të dokumentave me të dhëna të rreme sipas parashikimeve të nenit të **78/1/a të LPP;**
- **1 rast** i referohet parashikimeve të nenit **78/1/c të LPP;**
- **33 raste** referohen për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale, sipas parashikimeve të nenit **nenit 78/1/b të LPP**.
-

Në formë tabelore, po i paraqesim si më poshtë:

**Tabela 80**

| Rastet e shqyrtuara për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, me bazë ligjore neni 78 LPP | |
|---|---|
| Propozime për keqinformim dhe paraqitje të dokumentave me të dhëna të rreme | 26 |
| Propozime për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale | 33 |
| Propozim për tërheqje mbi 5 herë të operatorit ekonomik nga nënshkrimi i kontratës | 1 |
| TOTALI | 60 |

Nga **60** kërkesat/informacionet e administruara, rezulton se:

- ka nisur procedimi administrativ për **30** operatorë ekonomikë.
- **29 kërkesa,** kanë qenë të paplota në argumenta ligjorë dhe prova dokumentare, ose pas verifikimeve të kryera ka rezultuar se nuk kanë qenë kushtet e parashikuara nga dispozitat ligjore për nisjen e procedimit administrativ nga APP.
- **1 kërkesë** është në proces shqyrtimi.

**Tabela 81**

| Vlerësimi i kërkesave për përjashtim | |
|---|---|
| **Fillim procedimi administrativ** | **30 kërkesa** |
| **Kërkesa të paplota/në proces shqyrtimi** | **30 kërkesa** |

**Vendimmarrja E Procedimeve Administrative**

Në përfundim të procedimit administrativ rezulton se:

- është **marrë vendimi për përjashtimin** nga e drejta për të fituar kontrata publike, për **19 (nëntëmbëdhjetë)** operatorë ekonomikë .
- është marrë vendimi për mospërjashtimin nga e drejta për të fituar kontrata publike për **3 (tre)** operatorë ekonomikë;
- është marrë vendimi për pezullim të procesit të nisur për përjashtim nga e drejta për të fituar kontrata publike për **4 (katër)** operatorë ekonomikë, për shkak të procesit gjyqësor;
- vijon procesi i procedimit administrativ **për 4 (katër)** operatorë ekonomikë.

**Vendime për përjashtimin e operatorëve ekonomikë**

Lidhur me vendimet e përjashtimit (19 të tilla), rezulton se nga këta:

- **7 operatorë ekonomikë**, janë përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike për shkak të keqinformimit dhe paraqitjes në tender të dokumentave, që përmbajnë të dhëna të rreme;
- **1 operator ekonomik** në zbatim të vendimit të dhënë nga gjykata;
- **12 operatorë ekonomikë** janë përjashtuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale.

Në formë tabelore po i paraqesim si më poshtë vijon**:**

**Tabela 82**

| Përjashtime me bazë ligjore | |
|---|---|
| **Përjashtuar në zbatim të vendimit të dhënë nga Gjykata.** | **1 operator ekonomik** |
| **Përjashtuar për keqinformim dhe paraqitje të dokumentave me të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi (neni 78 i LPP)** | **6 operatorë ekonomikë** |
| **Përjashtuar për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale (neni 78/1/b i LPP)** | **12 operatorë ekonomikë** |

Vlen të theksohet se, nga bashkëpunimi institucional dhe raportimi i ndërsjelltë me AKU dhe ISHP-SHSH, gjatë këtij viti, është konkluduar me 2 (dy) vendime përjashtimi të operatorëve ekonomikë. Krahasuar me vitin 2022, kur ka pasur 7 vendime të tilla përjashtimi, vërehet rënie e konsiderueshme e rasteve të keqinformimit kur janë të penalizuar nga këto institucione, çka është tregues pozitiv se mekanizmi i kontrollit nëpërmjet vetëdeklarimit dhe bashkëpunimi institucional kanë dhënë rezultatet e pritshme.

**Vendime për mospërjashtimin e operatorëve ekonomikë**

Për **3 (tre) operator ekonomikë** është vendosur mospërjashtimi për shkak se, nuk plotësoheshin kushtet e parashikuara në nenin 78 të LPP për përjashtimin e tyre.

Në formë tabelore, të dhënat për vendimet e mospërjashtimit:

**Tabela 83**

| Vendime mospërjashtimi nga pjesëmarrja në prokurimet publike | |
|---|---|
| **Vendim për mospërjashtim, të mbështetur në parashikimet e nenit 78 të Ligjit 162/2020** | **3** |

**Kërkesa të paplota**

Për **30 (tridhjetë) operatorë ekonomikë**, APP nuk ka nisur procedimin administrativ, pasi kërkesa e paraqitur nga propozuesit (operatorë ekonomikë/autoritet kontraktor) është konsideruar me dokumentacion të pamjaftueshëm dhe e paargumentuar për të filluar procedimin administrativ, apo pas verifikimeve të kryera ka rezultuar se, nuk janë plotësuar kushtet për nisjen e procedimit administrativ, sipas parashikimeve të nenit 78 të LPP.

- Në mënyrë të përmbledhur, më poshtë paraqesim në formë tabelore, trajtimin e të gjitha kërkesave për përjashtim të operatorëve ekonomikë, nga e drejta për të fituar kontrata publike, gjatë vitit 2023:

**Tabela 84**

| Trajtimi i kërkesave për përjashtim | |
|---|---|
| **Vendimi** | **Numri** |
| **Vendime përjashtimi** | **19** |
| **Vendime mos përjashtimi** | **3** |
| **Vendime pezullimi** | **4** |
| **Procedime administrative në proces, për marrje vendimi** | **4** |
| **Kërkesa të paplota/në proces shqyrtimi kërkese** | **30** |
| **TOTALI** | **60** |

# 11

# PËRFAQËSIMI I APP NË PROCESET GJYQËSORE

Gjatë vitit 2023, APP është përfaqësuar në proceset gjyqësore si palë e paditur, nga zyrtarët e autoriteteve kontraktore të penalizuar në përfundim të procesit të verifikimit të ushtruar nga APP apo nga shqyrtimi i raporteve audituese, si edhe nga operatorët ekonomikë, ndaj të cilëve është dhënë vendimi i përjashtimit nga e drejta për të fituar fonde publike.

**Tabela 85**

| **Çështjet Gjyqësore Administrative të ndjekura nga APP, sipas shkallës së gjykimit** | |
|---|---|
| **Shkalla e gjykimit** | **Numri** |
| **Gjykata Administrative në Shkallën e Parë të Gjykimit** | **41** |
| **Çështje Administrative/Civile në Shkallën e dytë të Gjykimit** | **96** |
| **Çështje Administrative në Shkallën e tretë të Gjykimit** | **15** |
| **TOTALI** | **152** |

**Tabela 86**

| ***Çështjet Gjyqësore të ndjekura nga APP në shkallë të parë, Tiranë, sipas llojit të kërkesë padisë*** | |
|---|---|
| ***Lloji i padisë*** | ***Numri*** |
| ***Kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë*** | ***11*** |
| ***Kundër fillimit të hetimit administrativ të nisur nga APP për përjashtim të subjektit*** | ***1*** |
| ***Kundër vendimeve të APP për penalizim të zyrtarëve gjatë procedurave të prokurimit publik*** | ***19*** |
| ***Kundër vendimeve të APP për penalizim të zyrtarëve gjatë procedurave të ankandit publik*** | ***2*** |
| ***Kundër vendimeve të APP per penalizimin e zyrtarëve për monitorimin e zbatimit të kontratës*** | ***4*** |
| ***Dëmshpërblim dëmi nga efektet e dhena nga vendimi i APP*** | ***1*** |
| ***Saktësim i vendimit të Gjykatës Administrative të shkallës së parë*** | ***2*** |
| ***Kundërshtim i veprimeve përmbarimore*** | ***1*** |
| ***TOTALI*** | ***41*** |

- Çështjet Gjyqësore kundër **vendimeve të dhëna nga APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë**

Po të marrim në analizë vendimet e dhëna nga APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë gjatë vitit 2023 janë dhënë gjithsej **19** vendime, rezulton se, **vetëm 5 vendime** te dhënë gjatë vitit 2023 janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, pasi 6 cështje janë të mbartuara dhe i referohen vendimeve të përjashtimit të dhëna gjatë vitit 2022.

**Tabela 87**

| Vendime përjashtimi gjate vitit 2023 | Kërkesë padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë | Kërkesë Padi të mbartuara gjatë 2022 |
|---|---|---|
| 19 | 5 | 6 |

Pra, gjithsej kemi **11** ankimime, për të cilat, Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur:

- **3 (tre)** çështje, rrëzim i kërkesë padisë;
- **1(një)** cështje, pranim kërkesë padie.
- **1 (një)** cështje, pranim pjesërisht kërkesë padie
- **1 (një)** cështje, kthim padie
- **1 (një)** cështje, pushim gjykim
- **4 (katër) çështje janë ende në proces.**

**Tabela 88**

| Vendimmarrja e Gjykatës për cështjet gjyqësore me objekt kundershtimin e vendimeve për përjashtimin e operatorëve ekonomikë | |
|---|---|
| **Vendimi i gjykatës** | **Numri** |
| Rrëzuar kërkesë padia | 3 |
| Pranim kërkesë padie | 1 |
| Pranim pjeserisht | 1 |
| Kthim padie | 1 |
| Pushim gjykimi | 1 |
| Në proces | 4 |

- Nga **11 ankimime në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë, në 7 raste** është kërkuar sigurim padie apo dhënie vendimi me ekzekutim të përkohshëm.

Pra, **nga 11 ankimime** në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, këto të fundit nuk kanë marrë në konsideratë kërkesë paditë për dhënien e masës së sigurimit të padisë ose dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm në **6 rastet e kërkuara**, duke sjellë që vendimi i dhënë nga APP në këto raste, për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, të vijojë të zbatohet deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Ndërsa, në **1 rast,** gjykata ka vendosur të marrë në konsideratë kërkesën paraqitur për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm duke sjellë që APP të marrë vendim për pezullimin e vendimit të dhënë dëri sa të shprehet me vendim Gjykata Administrative e Apelit.

**Tabela 89**

| Pranim Kërkesë Padie për dhënie të masës së sigurimit të padisë/vendim me ekzekutim të përkohshëm | Rrëzim Kërkesë Padie për dhënie të masës së sigurimit të padisë/vendim me ekzekutim të përkohshëm |
|---|---|
| 1 | 6 |

- Çështjet gjyqësore kundër vendimeve të dhëna nga APP, **për penalizim të zyrtarëve në Autoritete Kontraktore.**

Gjatë këtij viti janë **ndjekur 25 çështje gjyqësore** të cilat kërkesë padi të reja apo edhe të mbartura në Gjykatën Administrative të shkallës së parë kundër vendimeve të APP, për penalizimin e zyrtarëve me gjobë.

Vlen të theksojmë se, nga këto kërkesë padi të paraqitura gjatë kësaj periudhe raportimi, 2 (dy) prej tyre janë ngritur për penalizim të zyrtarëve në procedurat e ankandit publik dhe 3 (tre) kërkesë padi për penalizimin e zyrtarëve për zbatim kontrate.

Nga çështjet gjyqësore kundër vendimeve të APP për penalizim të zyrtarëve, në përfundim të procesit të monitorimit apo të shqyrtimit të raporteve të auditimit, gjatë vitit të 2023, Gjykata ka dalë me vendim për 15 (pesëmbëdhjetë) çështje gjyqësore.

Paraqitja në tabelë e këtyre çështjeve për këtë periudhë raportimi, si më poshtë vijon:

**Tabela 90**

| Çështjet Gjyqësore kundër vendimit të dënimit me gjobë, sipas vendimit të gjykatës | |
|---|---|
| **Vendimi i gjykatës** | **Numri** |
| **Rrëzuar kërkesë padia** | **9** |
| **Pranim kërkesë padie** | **3** |
| **Pushim gjykimi** | **1** |
| **Pranim pjesërisht kërkesë padie** | **2** |
| **Në proces** | **10** |
| **TOTAL** | **25** |

- Gjatë këtij viti kemi patur edhe një kërkesë padi, e cila ka si objekt dëmshpërblimin që kërkon operatori ekonomik, si rezultat i dëmit që presupozon që i ka ardhur nga vendimi i dhënë nga APP për përjashtimin e tij, vendim i cili theksojmë se, është marrë nga APP gjatë vitit 2018. Cështja po gjykohet dhe është ende në proces.
- Gjithashtu, gjatë viti, APP në cilësinë e palës së paditur ka kërkuar nga Gjykata dhe saktësim në një vendim të dhënë nga ana e saj, kërkesë për të cilën Gjykata e ka marrë në konsideratë, duke dalë me vendim për interpretimin e dispozitivit të vendimit të dhënë.
- Po kështu, kemi patur edhe **1 çështje gjyqësore**, ku pala paditëse ka kërkuar saktësim të dispozitivit të vendimit të dhënë nga Gjykata. Gjykata ka dhënë vendim për interpretimin e dispozitivit të vendimit të saj.
- **APP ka ngritur edhe një kërkesë padi me objekt: "Pezullimin e veprimeve përmbarimore të zyrës përmbarimore private "Suela Ndreca" për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, Vendimit Nr. 462 (80-2023-474) datë 02.03.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë si dhe Kundërshtimin e veprimeve përmbarimore të zyrës përmbarimore "Suela**

**Ndreca" Shpk sipas shkresës Nr. 388/10 Prot., datë 13.06.2023, Vendim me objekt: "Për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm" të Vendimit 462 (80-2023-474) datë 02.03.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë". Në përfundim të gjykimit, Gjykata ka vendosur vendosur rrëzimin e saj.**

**Tabela 91**

| Çështjet Gjyqësore të ndjekura pranë Gjykatës Administrative Tiranë sipas llojit të kërkesë padisë | |
|---|---|
| **Lloji i padisë** | **Numri** |
| **Dëmshpërblim dëmi nga efektet e dhëna nga vendimi i APP** | **1** |
| **Saktësim i vendimit të Gjykatës Administrative të shkallës së parë** | **2** |
| **Kundërshtim veprimesh përmbarimore** | **1** |

- Çështje Gjyqësore të mbyllura me vendim në shkallë të parë

Gjatë këtij viti, **nga 41 çështje gjyqësore** të ndjekura në shkallë të parë pranë Gjykatës Administrative Tiranë, **kanë përfunduar** me dhënien e vendimit nga Gjykata vetëm **25 çështje gjyqësore**, **pasi 16 çështje janë ende në proces.**

**Tabela 92**

| Çështjet Gjyqësore të ndjekura pranë Gjykatës Administrative Tiranë | |
|---|---|
| **Çështje gjyqësore** | **Numri** |
| **Të përfunduara me dhënie vendimi** | **25** |
| **Ne proces** | **16** |

Nga 25 procese gjyqësore të përfunduara me vendim nga Gjykata, vetëm 10 (dhjetë) prej tyre **janë të ankimueshme,** dhe 15 (pesëmbëdhjetë) **janë të formës së prerë** për shkak se masa e gjobës së dhënë ndaj paditësve ka qenë nën 20-fishin e pagës minimale, duke e bërë vendimin kështu të pankimueshëm.

Në formë tabelore janë si më poshtë:

**Tabela 93**

| Vendime të formës së prerë | Vendime të ankimueshme |
|---|---|
| **15** | **10** |

Nga këto 10 çështje, për të cilat vendimi ka qenë i ankimueshëm, nga vetë APP është ushtruar e drejta e ankimit për **6 (gjashtë)** vendimet e dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë.

- Në Gjykatën **Administrative e Apelit Tiranë**, vazhdojnë të jenë të regjistruara dhe pritet gjykimi për rreth **95 çështje**[11]**,** ku APP është cilësinë e palës së paditur /palës së tretë.

**11 Në këto cështje përfshihen 84 prej tyre të mbartura nga vitet e mëparshme, si dhe 11 (njëmbëdhjetë) cështje të reja të shtuara gjatë të vitit 2023, të cilat vijnë si rezultat i ushtrimit të së drejtës së ankimit si nga APP, ashtu edhe nga vetë operatorët ekonomikë.**

Theksojmë se, gjatë këtij viti janë shtuar 11 (njëmbëdhjetë) çështje të reja në Gjykatën Administrative të Apelit, ku APP është në cilësinë e palës se paditur /palës së tretë, apo edhe në cilësinë e palës paditëse.

Ndërkohë që, për 1 (një) cështje të mbartur nga vitet e kaluara, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë është shprehur me vendim përfundimtar.
Nga 11 (njëmbëdhjetë) cështje e reja të regjistruara gjatë vitit 2023, 1 (një) cështje është rikthyer për gjykim në këtë gjykatë me vendim të Gjykatës së Lartë, ndërsa 10 (dhjetë) cëshje janë procese ankimimi të ushtruar nga APP, ndaj një vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë apo nga personat e penalizuar me gjobë/operatorët ekonomikë .

**Tabela 94**

| Çështje në Gjykatë Administrative të Apelit | |
|---|---|
| Gjithsej | 95 |

- **Ndërkohë, në Gjykatën Civile të Apelit** kemi qenë palë në 1 (një) proces gjyqësor, ku APP është në cilësinë e palës së paditur, çështje e cila theksojmë se ishte e mbartur nga vitet e mëparshme.

Për këtë çështje, Gjykata Civile e Apelit ka dalë me Vendim në lidhje duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga Gjykata e shkallës së parë nr.11500 datë 26.11.2012, për pushimin e gjykimit të kërkesë padisë.

- Përveç çështjeve gjyqësore pranë gjykatave administrative, sikurse analizuar më sipër, APP është palë edhe në **15 çështje të ngritura pranë Gjykatës së Lartë**, duke përfshirë këtu edhe çështje, të cilat janë të mbartura nga vitet e kaluara.

Në formë tabelore:

**Tabela 95**

| Çështje në proces në Gjykatën e Lartë | |
|---|---|
| Gjithsej | 15 |

Ndërkohë, gjatë vitit 2023, Gjykata e Lartë ka dalë me **8 (tetë)** vendime, nga të cilat:

- **6 (gjashtë) raste** ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga APP/Avokatura e Shtetit, duke lënë kështu në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit,
- **1(një) rast** ka vendosur rrëzimin e vendimit të Gjykatës së Apelit, duke e kthyer çështjen për rigjykim në këtë gjykatë me trup tjetër gjykues
- **1 (një) rast** ka vendosur rrëzimin e vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit duke lënë kështu në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në formë tabelore po i paraqesim si më poshtë:

**Tabela 96**

| Vendimmarrja e Gjykatës së Lartë në çështjet e mbyllura gjatë vitit të 2023 | |
|---|---|
| **Çështje gjyqësore** | **Numri** |
| **Mospranim rekursi të paraqitur nga APP/Avokatura Shtetit/pala paditese** | **6** |
| **Kthimin e çështjes në Gjykatën e Apelit me trup tjetër gjykues** | **1** |
| **Rrezimin të vendimit te dhënë nga Gjykata e Apelit** | **1** |

# 12

# TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR PUBLIKIMIN

APP trajton të gjithë zërat e regjistrave të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe miraton ose refuzon elementët në sistemin elektronik të prokurimit, vlerëson formatin e të gjithë njoftimeve që dërgohen në sistem nga autoritetet kontraktore për publikim me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit dhe më pas kryen publikim e tyre, verikon dhe publikon njoftimet për procedurat e prokurimit publik/procedurat konkurruese të koncesioneve/ppp/ ankandet të zhvilluara nga AK, si dhe kthen për saktësim dhe publikon në Buletinin e APP çdo informacion të nevojshëm, etj.

Një nga detyrat kryesore është përgatitja e Buletinit të Njoftimeve Publike në përputhje me LPP, VKM Nr. 176, date 29.03.2006 "Për Botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike" dhe rregullat e prokurimit publik, i cili publikohet në faqen kryesore të internetit të APP.

Gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2023 janë përgatitur për publikim në total **105** Buletine të Njoftimeve Publike (nga të cilët **52** kanë qenë Buletinë të Posaçëm në lidhje me procedurat e prokurimit publik për Rindërtimin), me një numër faqe në total prej **31084** faqe ose mesatarisht **598** faqe për javë.

APP ndër të tjera kryen sa më poshtë:

- Kontrollon të dhënat e hedhura nga personat përgjegjës në regjistrin e parashikimeve dhe të realizimeve të prokurimit publik, publikon ose kthen për saktësim publikimin e tyre në sistemin elektronik të prokurimit.
- Kontrollon të dhënat e hedhura në sistemin e prokurimit elektronik konform rregullave të prokurimit, dhe rregullave të konçesioneve, njoftimet e kontratave, njoftimet e fituesve, njoftimet e lidhjeve të kontratave të nënshkruara, njoftimet e anullimeve, njoftimet për korrigjim gabimesh për procedurat e prokurimit publik/procedurat konkurruese të koncesioneve/ppp të zhvilluara nga AK, miraton ose refuzon publikimin e tyre ne SPE.
- Publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike konform rregullave të ankandit publik, njoftimet e kontratave, njoftimet e fituesit paraprak dhe nese ligji e parashikon, fituesin perfundimtar, njoftimet e lidhjeve të kontratave të nënshkruara, njoftimet e anullimeve, njoftimet për ndreqje gabimesh të procedurave të ankandeve publike dhe qerave të zhvilluara nga AK.
- Publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimet e procedurave të lejeve minerare të realizuara nga AK.
- Publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike, sipas parashikimeve të VKM. 176/2006, çdo njoftim për vend pune apo njoftim tjetër të kërkuar nga AK.
- Publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike listën e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në prokurimin publik, nga koncesionet/partneriteti publik privat apo nga pjesëmarrja në ankandet publike, si dhe arsyet e këtij përjashtimi, në bazë LPP-së, nenit 7/d të ligjit për ankandin publik dhe nenit 11/b të ligjit 125/2013 "Për koncensionet dhe partneritetin publik privat" i ndryshuar.
- Publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike çdo informacion apo njoftim në përputhje me LPP, rregullat e prokurimit publik, si dhe me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.176, datë 29.03.2006 "Për botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike", si dhe ligje të tjera.
- U jep suport telefonik ose verbal, përdoruesve të sistemit të prokurimit elektronik në lidhje me krijimin e procedurave dhe njoftimet e kontratave, njoftim fituesve, njoftime lidhjeve të kontratave të nënshkruara, njoftim anullimeve etj.

- Raporton në lidhje me njoftimet e procedurat të prokurimit të krijuara në sistem nga autoritetet kontraktore nëse konstatohen parregullsi.
- Publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike, sipas parashikimeve ligjore ne fuqi, njoftimet e fituesit për minikonkurset për një kontratë të zhvilluar në Marrëveshjet Kuadër dhe njoftimet e modifikimit të kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj.
- Përgatit dhe dërgon Buletinin e Njoftimeve Publike për t'u publikuar në portalin e APP.

## 12.1. Publikimi i njoftimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik

APP gjatë vitit 2023 ka trajtuar dhe publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe më pas në Buletinin e Njoftimeve Publike të rradhës:

- ➢ Publikimi i Njoftimeve të Procedurave në Sistemin e Prokurimit Elektronik sipas kategorive:

- **5250** Njoftime Kontratash të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke reflektuar ne Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit;
- **4007** Njoftime Fituesi të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit;
- **3750** Njoftime Kontratash të Nënshkruara për procedura të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik;
- **120** Njoftime fituesi për procedurat me negociim pa shpallje paraprake,
- **87** Njoftime Kontratash të Nënshkruara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake, për plotësimin e nevojave të vitit 2023;
- **1873** Njoftime Anullimi të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit.
- **11** Njoftime Kontratash në kuadër të rindërtimit, të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke reflektuar ne Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit;
- **3** Njoftime Anullimi për procedurat në kuadër të rindërtimit, të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave.




**Grafiku 63**




**Grafiku 64**

Është e rëndësishme të theksojmë se, më sipër janë cituar vetëm njoftimet e miratuara dhe publikuara, pasi në punën e përditshme, për shkak të gabimeve që konstatohen në formularët e njoftimeve të dërguara për publikim nga autoritetet kontraktore, si dhe për shkak të mos respektimit të afateve të ankimimit, vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik, dhe faktorëve të tjerë të ngjashëm, APP ka qenë i detyruar të bëjë rikthimin e këtyre njoftimeve.

Konkretisht, totali i procedurave të refuzuara në SPE nga publikuesit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 rezulton rreth 1724 njoftime. Ndarja e këtyre procedurave të mospublikuara sipas kategorive përkatëse është:

**Tabela 97**

| REFUZIMET NË SPE SIPAS KATEGORIVE | | | |
|---|---|---|---|
| Njoftime Kontrate | Njoftime Fituesi | Njoftime Kontratë e nënsh-kruar | Njoftime Anullimi |
| 891 | 514 | 213 | 106 |




**Grafiku 65**

➢ **Përqindja që zë çdo kategori e refuzuar reflektohet në grafikun e mëposhtëm:**

Gjithashtu, APP gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2023 ka trajtuar 1119 Vendime të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurat e prokurimit në faza të ndryshme, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit. Të detajuara këto (1119) Vendime të Komisionit të Prokurimit Publik për periudhën Janar– Dhjetor 2023 janë si më poshtë:

- **339** pezullime fillestare të procedurave të prokurimit,
- **209** vendime të tjera (anullimi, modifikimi, pezullimi të ndërmjetëm, rivleresimi etj)
- **571** vendime lejimi.




Grafiku 66




Grafiku 67

## 12.2. Publikimi i Njoftimeve për Ankande Publike në Buletinin e Njoftimeve Publike

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2023 janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike për procedurat e ankandeve publike:

- 264 Njoftime për shpalljen e Ankandeve publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 133 Njoftime Fituesish për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 55 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 93 Njoftime Anullimi për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;




Gafiku 68

## 12.3. Njoftime për Koncesione/Partneritet Publik Privat dhe të njoftime të tjera

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike:

Tabela 98

| Tipi i Njoftimeve | Numri |
|---|---|
| **Njoftime Kontratash për Procedura Koncesioni.** | **0** |
| **Njoftime Fituesi për Procedura Koncesioni** | **2** |
| **Njoftime për Procedura konkurruese për dhënie leje minerare** | **14** |
| **Njoftime të tjera.** | **1181** |
| **Njoftime për dhënie me qera.** | **128** |




Grafiku 69

## 12.4. Publikimi i elementëve të regjistrit në sistem

Gjithashtu, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë trajtuar **38,413** elementë të regjistrave (zëra të rinj dhe ndryshimet e kryera gjatë periudhës Janar-Dhjetor te vitit 2023) në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, nga të cilat **30,988** janë elementë të publikuar ndërsa **7,425** janë elementë të refuzuar per shkak të mos plotësimit të të dhënave saktë nga autoritetet.

Tabela 99

| Numri i elementëve të trajtuar | |
|---|---|
| **Numri i elementëve të publikuar** | **30,988** |
| **Numri i elementëve të refuzuar** | **7425** |
| **Totali** | **38413** |

**Më poshtë në grafik paraqiten elementët e regjistrit të miratuar dhe të refuzuar:**




**Grafiku 70**

Më poshtë paraqitet përqindja e elementëve të regjistrit të publikuar dhe të refuzuar gjatë vitit 2023.




**Grafiku 71**

APP ka qenë në gadishmëri për të publikuar shumicën e elementëve të regjistrit brenda 24 orëve nga dërgimi për publikim i tyre pranë APP.

## 12.5. Praktikat e shqyrtuara

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 APP ka trajtuar 3403 praktikat (shkresat) të detajuara si më poshtë:

Tabela 100

| Lloji i kërkesës | Numri: |
|---|---|
| Shkresa të trajtuara dhe të arkivuara | 3126 |
| Shkresa të trajtuara dhe kthyer pergjigje | 277 |

Shkresat e ardhura pranë APP të cilat janë trajtuar përfshijnë njoftimet e dërguara nga autoritetet kontraktore në lidhje me minikontratat, modifikimet e kontratave, vendet e punës, ankandet, qerat, njoftimet e qerave etj.




Grafiku 72




Grafiku 73

Pjesa më e madhe e praktikave të ardhura janë trajtuar dhe publikuar sipas dispozitave ligjore në fuqi, por ka pasur raste të konstatimeve për mosrespektimit të parashikimeve ligjore të cilave i është kthyer përgjigje në rrugë shkresore.

Gjithashtu, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 APP ka asistuar me anë të postës elektronike (emaileve) Autoritet Kontraktore të cilat kanë hasur problematika të caktuara në procesin e publikimit të njoftimeve elektronikisht dhe në mënyre shkresore. Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar rreth 515 emaile, të cilëve i është kthyer përgjigje brenda afateve kohore dhe sipas dispozitave ligjore në fuqi.

# 13

# TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR MENAXHIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE

APP ka si detyrë të saj funksionale edhe menaxhimin e bazës së të dhënave te SPE, asistencën e të gjithë përdoruesve të sistemit si dhe raportimin e problematikave me qëllim zgjidhjen e tyre pranë AKSHI-t dhe kompanisë së mirëmbajtjes duke qënë pjesë e ndjekjes së kontratës së mirëmbajtjes.

Qëllimi është përmiresimi i vazhdueshëm i procesit të prokurimit në SPE. APP asiston në rrugë shkresore, telefonike apo me anë të email të gjithë përdoruesit e SPE.

APP menaxhon BI Reports me qëllim gjenerimin e të dhënave nga sistemi dhe përpunimin e të dhënave statistikore, konkretisht:

- Pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë për muaj;
- Trendi i numrit të pjesemarrjes se operatoreve ekonomikë;
- Statistika Prokurime Elektronike të Publikuara;
- Statistika Njoftime fituesi të shpallura;
- Statistika Kontrata të nënshkruara të shpallura;
- Pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë në prokurime;
- Regjistri i realizimeve;
- Statistika regjistri i parashikimeve;
- Statistika mbi minikontratat;
- Statistika për arsyet e anullimit;
- Statistika procedurat me një ofertë;
- Transaksionet e miratuara nga AFMIS dhe Integrimi me AFMIS.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, APP ka suportuar të gjithë përdoruesit e sistemit të prokurimit elektronik për zgjidhjen e problematikave apo asistencën teknike. Gjithashtu ka përgatitur manuale dhe njoftime të ndryshme.

APP gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, ka punuar maksimalisht në ofrimin e shërbimeve me siguri të lartë për të gjithë Autoritetet Kontraktore, Operatorët Ekonomikë, Audituesit, si dhe çdo perdorues tjetër që, në përmbushje të detyrave të tij, përdor Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Po kështu APP ka qenë në dispozicion për çdo kërkesë për asistencë, pyetje apo paqartësi si dhe ka ndjekur me rigorizitet proceset e monitorimit e kontrollet javore, apo çdo problematikë të raportuar deri në zgjidhjen e tyre përfundimtare, etj.

Gjithashtu, pavarësisht situatës së vështirë të krijuar në vendin tone per shkak te sulmeve kibernetike, Sistemi i Prokurimit Elektronik ka qëndruar në punë (on-line) 24 orë, çdo ditë të javës.

Ndër të tjera APP:

- Asiston autoritetet kontraktore, operatorët ekonomike dhe çdo person të interesuar në lidhje me zërat e regjistrave të parashikimit dhe të realizimit dhe përcjell tek AKSHI dhe kontraktori

problematikat e konstatuara.

- Asiston autoritetet kontraktore, operatorët ekonomike dhe çdo person të interesuar mbi dokumentat standarte të tenderit dhe njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit elektronik /procedurave konkuruese koncesionare/ppp të shpallura në sistemin e prokurimit elektronik dhe përcjell tek AKSHI dhe kontraktori problematikat e konstatuara.
- Asiston autoritetet kontraktore, operatorët ekonomike dhe çdo person të interesuar mbi njoftimet e fituesve/ njoftimin e lidhjes së kontratave/njoftimin e anullimeve të procedurave të prokurimit elektronik /procedurave konkuruese koncesionare/ppp të shpallura në sistemin e prokurimit elektronik dhe përcjell tek AKSHI dhe kontraktori problematikat e konstatuara.
- Asiston autoritetet kontraktore, operatorët ekonomike dhe çdo person të interesuar mbi njoftimet e kontratës/ njoftimet e fituesve/ njoftimin e lidhjes së kontratave/njoftimin e anullimeve të procedurave të prokurimit elektronik / mbi procedurat të prokurimit /procedurave konkuruese koncesionare/ppp/ ankandeve që nuk zhvillohen në sistemin e prokurimit elektronik.
- Konsideron dhe ndjek komentet dhe rekomandimet e bëra në raporte të brendshme dhe të jashtme, sipas fushës së përgjegjësisë.
- Siguron asistencë teknike dhe/ose suport telefonik dhe e-mail, për personat përgjegjës të autoritetet kontraktore për krijimin e procedurave të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik sipas udhëzimeve të publikuara nga APP deri në fazën e arkivimit të tyre, si dhe përcjell problematikat që mund të shfaqen tek AKSHI dhe kontraktori.
- Siguron asistencë teknike dhe/ose suport telefonik dhe e-mail, për operatorët ekonomikë si dhe përcjell tek AKSHI problematikat që mund të shfaqen gjatë ofertimit në procedurat e prokurimit të shpallura në sistemin e prokurimit elektronik dhe në lidhje me krijimin/pajisjen me fjalëkalim ose mbylljen e llogarive në rolin e operatorit ekonomik.
- Siguron asistencë teknike dhe/ose suport telefonik dhe e-mail, për autoritetet kontraktore në lidhje me krijimin/pajisjen me fjalëkalim ose mbylljen e llogarive nga Administratori i Sistemit të Autoritetit Kontrakto, si dhe përcjell tek AKSHI dhe kontraktori problematikat që mund të shfaqen.
- Siguron asistencë teknike dhe/ose suport telefonik dhe e-mail, për Audituesit në lidhje me aksesimin e procedurave të prokurimit të arkivuara si dhe përcjell tek AKSHI dhe kontraktori problematikat që mund të shfaqen.
- Përcjell tek AKSHI dhe kontraktori problematikën dhe me pas me daljen e një përgjigje nga investigimi i kryer përpilon shkresen për autoritetet kontraktore apo operatoret ekonomike.
- Sugjeron zhvillime dhe përmirësime të mëtejshme të funksioneve/proceseve në sistemin e prokurimit elektronik dhe sipas rastit, monitoron, këshillon me qëllim arritjen e një performance sa më të mirë të sistemit në kuadër të bazës së të dhënave.
- Ndjek përditësimin e informacionit në faqen zyrtare të internetit të institucionit me publikimin e njoftimeve, udhëzimeve, rekomandimeve, etj.
- Përgatit çdo informacion sqarues me kërkesë paraprake ose jo, me qëllim informimin mbi realizimin e objektivave dhe detyrave.

Një nga objektivat kryesore të APP është përmirësimi i vazhdueshëm dhe optimizimi i ndërfaqes, me qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e punës së përdoruesve. APP ka vijuar punën me identifikimin e kërkesave për përmirësime dhe shtim të disa funksionaliteteve të reja për Sistemin e Prokurimit Elektronik. Konkretisht, gjatë periudhës Janar - Dhjetor janë raportuar tek kompania e mirëmbajtjes 168 raste/ kërkesa për përmirësim në funksionet dhe ndërfaqet e roleve në sistem, analizimi të dhënave, verifikime në sistem, etj.
Të gjitha çështjet e hapura në CRM janë ndarë si më poshtë:




**Grafiku 74**

Gjatë vitit 2023 në Sistemin e prokurimit Elektronik, janë realizuar përmirësimet e mëposhtme:

- Përmirësim në deklarimin e operatorëve ekonomikë si bashkim operatorësh nga KVO.

Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duhet të deklarojnë të gjithë operatorët ekonomikë me të cilët është bashkuar operatori kryesues gjatë ofertimit. Deklarimi duhet të jetë i njëjtë nga të gjithë anëtarët e KVO dhe përqindja përkatëse e secilit operator ekonomik. Ky përmirësim synon identifikimin e operatorëve ekonomikë në rastin kur marrin pjesë si bashkim operatorësh.

- Ndarja e skedarit Procedurat e publikuara në rolin e njësisë së prokurimit.

Përmirësimi synon ndarjen e procedurave konkretisht kontratë, marrëveshje kuadër, sistem dinamik. Gjithashtu skedari marrëveshje kuadër ndahet në llojet e marrëveshjeve kuadër me qëllim identifikimin e procedurave marrëveshje kuadër.

• Ndryshim i zyrtarëve të prokurimit nga llogaria e administratorit të sistemit të autoritetit kontraktor

Me qëllim përfundimin e procedurave të lëna pezull (konkretisht procedurat draft apo procedurat e papublikuara) administratorit të sistemit të autoritetit kontraktor i është dhënë mundësia të shtoj një zyrtar prokurimi me qëllim përfundimin e këtyre procedurave.

• Përmiresim i BI Reports

Me qëllim përpunimin e të dhënave statisitikore janë realizuar përmiresime në raportet e gjeneruara nga SPE.

• Gjatë kësaj periudhe janë kryer përmirësime në shfaqjen e fushave apo informacioneve të nevojshme për zbatimin e detyrave të përditshme të përdoruesve si:

•

- Përmirësime në ndërfaqet e Rolit e Publikuesit.
- Përmirësime në Raportet që gjenerohen nga sistemi për rolin Analist prokurimesh, etj.

## 13.1. Dhënia e asistencës teknike për përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik

Një nga detyrat e APP është garantimi i asistencës teknike për çdo kërkesë (kërkesat për dekriptim dokumentash, kërkesat për sqarim, ankesat nga ana teknike), të mbërritur në APP, garantimi i asistences teknike për punonjësit e APP-së, garantimi i asistencës teknike për telefonatat dhe e-mailet e mbërritura në APP.

Asistenca teknike që u jepet të gjitha autoriteteve kontraktore, si dhe të gjithë operatorëve ekonomikë të huaj dhe vendas të cilët përdorin sistemin e prokurimit elektronik, nëpërmjet e-mail-eve, telefonit apo dhe konsultimeve në ambientet e APP, është një punë e përditshme për këtë drejtori. Këtu vlen të përmendet se numri i lartë telefonatave apo e-maileve.

Nga APP, janë dërguar rreth 4235 e-maile në total, dyfishi i emaile-ve të dërguara në 2022, drejt:

- autoriteteve kontraktore, sqarime të përgatitura për autoritetet kontraktore (për sqarime dhe udhëzime të karakterit teknik);
- operatorëve ekonomikë (për konfirmimin e regjistrimeve të bëra online, për rikthim të fjalëkalimit në gjendjen fillestare, për sqarime, udhëzime dhe ankesa);
- institucioneve të tjera (për dërgim të dhënash dhe informacionesh);

Garantimi i asistencës teknike për llogari audituese për çdo auditues të Autoriteteve Kontraktore si dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- **Pasurimi i portalit të APP me informacionet e duhura,**

Nga APP është kryer publikimi i cdo informacioni të përditësuar në lidhje me procesin e prokurimit, konkretisht ne portal janë publikuar

- 105 buletinëve javorë (ku 52 prej tyre janë Buletine te Njoftimeve Publike dhe 53 janë Buletinë te Posacëm),
- Vendime nga Monitorimi i APP - 50 vendime
- Vendime nga Raportet e Auditimit - 5 vendime
- Vendime për Përjashtime të Operatorëve Ekonomikë - 26 vendime
- VKM 2023 - 1 vendim
- Udhëzime 2023 - 1 publikim
- Rekomandime 2023 - 3 publikime
- Sjellje në vëmendje të AK – 2 publikime
- Lajmërime për operatoret ekonomike - 4 publikime
- Njoftime- 11 njoftime per autoritetet kontraktore dhe operatoret ekonomike.
- Krijimi, azhornimi, si dhe mbyllja e llogarive të Sistemit të Prokurimit Elektronik
- Monitorimi i procedurave të prokurimit të lëna pezull në sistem dhe tërheqja e vëmendjes ndaj personave përgjegjës konform legjislacionit në fuqi.
- Arkivimi i të gjitha procedurave të lëna pezull nga Autoritetet Kontraktore per procedurat e prokurimit me 2 faza e dyte zhvillohet ne forme shkresore. Ky proces bën të mundur që sistemi operacional, në të cilin kryhen të gjitha procedurat e prokurimit publik, të lehtësohet ndjeshëm duke ulur gjithmonë e më shumë numrin e procedurave që ndodhen në të dhe, për pasojë, duke lehtësuar punën e përdoruesve të sistemit (Autoritete Kontraktore, Operatorë Ekonomikë, Auditues).
- Evidentimit të rasteve problematike dhe dhënien e mendimit duke e referuar tek suporti për përmirësimin e sistemit të prokurimit elektronik, konform legjislacionit në fuqi.
- Testim te zhvillimeve dhe permiresimet te SPE perpara se te kalojne ne sistemin live
- Ndjekja e kontratës së mirëmbajtjes për Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe e të gjithë komponentëve të saj duke monitoruar tëgjithë kompontet e sistemit.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit (SLA) mes Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe APP si dhe kontrates Nr.64 datë 30.07.2023 të nënshkruar ndërmjet AKSHI-t dhe kompanisë së mirëmbajtjes për "Mirëmbajtjen e Sistemit të Prokurimit Elektronik", APP ka marr masat për zgjidhjen e cështjeve të referuara nga rekomandimet e kompanisë së mirëmbajtjes, përsa i përket kopmetencave të APP.

## 13.2. Statistika mbi transaksionet e miratuara nga AFMIS

Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave janë integruar Sistemi i Thesarit (AFMIS) me Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) per nje pjese te institucioneve te cilat aktualisht veprojne me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).

Gjate vitit 2023 pas permiresimit te integrimit te Sistemit te Prokurimit Elektronik me Thesarin (AFMIS) pas kontrollit të fondeve me AFMIS jane publikuar **2847** procedura prokurimi, pra për 76% te procedurave te prokurimit eshte bere kontrolli i fondeve (ku nuk bëjnë pjesë procedurat e prokurimit blerje me vlerë të vogël, sistem dinamik i biletave, marrëveshje kuadër).




**Grafiku 75**

**** Institucionet të cilat nuk kanë integrim me AFMIS, por publikojnë procedura prokurimi në SPE është 25%, kjo për shkak se nuk jane shtuar të gjithë institucionet në sistemin AFMIS, ndërkohë që infrastruktura e SPE është e konfiguruar t'i përmbajë të gjitha autoritetetet kontraktore gjatë procesit të ndërveprimit.**

## 13.3. Praktikat e shqyrtuara

Gjatë vitit 2023, janë trajtuar 883 shkresa dhe memo në total, ku përfshihen:

- Krijim/ Mbyllje llogarie në rolin CA Admin, si dhe rikthim fjalëkalimi në gjendje fillestare (373);
- Shkresa sqaruese me Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë (354);
- Shkresa për arkivim dhe persona përgjegjës (37);
- Memo të brendshme dhe memo për bashkëpunim me Drejtoria Juridike, Verifikimit dhe Integrimit në APP (60);
- Shkresa me ILDKPKI (59)

**Tabela 101**

| Praktikat e shqyrtuara gjatë vitit 2023 sipas llojit të kërkesës | |
|---|---|
| **Lloji i Kërkesës** | **Numri** |
| **Kërkesa për mbyllje llogarie/ ndryshim fjalëkalimi per autoritetet kontraktore** | **373** |
| **Shkresa sqaruese me Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë** | **354** |
| **Kërkesa për asistencë teknike/sqarime dhe për dërgim të dhënash dhe bashkëpunim me institucionet e tjera** | **37** |
| **Shkresa për arkivim dhe persona përgjegjës** | **60** |
| **Shkresa pë ILDKPKI** | **59** |
| **Totali** | **883** |

Sic shihet edhe nga të dhënat e mësipërme numrin më të lartë të shkresave të dërguara dhe të trajtuara, e zënë shkresat për fjalekalim pavarësisht se operatoret ekonomike regjistrohen dhe pajisen me fjalekalim nepermjet EAlbania-s.

## 13.4. Krijimi i përdoruesve të rinj për vitin 2023

Për vitin 2023 në sistemin e prokurimit elektronik janë krijuar 24023 përdorues të rinj (autoritete kontraktore dhe operatorë ekonomikë), përkatësisht:

Gjatë vitit 2023 janë krijuar 18 llogari të reja në rolin "Administrator i Sistemit" për Autoritetet Kontraktore. Ndërsa nga llogaritë e Administratorëve të Autoriteteve Kontraktore janë krijuar në total rreth 5145 përdorues të rinj.

Në tabelën e mëposhtëm paraqitet numri i përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik, brenda Autoriteteve Kontraktore, të krijuar përkatësisht në vitin 2023.

Tabela 102

| Roli i Llogarisë | Llogarive të Përdoruesve të krijuar gjatë vitit 2023 |
|---|---|
| **Administrator i Sistemit për AK** | **18** |
| **Njësi Prokurimi** | **2336** |
| **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** | **2532** |
| **Auditues i AK** | **277** |
| **Auditues** | **16** |
| **Totali** | **5179** |

Në tabelën dhe në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik, të krijuar përkatësisht në vitin 2023, sipas muajve.

**Tabela 103**

| Muaji | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i përdoruesve | 470 | 613 | 474 | 441 | 415 | 353 | 451 | 305 | 431 | 555 | 371 | 300 |

Siç mund të vihet re numri më i madh i përdoruesve të krijuar është në muajin Shkurt pasi është krijuar dhe Njësia e prokurimit në fillim të vitit me qëllim marrjen e masave për shpalljen e procedurave të prokurimit.




**Grafiku** 76

Nga figura shihet qartë krijimi i llogarive të përdoruesve në sistem për periudhën Nëntor-Dhjetor Kemi një rënie të dukshme të krijimit të përdoruesve, e cila është dhe periudha kur nuk kemi shumë shpallje te procedurave te prokurimit pasi nga ana e autoriteteve kontraktore jane marre masa per shpalljen e tyre gjate vitit.

Tabela e mëposhtme paraqet statusin e llogarive të përdoruesve nga Autoritet Kontraktore në Sistemin e Prokurimit Elektronik:

Tabela 104

| Roli i Llogarisë | Llogari përdoruesi Aktive | Llogari përdoruesi joaktive |
|---|---|---|
| **Administrator i Sistemit për AK** | **1487** | **1011** |
| **Njësi Prokurimi** | **6288** | **29116** |
| **Komisioni Vlerësimit të Ofertave** | **7959** | **33178** |
| **Auditues i AK** | **462** | **4663** |
| **Auditues** | **74** | **110** |

Gjithashtu, në sistem rezultojnë rreth 67067 llogari përdoruesi në rolin e njësisë së prokurimit, anëtarët të KVO, audites etj në statusin joaktiv per shkak te levizjes se personave drejt institucioneve te tjera apo per shkak te perfundimit te detyrave te tyre ne sistem dhe 14783 llogari përdoruesi në rolin e njësisë së prokurimit, anëtarët të KVO, audituesit në statusin aktiv. Ndërsa në rolin e Administratorit të Sistemit për autoritetin kontraktor janë 1011 në statusin joaktiv, per shkak te mbylljes se institucioneve apo shkrirjen e tyre dhe 1487 në statusin Aktiv.

